

**UNIVERSITETI I EJL  
JNE УНИВЕРЗИТЕТ  
SEE UNIVERSITY**



**FAKULTETI I DREJTESISË  
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ  
FACULTY OF LAW**

**STUDIMET PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË**

**TEMA E MAGJISTRATURËS:**

**“SHKURORËZIMI ME THEKS TË VEÇANTË NË KOMUNËN E PRESHEVËS  
PËR PERIUDHËN 2010-2015”**

**KANDIDATJA:  
Drenushë Sherifi**

**MENTORI:  
Prof.Dr.Adnan Jashari**

**TETOVË, PRILL , 2018**

***E drejta e autorit: Drenushë Sherifi***

Ky punim shkencor është realizuar sipas kërkesave të "Rregullores për ciklin e dytë të studimeve,, së Senatit të Universitetit të Evropës Juglindore.

Unë , Drenushë Sherifi deklaroj se unë jam autori original i këtij punimi.

**Copyright: Drenushë Sherifi  
Të gjitha të drejtat të rezervuara  
2018**

*Këtë punim ua dedikoj prindërve të mi babit Mesudit dhe nanës Florës në shenjë respekti, dashurie dhe falemnderimi të pafund...*

## REZYME

Shkurorëzimi në Komunën e Preshevës për periudhën 2010-2015 ka qenë objekt i studimit në këtë hulumtim. Në pjesën e parë të këtij hulumtimi bëhet fjalë për shkurorëzimin në përgjithësi, për veqoritë e shkurorëzimit, për shkurorëzimin dhe religjionin, për shkurorëzimin në të drejtën zakonore shqiptare dhe sistemet juridike të shkurorëzimit. Në pjesën e dytë është paraqitur zhvillimi historik i shkurorëzimit në periudha të ndryshme kohore duke filluar që nga shtetet e para skllavopronare e deri në ditët e sotme. Në pjesën e tretë flitet për rregullimin juridik të shkurorëzimit në Republikën e Serbisë, për shkaqet e shkurorëzimit sipas legjislacionit serb, për procedurën e shkurorëzimit, për pasojat e shkurorëzimit, për të dhënat statistikore mbi shkurorëzimin në Serbi si dhe shkurorëzimin në disa nga shtetet fqinje. Pjesa e katërtëka të bëjë me shkaqet aktuale në Komunën e Preshevës, shkurorëzimi në periudhën 2010-2015.

Është bërë identifikimi i faktorëve relevantë dhe shkaktarëve më të mëdhenj të shkurorëzimit në Komunën e Preshevës si dhe pasojave të shkurorëzimit. Hulumtimin e kam përqëndruar tek institucionet relevante për shkurorëzimin si Gjykata Themelore e Preshevës, Qendra për Punë Sociale, Zyra e Ofiçarisë e Komunës së Preshevës si dhe tek vet të shkurorëzuarit nga komuna jonë që janë shkurorëzuar në periudhën 2010-2015. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë që të jap një pasqyrim të gjendjes reale të shkurorëzimit në Komunën e Preshevës si dhe identifikimin e shkaqeve kryesore dhe pasojave të shkurorëzimit. Theks të veçantë në këtë hulumtim iu është kushtuar shkurorëzimeve të çifteve që kanë pasur fëmijë. Kam analizuar në veçanti numrin dhe moshën e fëmijëve të pindërve të shkurorëzuar, kujdestarinë si dhe alimentacionin. Poashtu është analizuar edhe kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar dhe mosha e të shkurorëzuarve mosha mesatare e gruas dhe burrit. Është analizuar gjithashtu edhe mënyra e inicimit të procedurës së shkurorëzimit në Komunën e Preshevës për këtë periudhë kohore.

**Fjalët kyçe:** *shkurorëzimi, shkaqet e shkurorëzimit, pasojat e shkurorëzimit, kujdestaria e fëmijëve, inicimi i procedurës, Komuna e Preshevës.*

|  |    |
|--|----|
| <b>HYRJE</b> .....   | 7  |
| <b>KAPITULLI I</b> .....   | 9  |
| <b>SHKURORËZIMI, VEQORITË DHE SISTEMET E SHKURORËZIMIT</b> .....                 | 9  |
| <b>1.NË PËRGGJITHËSI PËR SHKURORËZIMIN</b> .....                                 | 9  |
| 1.1.Kuptimi i shkurorëzimit.....   | 9  |
| 1.2.Veqoritë e shkurorëzimit.....  | 10 |
| 1.3.Shkurorëzimi dhe religjioni.....   | 11 |
| 1.4. Shkurorëzimi në të drejtën zakonore shqiptare .....                         | 18 |
| <b>2.SISTEMET JURIDIKE TE SHKURORËZIMIT</b> .....                                | 23 |
| 2.1.Sistemi juridik i ndalimit të shkurorëzimit.....                             | 23 |
| 2.2.Sistemet juridike që e lejojnë shkurorëzimin.....                            | 23 |
| 2.3.Sistemi i shkurorëzimit si sanksion.....                                     | 24 |
| 2.4.Sistemi i shkurorëzimit si ilaç.....   | 24 |
| 2.5.Sistemi i kombinuar i shkurorëzimit.....                                     | 24 |
| <b>KAPITULLI II</b> .....  | 26 |
| <b>3.ZHVILLIMI HISTORIK I SHKURORËZIMIT</b> .....                                | 26 |
| 3.1.Shkurorëzimi në shtetet e para skllavopronare.....                           | 26 |
| 3.1.1.Shkurorëzimi në Egjipt.....  | 26 |
| 3.1.2.Shkurorëzimi në Babiloni.....  | 27 |
| 3.1.3.Shkurorëzimi në Athinë.....  | 28 |
| 3.1.4.Shkurorëzimi në të drejtën Romake.....                                     | 29 |
| 3.2.Shkurorëzimi në periudhën e feudalizmit.....                                 | 32 |
| 3.2.1.Shkurorëzimi në shtetin Frank.....   | 32 |
| 3.2.2.Shkurorëzimi në shtetin Bizantin.....                                      | 32 |
| 3.2.3.Shkurorëzimi në Francën feudale.....                                       | 33 |
| 3.3.Shkurorëzimi në periudhën liberale.....                                      | 33 |
| 3.3.1.Shkurorëzimi në Angli.....   | 33 |
| 3.3.2.Shkurorëzimi në Gjermani.....  | 34 |
| 3.3.3.Shkurorëzimi në SHBA.....  | 35 |
| 3.3.4.Shkurorëzimi dhe Revolucioni Francez Borxhez.....                          | 36 |
| <b>KAPITULLI III</b> .....   | 37 |
| <b>4.SHKURORËZIMI NË REPUBLIKËN E SERBISË</b> .....                              | 37 |
| 4.1.Rregullimi juridik i shkurorëzimit në Republikën e Serbisë.....              | 37 |
| 4.1.1.Kushtetuta e RS.....   | 37 |
| 4.2.2.Ligji për Familjen i RS.....   | 37 |
| 4.2.3.Konventat dhe dokumentet ndërkombëtare që e rregullojnë shkurorëzimin..... | 38 |
| 4.2.Shkaqet e shkurorëzimit sipas legjislacionit serb.....                       | 40 |
| 4.3.Procedura e shkurorëzimit në Republikën e Serbisë.....                       | 41 |
| 4.3.1.Mënyrat e shkurorëzimit .....  | 41 |
| 4.3.2.Inicimi i procedurës.....  | 43 |
| 4.3.3.Kompetenca e gjykatës.....   | 43 |
| 4.3.4.Parimet e procedurës.....  | 44 |

|  |            |
|--|------------|
| 4.3.5.Fazat e procedurës së shkurorëzimit.....                               | 45         |
| 4.3.6.Sjellja e vendimit.....  | 47         |
| 4.3.7.Mjetet juridike.....   | 47         |
| 4.4.Pasojat e shkurorëzimit .....  | 48         |
| 4.4.1.Pasojat ndaj ish bashkëshortëve.....                                   | 48         |
| 4.4.1.1.Efektet e karakterit personal.....                                   | 48         |
| 4.4.1.2.Efektet e karakterit pasuror.....                                    | 49         |
| 4.4.2.Pasojat ndaj fëmijëve.....   | 52         |
| 4.5.Të dhëna mbi shkurorëzimin në Serbi nga Enti Statistikor Republikan..... | 54         |
| 4.6.Vështrime krahasuese mbi shkurorëzimin në shtetet fqinje.....            | 58         |
| 4.6.1.Shkurorëzimi në Shqipëri.....  | 58         |
| 4.6.2.Shkurorëzimi në Kosovë.....  | 62         |
| 4.6.3.Shkurorëzimi në Maqedoni.....  | 64         |
| <b>KAPITULLI IV.....</b>   | <b>66</b>  |
| <b>5.AKTUALITETI I SHKURORËZIMIT NË KOMUNËN E PRESHEVËS.....</b>             | <b>66</b>  |
| 5.1.Shkaqet aktuale të shkurorëzimit në Komunë të Preshevës.....             | 66         |
| 5.2.Shkurorëzimi në vitin 2010.....  | 73         |
| 5.3.Shkurorëzimi në vitin 2011.....  | 76         |
| 5.4.Shkurorëzimi në vitin 2012.....  | 79         |
| 5.5.Shkurorëzimi në vitin 2013.....  | 82         |
| 5.6.Shkurorëzimi në vitin 2014.....  | 85         |
| 5.7.Shkurorëzimi në vitin 2015.....  | 88         |
| <b>PËRFUNDIMI.....</b>   | <b>97</b>  |
| <b>BIBLIOGRAFIA.....</b>   | <b>100</b> |

## HYRJE

Lënda e këtij punimi është divorci në veçanti në Komunë të Preshevës për periudhën 2010-2015. Me anë të kësaj teme do të mundohem të bëj një analizë më të thellë për divorcin. Dihet që divorci është një problem shumë kompleks pasi nuk është vetëm problem juridik por edhe social e psikologjik. Do paraqes zhvillimin historik të tij pra si ka evoluar përgjatë viteve, si dhe do bëj përpjekje të qes në pah shkaqet apo faktorët që ndikojnë që bashkëshortët të marrin vendimin për tu ndarë.

Qëllimi i këtij punimi është që të kuptohet thelbi i divorcit dhe këtë qëllim mendoj ta arrij duke shqyrtuar literaturë të ndryshme që do na shërbejë që ta kuptojmë më mirë institucionin e divorcit. Qëllim tjetër është identifikimi i shkaqeve apo faktorëve të cilat ndikojnë që bashkëshortët të divorcohen. Poashtu edhe shtjellimin e pasojave që sjell divorci do përbëjë qëllim në vete, kjo pasi divorci ka pasoja jo vetëm për bashkëshortët por edhe për fëmijet dhe familjet e bashkëshortëve. Këto qëllime mendoj ti përmbush duke u bazuar në literaturë të ndryshme si dhe duke analizuar legjislacionin si atë vendor ashtu edhe legjislacionin ndërkombëtar. Poashtu do kem për qëllim të bëjë edhe krahasime mes procedurës së divorcit në Republikën e Serbisë dhe procedurave të divorcit të shteteve të rajonit. Sikur çdo punim i këtij lloji edhe ky punim do ketë hipotezat e tij.

Hipoteza e përgjithshme e kësaj teze është :

Në Komunën e Preshevës është rritur ndjeshëm numri i divorceve këto pesë vitet e fundit.

Hipotezat e veçanta janë :

a) mospërputhja e karaktereve çon në divorc – këtë hipotezë do ta verifikoj duke parë dhe analizuar te gjitha rastet e divorceve në Komunë të Presheves për periudhën për te cilën bëhet fjalë;

b) martesat e rregulluara me shkuesi (apo siç i themi në gjuhën popullore martesat me mësit) janë të predispozuara të përfundojnë me divorc;

c) bashkëshortët që nuk kanë fëmijë e kanë më të lehtë për të marrë vendimin për shkurorëzim.

Këto hipoteza poashtu do t'i verifikoj duke bërë intervista me njerëz të cilët janë shkurorëzuar viteve te fundit.

Për pregatitjen e kësaj teze të magjistraturës do të përdori edhe metoda specifike kërkimore – shkencore, të cilat do të më ndihmojnë në përmbledhjen e fakteve, rasteve dhe kërkimeve hulumtuese për ta bërë temën sa më objektive dhe për përmbledhje të të dhënave edhe nga vetë personat të cilët janë divorcuar. Metodatat që do ti përdor janë: metoda normative, metoda historike, metoda analitike, metoda krahasuese, metoda statistikore, metoda deskriptive, metoda e intervistës dhe metoda e studimit të rastit. Metoda normative do më shërbejë që të analizoj normat juridike që mirren me çështjen e divorcit, si të vendit ashtu edhe ato ndërkombëtare. Metodën historike do ta shfrytëzoj për të treguar zhvillimin historik të divorcit në mënyrë kronologjike që nga shtetet e para skllavopronare e deri ne ditët e sotme. Me metodën analitike kam kuptuar domethënien e vërtetë të dispozitave ligjore që mirren me divorcin si të legjislacionit të vendit ashtu edhe atë ndërkombëtar me theks të veçantë legjislacioni pozitiv i R.së Serbisë më konkretisht Ligji për familjen (Gazeta zyrtare e R.Serbisë 18/2005 dhe 72/2011) si dhe të dokumenteve ndërkombëtare që mirren me këtë çështje. Për të bërë krahasime në mes të

divorcit në vendin tonë dhe divorcit në shtetet fqinje me qëllim që të vihen në pah ngjajshmëritë dhe dallimet e divorcit në shtete të ndryshme kam përdorur metodën krahasuese.

Për të hulumtuar dhe studiuar dukurinë e divorcit dhe analizuar karakteristikat e saj më ka ndihmuar shumë metoda statistikore përmes së cilës kam bërë grumbullimin e të dhënave të divorcit në Komunë të Preshevës. Këto të dhëna i kam grumbulluar në Gjykatën themelore duke parë për se afërmi lëndë të divorcit, mandej në Ofiqarinë e Komunës së Presheves ku kam studiuar të gjitha rastet e divorcit që nga viti 2010 deri në vitin 2015, pastaj në qendrën për punë sociale të Komunës së Preshevës ku kam hulumtuar rastet e divorcit të qifteve me fëmijë, si dhe të dhëna nga Enti statistikor Republikan i Serbisë.

Me metodën deskriptive kam bërë përshkrimin e objektit të këtij hulumtimi. Metodë tjetër që më ka ndihmuar pa masë për të kuptuar thelbin e divorcit shkaqet dhe pasojat e divorcit është metoda e intervistës përmes së cilës kam realizuar intervista të shumta me çifte të divorcuara si dhe persona që mirren me procedurën e divorcit si gjygjëtar, avokat. Me metodën e studimit të rastit do të trajtoj raste konkrete nga lëndët e shikuara në Gjykatën Themelore të Preshevës si dhe raste nga Qendra për Punë Sociale për periudhën 2010-2015.

Rëndësia e këtij punimi përveq vlerës shkencore është edhe e një rëndësie shumë të veçantë pasi është hulumtimi i parë që bëhet për divorcin në Komunë të Preshevës. Rëndësia e këtij hulumtimi është e madhe pasi jep njohuri dhe të dhëna të sakta mbi divorcin, na ndihmon ta kuptojmë thelbin e institucionit të divorcit, poashtu edhe të shohim arsyet e vërteta që qojnë në shkurorëzim si dhe pasojat që lindin prej saj. E një rëndësie të veçantë është se ky punim tregon aktualitetin e divorcit në Komunën e Preshevës për periudhën 2010-2015. Si dhe gjithashtu ka rëndësi pasi që do të qet në pah mangësitë apo parregullësitë e ligjit apo procedurave të divorcit e që vetëm duke i determinuar këto mangësi do të mund përmiresohen.

Përmes këtij punimi do të kuptojmë se sa është numri i saktë i divorceve për vitin 2010, 2011, 2012, 2013 dhe për vitin 2014,2015, sa vite kanë zgjatur këto martesë që kanë përfunduar me divorc, poashtu a kanë pasur fëmijë apo ajo, nëse po nga sa fëmijë dhe moshën e fëmijëve dhe kujt i janë besuar nënës apo babait, si është bërë ndarja e pasurisë etj.



# NË PËRGGJITHËSI PËR SHKURORËZIMIN

## 1.SHKURORËZIMI

### 1.1.Kuptimi i shkurorëzimit

Shpresa e dhëndrit dhe nusës bashkë me premtimin që i japin njëri tjetrit për të qenë bashkë deri në fund të jetës jo gjithmonë realizohet. Martesa është bashkësi ndërmjet një burri dhe gruaje në të cilën dominon apo do të duhej të dominonte harmonia, respekti, dashuria, toleranca e mëshira. Kur këto gjëra në një martesë mungojnë atëherë jetesa e përbashkët e çiftit fillon të bëhet e vështirë dhe e padurueshme gjë që shpie edhe deri te divorci. Sikurse martesa edhe divorci është një e drejtë e njeriut.

Mbarimi i martesës i referohet fakteve juridike që burojnë nga vullneti i bashkëshortëve, njërit ose të dyve e cila detyrimisht duhet të bëhet në rrugë gjyqësore. Në këtë rast autoriteti gjyqësor ka si detyrë që, nëse vendimi është pro zgjidhjes së martesës, të keta krujar bindjen gjatë procesit, se ka ndodhur një lloj dëmtimi i tillë në raportin martesor që jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës apo për të dy bashkëshortët. Pra nuk asnjë shpresë për kthim mbrapa, dhe pasi gjyqtari krijon bindjen e vërteton këtë përfundimisht në vendimin gjyqësor.<sup>1</sup> Shkurorëzimi është zgjidhje e një martese të vlefshme. Shkurorëzimi ndryshe njihet edhe si divorc që ka prejardhjen nga fjala latine divortium që do të thotë ndarje.

Divorci nënkupton zgjidhjen e një martese të plotëfuqishme gjatë jetës së bashkëshortëve, në procedurë gjyqësore, për shkaqe të parashikuara me ligj.<sup>2</sup> Dy bashkëshortët kanë të drejta të barabarta edhe gjatë shkurorëzimit. Qëllimi i kësaj është mënjanimi i të gjitha formave të diskriminimit të gruas, i cili ka qenë i vrazhdë në periudha të caktuara të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Në antikë kur gruaja nuk lindte fëmijë sidomos djalë burri detyrohej edhe kundër vullnetit të tij, për ta zgjidhur martesën. Për shkelje të besnikërisë bashkëshortore sanksionet ndaj gruas ishin drakoniane madje ajo dënohej edhe me vdekje.<sup>3</sup>

Divorci dallon thelbësisht nga anulimi i martesës, sepse anulimi i martesës është zgjidhje e një martese të pavlefshme ndërsa divorci është zgjidhje e një martesë të vlefshme. Anulimi i martesës ekziston kur nuk janë plotësuar kushtet e parashikuara me ligj për vlefshmërinë e martesës. Ndërsa kur martesa është e vlefshme, ajo mund të zgjidhet me divorc.<sup>4</sup> Vlen të theksohet se përveq divorcit, edhe vdekja e bashkëshortit apo shpallja e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur janë mënyra të zgjidhjes së martesës së vlefshme.

Divorci zakonisht përkufizohet si zgjidhje e martesës së vlefshme, gjatë jetës së bashkëshortëve, për shkaqe të parashikuara me ligj dhe në procedurë gjyqësore (me vendim të gjykatës).<sup>5</sup> Divorci është shumë stresues pasi çifti duhet të bëjë edhe ndarjen e pasurisë, nëse kanë fëmijë gjykata vendos ëshë për kujdestarinë e fëmijëve n.q.s nuk ka marrëveshje, pastaj alimentacioni etj. Divorci (apo zgjidhja e martesës) është përfundimi i martesës së vlefshme me vendim të organit kompetent me procedurë të paraparë me ligj, pra divorci sjell shpërbërjen e lidhjes martesore ndërmjet një çifti të martuar sipas ligjit të një vendi apo shteti të caktuar.

<sup>1</sup> Arta Mandro, vep. E cit, fq.301

<sup>2</sup> Abdulla Aliu, vep. E cit, fq.158

<sup>3</sup> Hamdi Podvorica, vep. E cit, fq.117

<sup>4</sup> Abdulla Aliu, Po aty

<sup>5</sup> Gani Oruçi, vep. E cit, fq.88

Ligjet që rregullojnë institucionin e divorcit ndryshojnë nga shteti në shteti por në shumicën e tyre kërkohet sanksionimi nga ana e gjykatës pra kërkohet që me vendim gjykate të bëhet zgjidhja e martesës.

Të vetmet vende që nuk e lejojnë divorcin janë Filipinet dhe Vatikani. Vendet të cilat e kanë legalizuar vonë divorcin janë: Italia (1970), Portugalia (1975), Brazili (1977), Spanja (1981), Argjentina (1987), Paraguaj (1991), Kolumbia (1991), Irlanda (1996), Kili (2004) dhe Malta (2011).<sup>6</sup>

## 1.2.Veqoritë e shkurorëzimit

Për ti theksuar veqoritë e divorcit duhet të ndalemi tek përkufizimi i divorcit. Më lart divorcin e përkufizuar si zgjidhje të martesës së vlefshme, gjatë jetës së bashkëshortëve, për shkaqe të parashikuara me ligj dhe në procedurë gjyqësore( me vendim të gjykatës). Nga përkufizimi i tillë mund të nxjerrim disa veqori të divorcit:

- a) ekzistimi i martesës së vlefshme,
- b) divorci bëhet vetëm sa të jenë gjallë bashkëshortët,
- c) shkurorëzimi bëhet për shkaqe të parashikuara me ligj,
- ç) divorci bëhet në procedurë gjyqësore.<sup>7</sup>

*Ekzistimi i martesës së vlefshme* - është një karakteristikë e divorcit sepse mund të bëhet vetëm shkurorëzimi i martesës së vlefshme. Nëse martesë është e pavlefshme ajo mund të anulohet dhe nuk ka shkurorëzim. Nëse ekzistojnë në të njëjtën kohë edhe shkaqet e anulimit edhe shkaqet e divorcit atëherë së pari sqarohen shkaqet e anulimit dhe zhvillohet procedura e anulimit të martesës. Kjo është e vetëkuptueshme se askush nuk mund të lidhë martesë në kundërshtim me ligjin. Prandaj edhe shkaqet e anulimit kanë përparësi ligjore në raport me shkaqet e shkurorëzimit.Kështu që martesë e vlefshme mund të zgjidhet me shkurorëzim.<sup>8</sup>

*Shkurorëzimi bëhet sa të jenë gjallë bashkëshortët* - Kjo është një veqori tjetër e divorcit, nga se shkurorëzimi mund të bëhet vetëm sa të jenë gjallë bashkëshortët.Nëse njëri bashkëshort vdes atëherë martesë pushon (shuhet) me vdekje si mënyrë natyrore e zgjidhjes së martesës.Prandaj në rastin e tillë nuk ka nevojë për shkurorëzim.Në qoftë se ka filluar procedura e divorcit por ndërkohë njëri bashkëshort vdes gjatë zhvillimit të procedurës, trashëgimtarët mund ta vazhdojnë procedurën e shkurorëzimit.Mirëpo gjykata nuk merr vendim për shkurorëzim sepse martesë ka pushuar me vdekje, por vetëm se konstatohet se a ka qenë padia e bazuar,Andaj divorci mund të bëhet vetëm sa të jenë gjallë bashkëshortët.

*Shkurorëzimi bëhet për shkaqe të parashikuara me ligj* - Si rregull martesë lidhet me vullnetin e lirë të bashkëshortëve.Mirëpo bashkëshortët edhe pse e lidhin martesën me vullnetin e lirë nuk do të thotë se ata mund të kërkojnë divorc pa ndonjë shkak të justifikuar.Ligjvënësi me qëllim të mbrojtjes së martesës dhe familjes i ka paraparë kushtet për të cilat bashkëshortët mund të kërkojnë divorc.Sipas Ligjit të Familjes neni 41 bashkëshortët mund të kërkojnë divorc kur marrëdhëniet janë çrregulluar seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme ose nëse jetesa në bashkësi martesore është bërë e pamundur për bashkëshortët.<sup>9</sup>

<sup>6</sup> Gani Oruçi, vep. E cit, fq.88

<sup>7</sup> Abdulla Aliu, vep. E cit, fq.158

<sup>8</sup> Po aty

<sup>9</sup> Ligji i Familjes i RS(Gazeta zyrtare e R.Serbisë 18/2005 dhe 72/2011)

*Shkurorëzimi mund të bëhet vetëm me procedurë gjyqësore* - Kjo është një karakteristikë tjetër e divorcit e cila nënkupton faktin se divorci mund të bëhet vetëm para gjykatës dhe me procedurën e parashikuar me ligj. Në të gjitha legjislacionet pozitive në botë divorci bëhet me procedurë gjyqësore. Martesa konsiderohet e zgjidhur kur vendimi i gjykatës bëhet i plotëfuqishëm.<sup>10</sup>

### **1.3. Shkurorëzimi dhe religjioni**

Të trija fetë kanë ndryshime të dallueshme në qëndrimet e tyre kundrejt shkurorëzimit. I gjithë Krishterimi e ka neveritur shkurorëzimin. E drejta kanonike, si pjesë e së drejtës së përgjithshme në feudalizëm, zë vend të rëndësishëm në të gjitha shtetet e krishtera. Rëndësinë më të madhe e kishte në periudhën prej shek. XI deri në shek. XV.

E drejta kanonike (*ius canonici, ius ecclesiasticum*) është e drejtë krishtare. Kjo është një tërësi e normave juridike të nxjerra nga kasha e krishterë (katolike dhe ortodokse) për rregullimin e marrëdhënieve përbrenda kishës (siç janë organizimi i kishës, rendi hierarkik, marrëdhëniet ndërmjet klerikëve, marrëdhëniet ndërmjet klerikëve dhe personave të tjerë që i takonin kishës, inkriminimi i veprave penale kundër kishës dhe religjionit si dhe parashikimi dhe mënyra e zbatimit të dënimeve kishtarë e të ngjashme) si dhe për rregullimin e disa lëmenjve juridikë që pjesërisht ose tërësisht binin në juridiksion të kishës si, bie fjala, çështjet martesore, familjare, trashëgimtare si dhe çështjet civile-juridike lidhur me personat e kishës dhe personave që jetonin në to. Pikëpamjet dhe tendencat e dominimit të kishës mbi shtetin apo të shtetit mbi kishën kanë shërbyer si shkak i grindjeve dhe përçarjeve të kishave. Më në fund, më 1054, u shkaktua edhe ndarja definitive e kishës: në atë Lindore (greko - ortodokse) dhe në atë Perëndimore (romako - katolike).<sup>11</sup>

Në Lindje u ruajt tradita e cezaropapizmit, që do të thotë se perandori ndërhynte në çështjet kishtarë si bie fjala kryesonte sinodhin (kuvendin e kishës) dhe i vërtetonte vendimet e tij, me konstitucione rregullonte materien që rregullohet me të drejtën kanonike, madje edhe ndërhynte në çështjet e komentimit të dogmës fetare. Ndërsa në Perëndim kasha kishte përballë një shtet gjysmë barbar dhe të imtësuar, pa traditë dhe pa inteligjenci autoktone. Kisha kishte përparësi ndaj këtij shteti dhe pushteti, i shërbente si model i organizimit me përkufizime të qarta juridike, me klerikë të arsimuar, për të cilët shteti kishte shumë nevojë, ishte me plot traditë dhe përvojë për organizimin e administratës. Duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana historike, mund të konkludohet se në Perëndim kisha i imponohej shtetit dhe se ky ngeli në njëfarë vartësie nga kisha. Nga kjo që u tha më sipër mund të përfundohet se kisha e krishterë dhe shteti, qoftë në Perëndim apo në Lindje, në periudhën e feudalizmit kanë qenë të pandashme, të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, plotësoheshin dhe ndihmoheshin reciprokisht.<sup>12</sup>

Burimet themelore ose të përgjithshme të së drejtës kanonike janë:

- 1) Shkrimi i Shenjtë,
- 2) Tradita apostolike dhe kishtarë,
- 3) Legjislacioni kishtar dhe
- 4) E drejta zakonore.

---

<sup>10</sup> Gani Oruçi, vep. e cit, fq.89

<sup>11</sup> <http://permalink.gmane.org>

<sup>12</sup> Po aty

Shkrimi i Shenjtë ose Bibla është burimi themelor i fesë së krishterë, por njëherësh edhe i drejtës kanonike. Sipas besimit të krishterë, Bibla është Shpallja e Perëndisë, që përbëhet nga Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re. beslidhja e Vjetër, tekstet e së cilës datojnë që nga shekulli VIII p.e. së re e deri në paraqitjen e Krishtit, është pjesërisht burim i së drejtës kanonike, e në veçanti parimet më të larta morale të saj, por vetëm ato të cilat kisha shprehimisht i ka akceptuar. Besëlidhja e Re, tekstet e së cilës datojnë që nga Krishti, është e një rëndësie të veçantë dhe në tërësi paraqet burimin themelor të së drejtës kanonike. Kisha lindore ortodokse përdor përkthimin e autorizuar të Besëlidhjes së Vjetër të quajtur septuaginta dhe tekstin original në greqishte të Besëlidhjes së Re. Ndërkaq kisha perëndimore romako – katolike përdor përkthimin e autorizuar në latinishte të Biblës të quajtur Vulgata.

Tradita apostolike dhe kishtare. Me termin traditë (traditio) nuk duhet kuptuar vetëm formën e jashtme të transmetimit të normave gjatë shekujve, por mënyrën trashëguese të ruajtjes në kishë të parimeve themelore të mësimit dhe rregullimit të jetës së krishterë nga ana e brendshme dhe e jashtme e saj. Kështu, p.sh., apostulli Pjetri u jep udhëzime anëtarëve të kishës që ta ruajnë dhe ta mbajnë mend gjithë atë që ua kishte përcjellë edhe gojarisht edhe me shkrim. Apostujt me fjalët e tyre të gjallë ose me shembujt e tyre personale gjatë punës dhe veprimeve të tyre themeluese krijuan rregulla ose norma që njihen si Tradita Klerikale.<sup>13</sup>

Legjislacioni si burim i së drejtës. Ndër burimet e rëndësishme të përgjithshme të së drejtës kanonike është edhe legjislacioni, i cimi, pa dyshim, është edhe burimi më i pasur i saj. Organi nëpërmjet të të cilit kisha e shpreh vullnetin e vet legjislativ është Kuvendi i Përgjithshëm. Që nga shekulli IV e deri në shekullin IX janë mbajtur disa kuvende të mëdha kishtare, në të cilat janë shqyrtuar shumë çështje të ndryshme që kryesisht kanë të bëjnë me administratën kishtare dhe me disiplinën. Normat të cilat janë nxjerrë në këto kuvende fituan karakter të përgjithshëm, fituan fuqinë e detyrueshme të ligjit pozitiv për të gjithë anëtarët e kishës. Pushteti shtetërorë, prej se u bë i krishterë, i pranoi dhe nga ana e vet i vërtetoi normat e nxjerra nga kisha, duke ua dhënë atyre autoritetin e ligjeve shtetërorë. Gjatë gjashtë shekujve gradualisht u krijua kodeksi themelor kishtar dhe në Kuvendin e Madh të Trulit (692), pastaj në Kuvendin VII të Përgjithshëm Kishtar (787), u proklamua përbërja e plotë e tij dhe u përcaktua vlera kanonike e monumenteve të ndryshme të legjislacionit kishtar, të cilat ishin krijuar gjatë kësaj periudhe, që me të drejtë quhet periudha kuvendore.Paralelisht me legjislacionin kishtar, si burim i së drejtës kanonike shërben edhe legjislacioni shtetërorë ose laik (qytetarë). Legjislacioni shtetërorë kishës i shërben si burim i jashtëm i së drejtës së saj.<sup>14</sup>

E drejta zakonore si burim i së drejtës kishtare - Zakoni patjetër duhet ti plotësojë kushtet që të jetë i pranuar si burim i së drejtës kishtare: duhet patjetër të jetë në pajtueshmëri me frymën dhe thelbin e të tërë kishës dhe institucionit që ka të bëjë me të dhe duhet patjetër të pranohet se ai ekziston një kohë të gjatë. Dhjata e Re në mënyrë të përcaktuar qartë mbron pazgjidhshmërinë e martesës. Ky ideal i pakompromis, padyshim që është irealist. Ajo merr një gjendje morale përkryeshmërie që shoqëritë njerëzore nuk e kanë pasur kurrë. Kur një çift e sheh që jeta e tyre martesore ka pësuar të çarë, një dëbim me shkurorëzim nuk i bën atyre ndonjë të mirë. Duke i detyruar me forcë çiftin që të qëndrojnë së bashku kundra dëshirës së tyre nuk është as efektive, as e arsyeshme. Nuk është ndonjë habi që e gjithë bota e krishterë ka qenë e detyruar të sanksionojë shkurorëzimin (divorcin).<sup>15</sup>

<sup>13</sup> Hilmi Ismaili Fatmir Sejdiu, vep.e cit, fq.185

<sup>14</sup> Po aty

<sup>15</sup> Po aty

Judaizmi nga ana tjetër, e lejon shkurorëzimin qoftë edhe pa asnjë shkak. Dhjata e Vjetër i jep të drejtën bashkëshortit ta shkurorëzojë gruan e tij edhe sikur ai të mos e pëlqejë atë: *“Kur dikush martohet dhe jeton me të si me grua, por pastaj ajo nuk i pëlqen më, sepse ka gjetur diçka të pahijshme në të, i shkruan vërtetimin e lëshimit, ia jep në dorë dhe e dëbon prej shtëpisë, dhe ajo si të ketë dalë prej tij, martohet me një tjetër, por edhe atij nuk i pëlqen dhe i jep edhe ai dëftesën e ndarjes dhe e hedh prej shtëpisë së vet, ose ndoshta vdes, burri i parë nuk mund ta marrë atë për grua, sepse ajo ka qenë përdhosur”*. Vargjet e mësipërme kanë shkaktuar shumë debate të konsiderueshme ndërmjet dijetarëve judaikë për shkak të mospajtimit në interpretimin e fjalëve “nuk i pëlqen” dhe “të pahijshme” të përmendura në vargjet. Talmudi regjistron opinionet e tyre të ndryshme: *“Shkolla e Shamait mban qëndrimin që një burrë nuk mund ta shkurorëzojë gruan e tij deri sa ai ta gjejë atë fajtoreshë për sjellje jo të mira seksuale, ndërsa shkolla e Hilelit thotë që ai mund ta shkurorëzojë atë edhe nëse ajo i ka thyer thjesht një pjatë atij. Rabini Akiba thotë se ai mund ta shkurorëzojë atë edhe sikur ai thjesht të gjejë një tjetër grua më të bukur se ajo”*. Dhjata e Re ndjek mendimin e Shamaitëve ndërsa Ligji Judaik ka ndjekur mendimin e Hilalitëve dhe të R. Akiba.<sup>16</sup>

Qysh kur këndvështrimi Hilalit mbizotëroi, ai u bë tradita e pathyeshme e Ligjit Judaik duke i dhënë bashkëshortit lirinë e shkurorëzimit të gruas së tij pa pasur ndonjë shkak të dukshëm. Dhjata e Vjetër jo vetëm i jep të drejtën bashkëshortit ta shkurorëzojë gruan e tij “të papëlqyeshme” por e njeh detyrim që të shkurorëzuarën ta quajë “bashkëshorte të keqe”: *“Shpirt i përrulur, fytyrë e trishtuar e plagë në zemër është gruaja e keqe. Duar të mekura e gjunj të këputur, gruaja që s’e bën të lum burrin e vet. Prej gruas zuri fill mëkatie për faj të saj të gjithë vdesim. Ujit mos i lër dalje, as më të voglën, as liri të flasë gruas së keqe. Nëse nuk sillet sikurse i thua, do të të turpërojë në sy të armiqve; ndaje prej trupit tënd dhe nise prej shtëpisë sate”* Talmudi ka regjistruar veprime të ndryshme specifike prej grave, të cilat i kanë detyruar bashkëshortët e tyre t’i shkurorëzojnë ato: *“Nëse ajo han në rrugë, nëse ajo pin me lakmi në rrugë, nëse ajo i jep gji fëmijës në rrugë, për çdo rast Rabini Meir thotë se ajo duhet të largohet nga burri i saj”*. Talmudi e ka bërë gjithashtu atë mandatar që ta shkurorëzojë gruan shterpë (që nuk lind fëmijë në një periudhë prej dhjetë vjetësh): *“Rabinët thonë: Në qoftë se një burrë merr një grua dhe jeton me atë për dhjetë vjet dhe ajo nuk i lind fëmijë, ai duhet që ta shkurorëzojë atë”*. Gratë, nga ana tjetër, nuk mund ta fillojnë shkurorëzimin nën Ligjin Judaik.<sup>17</sup>

Një grua hebreje, sidoqoftë mund ta pretendojë të drejtën e shkurorëzimit përpara një gjyqi judaik e pajisur me një arsye të fortë ekzistuese. Shumë pak baza janë parashikuar për gruan që të ketë pretendime për shkurorëzim. Këto baza përfshijnë: Një bashkëshort me defekte fizike ose i paafte, një bashkëshort që nuk i plotëson përgjegjësitë e tija bashkëshortore etj. Gjyqi mundet që ta mbështesë pretendimin e gruas për shkurorëzim por nuk mundet ta zgjidhi martesën. Vetëm burri mund ta zgjidhi martesën duke i dhënë gruas së tij letrën e shkurorëzimit. Gjyqi mundet ta përndjeki, ta gjobisi, ta burgosi dhe ta përjashtojë atë për ta detyruar të japi letrën e nevojshme të shkurorëzimit për gruan e tij. Megjithatë, nëse burri është aq kokëfortë saqë ai mundet ta refuzojë dhënien e shkurorëzimit gruas së tij dhe ta mbajë atë të lidhur me të në mënyrë të papërcaktuar. Më e keqja vazhdon kur ai mund ta braktisi atë pa i dhënë asaj shkurorëzimin dhe ta lejë atë të pamartuar dhe të pashkurorëzuar. Ai mundet që të martohet me një tjetër grua ose edhe të jetojë me çdo beqare jashtë kurore dhe të ketë fëmijë prej saj (këto fëmijë quhen të ligjshëm nën Ligjin Judaik). Nga ana tjetër, gruaja e braktisur nuk mund të martohet me ndonjë burrë tjetër deri sa ajo është përsëri e martuar ligjërisht dhe nuk mundet që të jetojë me ndonjë

<sup>16</sup> [www.de.slideshare.net](http://www.de.slideshare.net)

<sup>17</sup> Po aty

burrë tjetër sepse ajo do të quhet një shkelëse kurore dhe fëmijët e saj nga ky bashkim do të ishin të paligjshëm për dhjetë breza. Një grua në një pozicion të tillë quhet agunah (grua e mbërthyer me zinxhirë). Në Shtetet e Bashkuara sot gjenden përafërsisht 1.000-1.500 gra hebreje që janë agunot (shumës për agunah) ndërsa në Izrael numri i tyre mund të jetë më i lartë se 16.000. Burrat mundet që t'u shkëpusin me mijëra dollarë prej grave të tyre të zëna në kurth në shkëmbim për shkurorëzimin judaik.<sup>18</sup> Martesat në përgjithësi nuk rezultojnë të kenë përfundim të gëzueshëm dhe të lumtur.

Me gjithë përpjekjet që bëjnë bashkëshortët për kapërcimin e vështirësive të paparashikuara, vjen moment që jeta bashkëshortore bëhet e padurueshme. Në të tilla raste feja islame parashikon masa për parandalimin e divorcit. Problemet e lindura duhet të trajtohen që të zgjidhen kontradiktat në mes bashkëshortëve. Në pamundësi për zgjidhjen e kontradiktave midis çiftit, atëherë lejohet divorci.<sup>19</sup> Islami i kushton kujdes të veçantë martesës dhe marrëdhëniet martesore, veçanërisht e ruan dhe kujdeset për harmoninë martesore dhe me plot kujdes tenton dhe mundohet që ta ruaj bashkësinë martesore nga shkatërrimi. Shkurorëzimi i martesës bëhet e lejuar vetëm kur nuk ka mënyrë tjetër që çifti bashkëshortor të ruajë pajtimin dhe harmoninë.<sup>20</sup> Detyrë e çdonjërit prej bashkëshortëve është që të sillet mirë ndaj partnerit të tij jetësor dhe ti shfrytëzojë të gjitha mundësitë në përfundimin e bashkësisë martesore dhe të mundohen të shpëtojnë martesën atëherë kur, eventualisht dalin problem të cilat mund të sjellin deri të shkatërrimi i bashkësisë martesore.<sup>21</sup>

Me shprehjen shkurorëzim (Et-Talak) në të drejtën islame nënkuptojmë prishjen e kontratës së martesës përmes aktit konkret apo nënkuptues.<sup>22</sup> Pra feja islame na mëson dhe këshillon që një çift të mos divorcohet nëse nuk ka ndonjë arsye të fortë, në të kundërtën do të ishte i dëmshëm dhe ketë gjë muslimanëve ua ndalon feja e tyre ua ndalon që t'i shkaktojnë dëm ose ta lëndojnë njëri-tjetrin. Pra Islami e parashef divorcin si zgjidhje të fundit vetëm kur kontradiktat mes çiftit është e pamundur që të zgjidhen apo shmangen. Edhe në këtë rast nga Pejgamberi (s.a.v.s.) është emëruar si gjëja më e urryer te Zoti (xh.sh.), nga të gjitha gjërat e lejuara.<sup>23</sup>

Shkaqet apo arsyet e shkurorëzimit sipas të drejtës islame - Islami i jep të drejtën burrit për Talak (shkurorëzim). Divorci lejohet në ato raste kur njëri nga bashkëshortët nuk është i mirë dhe nuk mund t'i përmirësojë gabimet e tij dhe të respektojë njëri tjetrin, kur njëri është i pamoralshëm, ose kur sillet ashpër deri në fyerje rrahje. Në këto raste prishet harmonia dashuria fillon të zbehët dhe në zemrat e tyre fillon të zërë vend urrejtja.<sup>24</sup> Në disa raste, një grua muslimane me shumë vullnet kërkon ta ruajë martesën e saj por e gjen vetveten të detyruar të kërkojë shkurorëzimin për shkak të disa arsyeve shtrënguese të tilla si: mizoria e të shoqit, braktisje pa asnjë arsye, një bashkëshort që nuk përmbush përgjegjësitë bashkëshortore etj.

Islami i garanton gruas të drejtën ta zgjidhi martesën brenda asaj që quhet Khula'. Ajo mund ta përfundojë martesën brenda Khula' dhe ajo mund të japi kompensim për shkurorëzimin. Situatat që bëjnë të lejueshëm shkurorëzimin e gruas për burrin, janë "kufinj të që përcaktoi Allahu". Në se midis bashkëshortëve urrejtja, pashkueshmëria e rëndë, impotencia e marrëdhëniet e bëjnë të pamundur vazhdimin e martesës; edhe kur potencës së marrëdhëniet nuk i jepet mundësi për shkak të urrejtjes; gjendje të tilla i përngjajnë një zinaje.

<sup>18</sup> www.de.slideshare.net

<sup>19</sup> Muhammed Kutub, vep. E cit, fq.38

<sup>20</sup> Dr.Shefik Kurdiç, vep. E cit, fq.63

<sup>21</sup> Po aty

<sup>22</sup> E drejta familjare në Islam, grup autorësh, Shkup 1996, fq. 299

<sup>23</sup> Dr. Hamude Abdul'Ati, vep.E cit, fq. 227

<sup>24</sup> Po aty

Në periudhën e Shejhu'l-Islamit Hajri Efendi, me rregullimet përkatëse sipas Hejeti Telifijes, të legalizuara me protokollin e datës 10 mars 1333 me anë të Kryesisë së Fetvasë, të pranuar zyrtarisht në po atë datë nga Dekreti Juridik i Familjes; në bazë të këtyre, në kushtet e poshtëshkruara, gruaja mund të kërkojë shkurorëzimin nga i shoqi në këto raste:<sup>25</sup>

1. E privuar nga afërsia martesore për shkak të të metave që konstaton si sëmundje tek i shoqi, gruaja ka të drejtë të kërkojë ndarjen duke iu drejtuar gjykatësit (neni 119). Në se sëmundja e burrit është e pamjekueshme, gjykatësi merr vendim të menjëhershëm për ndarje. Po qe e mjekueshme, njihet një vit kohë mjekimi. Në se brenda kësaj periudhe nuk shfaqet ndonjë përmirësim dhe gruaja ngulmon në kërkesën e saj, edhe po s'që dakord i shoqi, gjykatësi vendos ndarjen (neni 121).
2. Në kushtet kur burri është i prekur nga infeksione kronike të lëkurës ose sëmundje veneriane të cilat është e pamundur të lejojnë një bashkëjetesë të padëmshme, gruaja mund të kërkojë ndarjen sapo të zbulojë njërin nga këto sëmundje tek i shoqi. Po pati shpresë mjekimi, njihet një vit kohë, në të kundërt, bëhet ndarje e menjëhershme (neni 122).
3. Pas aktit të kurorës, në se burri pëson çrregullime mendore dhe gruaja i paraqet gjykatësit kërkesën për ndarje, shtyhet një vit. Në se brenda kësaj periudhe çrregullimet nuk zhduken, vendoset ndarja (neni 123).
4. Përveç këtyre, kur burri humbet pa lënë gjurmë dhe të ardhurat e jetesës bëhen të pamundura, pas hetimeve të nevojshme, gjykatësi vendos ndarjen mbi bazën e kërkesës së gruas (neni 126).
5. Në se personi i humbur ka lënë pasuri që mundëson jetesën dhe gruaja bën kërkesë për ndarje, gjykatësi bën hetime në lidhje me atë person. Pas çastit kur humbasin shpresat për të marrë njoftim mbi vendndodhjen ose jetën a vdekjen e personit, caktohet afati i pritjes prej katër vjetësh. Brenda kësaj periudhe, në se nuk merret ndonjë lajm dhe gruaja ngulmon në kërkesën e saj, gjykatësi vendos ndarjen (neni 127) Kjo periudhë largimi midis burrit e gruas, konsiderohet ndarje.
6. Në se midis bashkëshortëve nxjerr krye e pashkuara dhe njëra nga palët i drejtohet gjykatësit, ky i fundit kërkon nga familjet e të dy palëve nga një përfaqësues si arbitër. Po qe e pamundur një gjë e tillë nga njëra apo të dyja palët, gjykatësi cakton një person nga të tjerët. Ky kuvend familjar, i sajuar në këtë mënyrë, dëgjon palët dhe përpiqet të gjejë pikat e bashkimit. Në pamundësi të kësaj, po qe fajtor burri, bëhet ndarja. Po qe fajtorë gruaja, e gjithë sasia e garancisë së kurorës ose një pjesë e saj i kalohet burrit dhe vendoset ndarja.<sup>26</sup>

Llojet e shkurorëzimit sipas të drejtës islame - Dijetarët shkurorëzimin e kanë ndarë në dy lloje:

- 1) shkurorëzimi me të drejt kthimi ( Talak rekh'ij) dhe
- 2) shkurorëzimi përfundimtar ( Talak Bain).

Shkurorëzimi përfundimtar ndahet në dy kategori:

- 1) ndarje e vogël ( bain bejnune sugra) dhe
- 2) ndarje e madhe ( bain bejnune kubra).<sup>27</sup>

<sup>25</sup> Dr. Hamude Abdul'Ati, vep.E cit, fq. 227

<sup>26</sup> <http://forumi.kurandhesunet.net/>

<sup>27</sup> Muhamed Ahmed Ken'an, vep. E cit, fq. 272

*Shkurorëzimi me të drejtë kthimi ( Talaku rehx'ij)* - Shkurorëzimi me të drejtë kthimi ( talak rehx'ij) është shkurorëzimi i cili nuk mënjanon dispozitat e bashkëshortësisë e as që pezullon të drejtën e bashkëshortit. Bashkëshortësia akoma vazhdon të mbetet përderisa gruaja ( e shkurorëzuar) është në ditët e iddetit( ditët e pritjes), andaj burri duhet ta rikthejë brenda kësaj periudhe. Nëse nuk e rikthen brenda periudhës së iddetit, atëherë ajo në këtë rast ndahet, me ç'rast ky nuk posedon të drejtë rikthimi pos me pëlqimin paraprak të gruas dhe ngritjes së një kontrate të re juridike. Ky lloj shkurorëzimi mund të bëhet me fjalë që përmbajnë domethënie të qartë për shkurorëzimin si p.sh. “ ti je e shkurorëzuar”, apo “ të kam shkurorëzuar”.<sup>28</sup>Gruaja e cila është shkurorëzuar para se të ketë marrëdhënie seksuale me burrin – nuk ka idet për shkak të fjalëve të Allahut subhanehu ve teala, : ‘‘O ju që besuat , kur të keni lidhur kurorë me besimtare e pastaj i lëshoni ato para se të keni kontaktuar me to , ju nuk keni të drejtë të kërkoni që ato të presin afatin e caktuar ( idetin) , po jepuni diçka atyre dhe lironi në mënyrë të njerëzishme .<sup>29</sup>

*Shkurorëzimi përfundimtar ( talaku bain)* - Pra, siç thamë edhe më herët se shkurorëzimi përfundimtarë ndahet në dy kategori: ndarje e vogël ( bain bejnune sugra) dhe ndarje e madhe ( bain bejnune kubra).

*Shkurorëzimi apo ndarja e vogël ( bain bejnune sugra)* - Nëse gruas pas shkurorëzimit me të drejtë kthimi ( talak rehx'ij) i kalon kohë pritja ( iddeti ) ndërsa burri nuk e rikthen në jetën bashkëshortore, apo e lëshon sërish pas rikthimit të parë, atëherë ky shkurorëzim shndërrohet në bain bejnune sugra, që do të thotë se, burri më nuk e posedon të drejtën e rikthimit pa kontratë të re. Para përsëritjes së kontrates së re është i ndaluar takimi dhe qëndrimi i tyre në vetmi.

*Shkurorëzimi apo ndarja e madhe ( bain bejnune kubra )* - Nëse burri nuk e rikthen gruan pas lëshimit bain bejnune sugra ndërsa kalon periudha e iddetit, apo, e rikthen dy herë dhe sërish e lëshon, ose, nëse në një kuvend burri e përsërit tri herë shprehjen “e lëshuar”, qoftë edhe me ndonjë shenjë që i jep kuptimësi treshit, si përshebull, tri herë rresht ia përsëritë se është e lëshuar, apo, duke i thënë se është e lëshuar njëkohësisht ngritë edhe tre gishtat e dorës, atëherë ky shkurorëzim konsiderohet bain bejnune kubra.<sup>30</sup> Ky lloj shkurorëzimi nuk lejon më rikthim, madje, as me kontratë të re. Në këtë rast rikthimi mund të vie në shprehje vetëm pasi gruaja e lëshuar për të tretën herë martohet dhe vë kurorë të shëndoshë me ndonjë tjetër me të cilin ka marrëdhënie të plota seksuale dhe, nëse edhe prej këtij burri lëshohet, pra, vetëm atëherë pas kalimit të periudhës së iddetit burri i mëparshëm mund ta rikthejë gruan edhe atë, nëse vetë ajo shpreh dëshirë për t'u rikthyer. Këtë e mbështesin në citatin kur'anor ku Allahu xh.sh. në lidhje me këtë thotë: “E në qoftë se ai (burri) e lëshon atë (për herë të tretë), pas atij (lëshimi) nuk lejohet më derisa të martohet ajo për një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e lëshon atë, atëherë për ata dy, po qe se mendojnë se do t'i zbatojnë dispozitat e All-llahut, nuk ka pengesë të rikthehen (në bashkëshortësi). Këto janë dispozita të All-llahut që ia sqaron një populli që kupton.”<sup>31</sup>

Mënyrat e shkurorëzimit sipas të drejtës islame - Shkurorëzimi mund të shprehet përmes dy mënyrave apo formave:

- a) përmes shprehjes që në mënyrë të drejtpërdrejtë e sinjalizon ndarjen e plotë,
- b) dhe përmes shprehjes në mënyrë alegorike apo të tërthortë.

<sup>28</sup> Muhamed Ahmed Ken'an, vep. E cit, fq. 272-273

<sup>29</sup> Shejh Salih ibën Salih El-Feuzan vep. E cit, fq.110

<sup>30</sup> Grup autorësh, vep. E cit, fq. 309-310

<sup>31</sup> Kur'an, kaptina El-Bekare, citati 230



*Mënyra e drejtpërdrejtë e shkurorëzimit* - Nëse në mënyrë të drejtpërdrejtë shprehet ndarja apo lëshimi, në këtë rast fuqizohet shkurorëzimi edhe pse ajo bëhet në fakt, pa qëllim. Pra, nëse burri i thotë gruas “je e shkurorëzuar” edhe pse me këtë rast nuk ekziston qëllimi i shkurorëzimit, me këtë shkurorëzimi bëhet i plotëfuqishëm. Në këtë rast, nëse kjo lëndë shqyrtohet në gjyq, përkundër përpjekjeve të burrit për të sqaruar se nuk e ka pasur për qëllim shkurorëzimin, këtë gjykatësi nuk do ta pranojë porse do t’i ndajë që të dy, natyrisht nëse arrinë gruaja t’i vërtetojë fjalët me të cilat është shprehur shkurorëzimi nga ana e burrit të saj.

*Mënyra e tërthortë e shkurorëzimit* - Nga ana tjetër, deri te shkurorëzimi i plotë mund të arrihet edhe nëse ai shprehet në mënyrë alegorike, apo të tërthortë. Ta zëmë, shprehja “shko te familja jote”, edhe pse në shikim të parë me këtë nënkuptohet diç tjetër, po qe se shprehet me nervozizëm apo me arrogancë, në esencë kjo lë të nënkuptosh qëllimin për shkurorëzim.<sup>32</sup> Pra tek ky lloj i shkurorëzimit shikohet edhe qëllimi i njeriut.

Rregullat e islamit për divorcin - Sheriati islam ka caktuar përkufizime të shumta me qëllim që sa më shumë të ngushtojë sferën e shkurorëzimit. Islami ndalon shkurorëzimin që është rezultat i shkaqeve jovalide dhe përfundim i pakonsultuar me të gjitha metodat për zgjidhjen e konfliktit. Gjërat që janë të ndaluar janë:

- Shkurorëzimi që dëmton burrin e gruan dhe që shkatërron interesin e të dyve pa arsye është i ndaluar. Pejgamberi a.s. thotë: “Mos dëmtoni veten e as të tjerët!”
- Divorci i gruas me të përmuajshmet konsiderohet i ndaluar. Koha e përshatshme nënkupton gruan e pastër pa të përmuajshmet, pa nifas dhe të mos ketë patur marrëdhënie seksuale para ciklit të fundit.
- Betimi në shkurorëzim është i ndaluar. Nuk i lejohet muslimanit të betohet në shkurorëzim për ta kryer ndonjë punë, ose t’i kërcënohet gruas së vet me ndonjë çështje e t’i thotë se nëse e bën atë, do ta lëshojë.
- E shkurorëzuara kalon kohën e pritjes në shtëpinë e ish- bashkëshortit të saj. Në sheriatin islam është vaxhib që e shkurorëzuara ta kalojë kohën e pritjes në shtëpinë e vet, gjegjësisht në shtëpinë e ish burrit të saj dhe i ndalohet të dalë jashtë shtëpisë. Gjithashtu edhe burrit i ndalohet ta largojë nga shtëpia pa ndonjë arsye, ngase është i obliguar që gjatë peridhës së pritjes të përpiqet ta rikthejë në qoftë se është divorci i parë apo i dytë.
- Shkurorëzimi i përsëritur. Muslimanit i lejohen tri shpallje të divorcit. Cdo shpallje e divorcit kushtëzohet të bëhet në peridhën e pastërtisë së gruas, kur edhe ska patur marrëdhënie seksuale me të. Burri mund ta shpallë divorcin e gruas një herë dhe të pret kalimin e iddetit. Gjatë periudhës së iddetit, të dy mund të rikthehen pa u rimartuar. Nëse kjo periudhë kalon, atëherë janë plotësisht të divorcuar dhe secili prej tyre ka të drejtë të martohet me ndonjë tjetër ose të rimartohen. Në qoftë se dëshirojnë të rimartohen, atëherë kanë nevojë për kurorëzim të ri. Nëse e lëshon gruan për të tretën herë, atëherë kuptohet se është absurd që të jetojnë së bashku, dhe për këtë shkak nuk i lejohet burrit ta rikthejë pas shpalljes së tretë përderisa gruaja të martohet me një burrë tjetër, edhe atë martesë të jetë ligjore, e vërtetë dhe e qëlluar e jo vetëm për t’ia mundësuar rikthimin te burri i parë.<sup>33</sup>
- Jetë e njerëzishme ose divorc me mirëkuptim. Nëse burri e lëshon gruan dhe kalon periudha e iddetit para burrit ka dy alternative: ose ta rikthejë e të jetojnë jetë të njerëzishme, të mirë e të përmirësuar por jo me qëllim që ta dëmtojë ose torturojë, ose ta

<sup>32</sup> grup autorësh, E drejta familjare në Islam, fq. 311-312

<sup>33</sup> Jusuf Kardavi, vep. E cit, fq. 290

divorcoj me mirëkuptim ta lë në përfundimin e periudhës së iddetit e të ndarjes pa fjalë e thashetheme më fyese dhe pa i shkelur të drejtat që i takojnë njëri-tjetrit.

- Gruaja e shkurorëzuar s' duhet penguar që të martohet me atë që dëshiron. Kur të përfundojë iddeti it ë shkurorëzuarës nuk i lejohet burrit të saj tutorit ose ndokujt tjetër që ta pengojë martesën e saj me atë që dëshiron përderisa i fejuari dhe e fejuara shprehin pëlqimin e tyre për martesë.
- E drejta e bashkëshortës të kërkojë divorc. Gruaja e cila urrenë burrin e vet dhe s' mund të jetojë bashk me të , ka të drejtë të lirohet nga martesa duke ia kthyer burrit të vet mehrin e paguar dhe dhuratat e dhuruara nga ai , ose kthimi do të realizohet varësisht nga pëlqimi i ndërsjellë.<sup>34</sup>
- Ndalohet torturimi i bashkëshortës. Nuk i lejohet burrit ta torturojë gruan e vet me qëllim që ajo të kërkojë ndarje dhe t'ia ktheje pasurinë osë një pjesë të saj, përderisa nuk ka bërë ndonjë amoralitet të dukshëm.

Allahu i Madhëruar u dha fund njëherë e mirë të gjitha traditave që ishin në dëm të grave për çështjen e divorcit . Me ardhjen e Islamit u bë një reformë rrënjësore edhe në këtë pike. Për ta konkretizuar më mire , përmendim :

- 1) Përcaktimi i numrit të rimartesës me gruan e ndarë në dy here , ndërkohë që më pare ka qenë e papërcaktuar ;
- 2) Burri që ndan gruan nuk mund të marrë prej saj asgjë që aim und t'ia ketë dhuruar para dhe gjatë martesës, çfarëdo qoftë ajo , pasi konsiderohet pronë personale e saj ;
- 3) Ndalimi i martesës me një grua të divorcuar në kohën e idetit.<sup>35</sup>

## 1.4. Shkurorëzimi sipas të drejtës zakonore shqiptare

Martesat e lidhura sipas të drejtës zakonore shqiptare përgjithsisht ishin të qëndrueshme . Zgjidhja e martesës ishte dukuri e rrallë, e jashtëzakonshme dhe vështrohej si një fatkeqësi e vërtetë për të dyja palët. Sipas Kanunit të Lumës , “Nusja e marrun nuk lëshohet kollaj”; sipas atij të Mirditës “Gruaja lëshohet veç për të madh gazep”; sipas kanunit të Pukës “Një burrë i mirë e mba një grua të keqe , një grua e mirë e mba një burrë të keq. Numri i pakët i zgjidhjeve të martesave shpjegohet me kushtet ekonomike – shoqërore të trevave shqiptare ku vepronin normat kanunore si dhe me mendësitë dhe moralin patriakal të krijuar mbi bazën e tyre . Në këtë shoqëri , liria e individit për të vendosur mbi vetveten , sidomos e grave , ishte tepër e kufizuar. Interesat vetjake zakonisht u nënshtroheshin interesave të familjes së gjerë patriarkale.

Zgjidhja e martesës sillte ndërlikime të ndryshme për rritjen e fëmijëve , problem pasurore ndërmjet bashkëshortëve , një martesë e re kërkonte shpenzime të reja të cilat mund të ishin të papërbalueshme për familjet e zakonshme etj. Por mbi të gjitha zgjidhja e martesës mund të çonte në armiqësi ndërmjet familjes së burrit e të gruas dhe në zbatimin e gjakmarrjes ndërmjet tyre , si në rastet e parashikuara në kanun , ashtu dhe në ato të paparashikuara. Për këto arsye , normat që rregullonin zgjidhjen e martesës në disa kanune ishin të pakta , si në KLD , në atë të Skëndërbeut dhe në atë të Mirditës. Kjo tregon se institute i zgjidhjes së martesës në këto kanune dhe në krahinat përkatëse nuk ishin përpunuar sa duhet , në dallim nga institutet tjera , që kishin rregullime të hollësishme. Në kufizimin e zgjidhjes së martesës duhet të ketë ndikuar edhe e drejta kishtarë (kanonike) në zonat e fesë së krishtere. Në disa kanune si te a i Lumës , KLD,

<sup>34</sup> Muhamed Rashid Rida , vep. E cit, fq.116

<sup>35</sup> Po aty

variant i Pukës dhe i Labërisë, që përgjithsisht ishin më tolerant , institute i zgjidhjes së martesës ishte disi më i përpunuar dhe përmabnte rregullime më të hollësishme .Sidoqosftë dallimet ishin anësore, kurse qëndrimet parimore përgjithsisht ishin të njëjta.Ndryshimet ekonomiko- shoqërore që ndodhën gjatë shekullit XIX në Perandorinë Osmane , ku përfshihej edhe Shqipëria , të cilat karakterizoheshin nga depërtimi i dobët i elementëve kapitalistë , ndikuan në ndryshimin e disa normave të së drejtës zakonore në krahinën e Labërisë.Këto ndryshime në Kanunin e Labërisë , të cilat lidhen me emrin e Idriz Sulit , një reformator popullor i së drejtës , prekën sidomos institutin e zgjidhjes së martesës.<sup>36</sup>

Sipas normave të vjetra të Kanunit të Labërisë ai që ndante ( çkurorëzonte) bashkëshorten e tij binte në gjak me familjen e saj.Meqenëse kishte shumë vrasje , Idriz Suli formuloi normën e re , sipas së cilës ndarja e gruas ishte e ligjshme.Gruaja vritej vetëm për shkelje të besnikërisë bashkëshortore dhe për asnjë shkak tjetër.Përveç kësaj , Idriz Suli përcaktoi edhe detyrimet e burrit kur zgjidhte martesën në mënyrë të njëanshme.Ai që ndante gruan , detyrohej t'i jepte asaj 49 grosh e një zollotë ( ose një dhi me një bri që ishte e barazvlefshme) , rrobte e martesës dhe 60 okë drithë.Në Kanunin e Labërisë jepej edhe shpjegimi i kuptimit të këtij shpërblimi. Po ti jepeshin gruas 50 grosh plot konsiderohej e ndarë dhe e shkëputur krejtësisht nga burri ; ¼ e groshit që duhej për të plotësuar numrin 50 e mbante atë të lidhur "me fije peri" .Rrobat i jepeshin se ishin prerë për trupin e saj dhe vetë burri kishte thënë "T'i grisësh me shëndet". Drithi i jepej si ushqim për tre muaj .Në qoftë se brenda kësaj periudhe kohe vërtetohej se ajo ishte shtatzanë , burri ishte i detyruar t'i jepte edhe 60 okë drithë për tre muaj të tjerë. Pasi të lindej fëmija , burri ishte i detyruar t'i jepte asaj groshin e fundit dhe kishte të drejtë ta merrte fëmijën , që konsiderohej gjithmonë i atit.Me këtë pritej " peri " simbolik që i lidhte bashkëshortët.<sup>37</sup>

Sipas të drejtës zakonore shqiptare, e drejta e zgjidhjes së martesës i përkiste në mënyrë pothuajse ekskluzive burrit.Sipas Kanunit të Lumës , këtë të drejtë mund ta ushtronte edhe babai i burrit ( vjehri), por ishte i detyruar t'i gjente të birit një grua tjetër.Zakonisht vendimi për zgjidhjen e martesës merrej bashkërisht nga burrat e shtëpisë , të cilët mbanin përgjegjësi të përbashkët për rrjedhojat e mundshme , por veprimet praktike të dëbimit të gruas i kryente bashkëshorti i saj.Në rast se burri , në kundërshtim me vendimin e "shtëpisë", nuk e dëbonte gruan e vet , sepse nuk bindej ose shihte ndonjë gabim të rëndë të saj, ai duhej të largohej nga familja bashkë me gruan dhe fëmijët. Familja e origjinës zakonisht e lëçiste (priste marrëdhëniet me të). Për të shmangur ndërlikimet e mundshme burri shiste ose e këmbente tokën dhe largohej në ndonjë krahinë tjetër.<sup>38</sup>

Burri mund ta zgjidhte martesën me bashkëshorten e vet për disa shkaqe të ligjshme , të cilat ndryshonin nga njëra krahinë te tjetra.Midis tyre dalloheshin tri shkaqe kryesore , të cilat parashikoheshin nga të gjitha kanunet shqiptare :

1. *Shkelja e besnikërisë bashkëshortore* - Nderi ishte një nga parimet themelore të së drejtës shqiptare.Shqiptarët ishin shumë të ndjeshëm në këtë sferë të jetës shoqërore , të prerë në kundërveprime dhe aspak tolerant.Një nga format më të rënda të prekjës së nderit ishte shkelja e besnikërisë bashkëshortore nga gratë.Për mendësinë e shqiptarëve kjo ishte një nga veprat më tronditëse , e pafalshme.Burri kishte të drejtën e zgjidhjes së martesës në çdo rast që ai bindej se gruaja e tij ishte e "pandershme".Ai mund ta zgjidhte martesën edhe kur dyshonte se gruaja

<sup>36</sup> Aleks Luarasi, vep. E cit, fq.184

<sup>37</sup> Aleks Luarasi, vep. E cit, fq.186

<sup>38</sup> Po aty

e tij kishte krijuar lidhje jashtë martesore me një burrë tjetër , por nuk kishte prova të mjaftueshme se dhe ne çdo rast kur vërente se gruaja e tij kishte sjellje pak a shumë të lira , të cilat nuk pajtoheshin me moralin e kohës.Kuptohet që vlerësimet e gabuara si dhe akuzat e pabazuara ndaj grave ishin të zakonshme.Një grua e ndarë nga burri , pavarsisht nga provat , merrte njollën e femrës së pandershme dhe përbufej rëndë nga opinion shoqëror ;

2. *Vjedhja* – Përvetësimi i çdo sendi të huaj (vjedhja bracallëku) brenda familjës ose jashtë saj ishte një shkak tjetër për zgjidhjen e martesës. Vjedhja shihej si një veprim i rëndë , çnderues , sidomos për gratë , që prekte rëndë nderin dhe dinjitetin vetjak dhe familjar , prandaj ajo shihej si një shkak i mjaftueshëm dhe krejtësisht i ligjshëm për ndarjen e gruas . Në disa kanune dhe përgjithësisht në mendësinë popullore shqiptare shihej një lidhje ndërmjet shkeljes së besnikërisë bashkëshortore ( ‘ kurvërisë’) dhe vjedhjes ( bracallëkut ‘) .Në krahinën e Pukës thuhej ‘Gruan brace( vjedhëse) ndaje se gruaja që bracon , edhe kurvnon ‘.Për zgjidhjen e martesës nuk kishte rëndësi vlera e sendit të vjedhur , por vesi i gruas.Sipas KLD , ‘ për bracni e cubni burri e lëshon gruan , por gje tjetër s’mund ti bajë ‘.
3. *Virgjëria* - Treguesi më domthënës i nderit të gruas ishte virgjëria .Gratë që nuk e plotësonin këtë kërkesë ktheheshin në shtëpinë e të atit qysh të nesërmen dhe martesë zgjidhej.Sipas Kanunit të Lumës , kur nusja shkonte tek burri i ligjshëm me barrë me një burrë tjetër ‘lëshohej’(martesë zgjidhej) , i ati i saj i lante gjakun familjes së dhëndrrit .Atij i takonte të gjente se me cilin kishte pasur marrëdhënie vajza e tij dhe të kërkonte marrjen e gjakut. 4)Shkaqe tjera të zgjidhjes së martesës – Kanunet shqiptare parashikonin edhe shkaqe të tjera për zgjidhjen e martesës të cilat mund të quhen relative sepse vareshin nga burri dhe familja e tij.Për më tepër nuk ishin të njëjlojta dhe ndryshonin nga njëra krahinë te tjetra. Një shkak i tillë mund të ishte steriliteti i grave .Ato gra që nuk lindnin fëmijë ose lindnin vetëm vajza shiheshin si bashkëshorte jo të mira dhe mund të ndaheshin.Megjithatë kishte raste kur burri nuk e ndante bashkëshorten e parë dhe merrte një të dytë për të lindur fëmijë , duke krijuar poligaminë.Sipas KLD , varianti i Pukës dhe atij të Mirditës , burri mund t andante gruan edhe për shkaqe tjera si p.sh. kur nuk ishte e zonja të kryente punët e shtëpisë e të rriste fëmijët , kur ishte llafazane dhe e ‘koriste’ burrin e shtëpinë e tij me fjalë e veprime , kur ikte me ditë të tëra pa leje nga shtëpia në shoqni e në komshi ose kur shkonte në gjininë e vet e nuk kthehej në afat , pa ndonjë shkak e arsye.<sup>39</sup>

E drejta zakonore shqiptare kishte përcaktuar disa mënyra konkrete të zgjidhjes së martesës ndërmjet palëve , të cilat përshkohen nga simbolizmi.Në KLD përdorej termi ‘theku i premë’, si sinonim i zgjidhjes së martesës .’Theku i premë’ tregonte një veprim simbolik që kryente burri ndaj gruas në çastin e dëbimit të saj e të zgjidhjes së martesës .Ai i priste gruas thekët , të cilat ishin skajet e tufave që kishin të ngjeshura në brezin e tyre gratë e Maleve të Mirditës etj.Në vend të thekëve burri mund ti priste gruas edhe flokët me gërshërë.Prerja e thekëve ose e flokëve ishte shenjë e poshtërimit të saj publik dhe e ndërprerjes së marrëdhënieve bashkëshortore. Përveç termit ‘theku i premë’ në krahinat e Shqipërisë së Veriut , përdorej edhe termi ‘lëshimi i gruas’ si sinonim i zgjidhjes së martesës nga burri që dallonte nga shprehja ‘lirimi i gruas’ e cila përdorej në rastin e pushimit të martesës me vdekjen e burrit.Në Kanunin

<sup>39</sup> Aleks Luarasi, vep. E cit, fq.187

e Labërisë dhe përgjithësisht në krahinat e Shqipërisë së Jugut përdorej termi ‘‘ndarja e gruas’’. Në krahinat e Shqipërisë së Veriut gruan e ‘‘lëshuar’’ e përcillte në shtëpinë e prindërve të saj vjehri dhe një shok i katundit (ia çon mikut në derë). Ajo nuk lihej rrugëve, sepse mund të rrezikohej për arsye të ndryshme dhe familja e burrit do të përgjigjej para prindërve dhe vëllezërve të saj. Krahas kësaj familja e gruas i kthente burrit ‘‘groshin e zakonit’’, një monedhë që tregonte në mënyrë simbolike zgjidhjen e kontratës së martesës.<sup>40</sup>

Qëndrimi ndaj gruas varej shumë nga shkaku i zgjidhjes së martesës. Në Krahinën e Lumës zbatohesh ‘‘çupimi i i grave’’ të pandershme, por që nuk ishin kapur në flagrancë. Me çupim kuptohej prerja e flokëve, e hundës, e veshit ose e të gjithave së bashku në shenjë çnderimi. E drejta e ‘‘çupimit’’ i përkiste vetëm burrit dhe askujt tjetër; varej tërësisht nga vullneti i tij. Pas çupimit burri e dëbonte. Një grua e tillë nuk mund të rimerrej nga i shoqi pas zgjidhjes së martesës. Çupimi i gruas mund të sillte ndërlikime në marrëdhëniet me familjen e saj. Sipas Kanunit të Lumës, burri që çupon gruan e vet ishte i detyruar ti jepte shpjegime familjes së saj, por nuk i kishte borxh gjakun sepse ushtronte një të drejtë të tij të njohur nga kanuni. Në rast se familja e gruas e vriste dhëndrrin për këtë shkak binte në gjak me familjen e tij, sepse vrasja konsiderohej e paligjshme.<sup>41</sup>

Zgjidhja e martesës në krahinën e Labërisë ishte më pak arbitrare. Shkaqet ishin po ato: shkelja e besnikërisë bashkëshortore (kurvëria), vjedhja (kusara), sjellja jo e mirë e gruas ndaj njerëzve të burrit etj. Në zgjidhjen e martesës ndikonte edhe qëndrimi i familjes së gruas. Pasi merrej vendimi për zgjidhjen e martesës nga burri dhe familjarët e tij, gruaja dërgohej në shtëpinë e babait pa i treguar shkakun ose pritej rasti kur shkonte vetë për të parë të afërmit e saj. Të nesërmen i çonin sepetin (arkën) me teshat e veta. Ky ishte një veprim simbolik që tregonte se martesë ishte e zgjidhur dhe gruaja nuk mund të kthehej në shtëpinë e burrit. Pas kësaj i zoti i shtëpisë së gruas njoftonte të zotin e shtëpisë së burrit dhe të dy palët mblidheshin rreth ndarjes së bashkëshortëve. Në këtë takim, shtëpia e burrit parashtronte shkaqet dhe argumentet e veta për zgjidhjen e martesës. Në qoftë se pala tjetër i gjente ato me vend dhe bindëse, zgjidhja e martesës pranohej në parim dhe të afërmit e gruas kërkonin ‘‘shartet e ndarjes’’, dmth të drejtat që i takonin gruas sipas kanunit. Pala e burrit ishte e detyruar t’ia jepte ato menjëherë.

Kur familja e gruas nuk bindej nga argumentet e paraqitura nga pala e burrit dhe nuk i pranonte ‘‘shartet e ndarjes’’, çështja kalonte tek pleqtë e fshatit të cilët zbatonin kanunin dhe shartet e Idriz Sulit. Pleqtë e fshatit luanin rolin e një gjykate pajtimi. ‘‘Trupi gjykues’’ dhe përbëhej nga 2, 3 pleqë të secilës palë dhe kishte më tepër pamjen e një arbitrazhi. Pleqtë mblidheshin në fshatin e burrit ose të gruas sipas kërkesës. Në seancat e tyre nuk merrte pjesë as burri, as gruaja, por i zoti i shtëpisë ose babai i secilit. Mbasi dëgjonin palët pleqtë përpiqeshin ta përefundonin çështjen me pajtim. Ata vetë bëheshin ndërmjetës dhe dorëzanë për arritjen e pajtimit dhe shuarjen e mosmarrëveshjeve. Kur pajtimi ishte i pamundur, pas një kohe pleqtë mblidheshin përsëri dhe vendosnin zgjidhjen e martesës, edhe sikur të mos kishte shkaqe të forta për prishjen e saj. Gruaja merrte ‘‘shartet e ndarjes’’. Si përjashtim, kur ndonjëra nga palët nuk pajtohej me vendimin e pleqve të fshatit, çështja shqyrtohej në shkallë të dytë nga pleqtë e krahinës (vilajetit). Vendimi i tyre ishte i formës së prerë. Zgjidhja e martesës nga pleqtë e fshatit mbështetej në normat e së drejtës zakonore shqiptare.<sup>42</sup> Mirëpo në Shqipëri, krahas me të drejtën zakonore, ka vepruar në shekuj e drejta pozitive (shtetërore) si dhe ajo fetare myslimane, katolike ose ortodokse. Në zonat ku vepronte e drejta zakonore, ligjet shtetërore nuk përfilleshin,

<sup>40</sup> Luarasi, vep. E cit, fq.251

<sup>41</sup> Aleks Luarasi, vep. E cit, fq.195

<sup>42</sup> Po aty

veçanërisht në rregullimin e marrëdhënieve familjare, por e drejta fetare respektohej. Prandaj , megjithëse sipas të drejtës zakonore të krahinës së Labërisë palët konsideroheshin të ndara , pasi kryenin procedurat e mësipërme , sipas të drejtës muslimane ose asaj kishtare ortodokse , mbeteshin ende të martuar . Në rast se njëri nga ish bashkëshortët dëshironte të rimartohej duhej të zgjidhte kurorën e vjetër , duke bërë veprimet formale dhe duke paguar të hollat sipas përkatësisë fetare, “sherisë“ për fenë myslimane ose “dhespotit“ për fenë ortodokse. Sipas zakonit të krahinës së Labërisë të hollat e shkurorëzimit i paguante ai (burri ose gruaja) që do të martohej i pari. Në krahinat me popullsi katolike , në të cilat vepronte KLD ose ai i Mirditës , kurora mbetej edhe pas zgjidhjes së martesës sipas të drejtës zakonore. E drejta kanonike e rritit katolik nuk lejonte zgjidhjen e martesës . Për rrjedhojë, ish-bashkëshortët mbeteshin nën kurorë dhe nuk mund të rimartohejshin përsëri, veçse po të shkelnin normat e së drejtës kishtare.<sup>43</sup>

Zgjidhja e martesës krijonte disa probleme juridike ndërmjet palëve për rritjen e fëmijëve, si dhe për pasurinë që i takonte gruas të merrte në shtëpinë bashkëshortore . Duke u mbështetur fortë në mendësinë patriarkale e drejta zakonore shqiptare i kishte zgjidhur këto dy probleme të mëdha në dobi të burrit. Të gjitha kanunet shqiptare njihnin pa mëdyshje të drejtën e burrit për mbajtjen e fëmijëve , pavarësisht nga shkaqet e zgjidhjes së martesës. Këtu shfaqet epërsia e të drejtës atërore ndaj asaj amtare që ishte në themel të kanuneve. Sipas së drejtës zakonore shqiptare , fëmijët , djem ose vajza i takonin babait, pra lisit të gjakut. Në familjen , vëllazërinë ose fisin e babait ata gëzonin të drejtën e trashëgimisë dhe të gjitha të drejtat e tjera të njohura nga kanunet. Gratë, kur largoheshin nga shtëpia bashkëshortore , me rastin e zgjidhjes së martesës ndaheshin nga fëmijët e tyre dhe nuk kishte asnjë mundësi takimi ose kontakti të mëvonshëm. Kur gruaja e shkurorëzuar ishte shtatzanë , do të lindte në shtëpinë e babait , por e kthente fëmijën te i ati , porsa mbushte 40 ditë.

Pak a shumë i njëjlojtë ishte edhe qëndrimi i së drejtës zakonore shqiptare edhe për sa i përket problemeve pasurore. Gruas nuk i njëhej asnjë pjesë në pasurinë e përbashkët të familjes, asnjë kontribut , si në pasurinë e luajtshme ashtu dhe në atë të paluajtshme. Si rregull gruaja merrte me vete vetëm teshat e shtatit . Sipas Kanunit të Lumës , gruaja pa fëmijë merrte edhe teshat e arkës si dhe ato që kishte punuar vetë. Gruaja me fëmijë merrte vetëm teshat e shtatit , ato të arkës u mbeteshin fëmijëve , shtresat e mbulesat burrit. Sipas Kanunit të Labërisë gruaja e ndarë me ose pa fëmijë merrte rrobat e trupit , ndonëse ato ishin blerë nga burri, pajën e sjellë me vete, si dhe dhuratat që i ishin bërë para ose pas martesës. Ajo kishte të drejtë, gjithashtu të merrte prej burrit 60 okë misër për tre muaj, sipas sharteve të Idriz Sulit. Gratë pothuajse nuk kishin asnjë të drejtë për zgjidhjen e martesës as familjet e tyre . Vetëm Kanuni i Lumës , në formë përjashtimi , njëhte të drejtën e gruas , më saktë të familjes së saj , për të kërkuar zgjidhjen e martesës për paaftësi seksuale të burrit. Sipas këtij kanuni , nusja ‘e lëshon burrin kur ai s’është i zoti e s’bjen me të‘, sepse pa burrë ‘nuk rri kush nuse në shtëpi të huaj‘.<sup>44</sup>

Në të drejtën familjare , Skënderbeu ndryshoi normën e vjetër zakonore që lejonte burrin në çdo rast ta shkurorëzonte gruan pa shkak dhe pa i dhënë kurrfarë pasurie. Kanuni i Skënderbeut njëhte vetëm dy shkaqe të ligjshme për shkurorëzimin e gruas: vjedhjen (bracallëkun) dhe shkeljen e besnikërisë bashkëshortore (për punë të pandërshme). Njëhej edhe shkurorëzimi i gruas pa shkak por me këtë rast ajo merrte gjysmën e tokës për sigurimin e jetesës. ‘Me kanunë të Skënderbeut gruja munet me u da vetëm për bracallëk e për punë të pandërshme. Nrishe , ai ç’i e dan grunë duhet me i dhanë pjesën , se edhe ajo ka ba mund për

<sup>43</sup> Aleks Luarasi, vep. E cit, fq.197

<sup>44</sup> Po Aty

*plang të shpajs.Po ta dajë grunë pa arsye, gruja të merrte xhimsën e tokës me kanun të Skëndërbeut*‘‘<sup>45</sup>.

## **2.SISTEMET JURIDIKE TE SHKURORËZIMIT**

Sa i përket shkurorëzimit , në botë egzistojnë dy sisteme :

1. sisteme që ndalojnë shkurorëzimin dhe
2. sisteme që lejojnë shkurorëzimin.

### **2.1.Sistemet juridike që ndalojnë shkurorëzimin**

Sistemet që ndalojnë shkurorëzimin zakonisht u përkasin shteteve në të cilat ka ndikim e Drejta kanonike e kishës katolike e kishës katolike , p.sh. Spanja , Irlanda , Monako, Lihentshtajni , Kili , Argjentina, Kolumbia , Brazili , Paraguai etj. Në këto shtete martesë konsiderohet si lidhje hyjnore , e lidhur para Perëndisë dhe e përjetshme , pra e pashkëputshme deri në vdekje. Në vend të shkurorëzimit lejohet institucioni i ndarjes nga shtrati dhe nga tryeza (separatio quod thorum et mensam). Kjo do të thotë se bashkëshortëve u mundësohet që të ndërpresin jetën e përbashkët faktike , mirëpo martesë juridikisht ekziston edhe më tej. Prandaj , martesë si ndërlidhje juridike ekziston , por pushon vetëm jeta faktike. Pra , bashkëshortët jetojnë ndaras , sepse janë të ndarë nga shtrati e tryeza. Vetë lejimi i këtij institucioni është argument dhe tregon se ndalimi i shkurorëzimit është qëndrim pa bazë dhe i padrejtë. Ky institucion shton numrin e konkubinateve , sepse bashkëshortët e ndarë nga shtrati dhe tryeza nuk mund të lidhin martesë të re, por ata detyrohen të krijojnë marrëdhënie jashtëmartesore – konkubinat.<sup>46</sup> Shkurorëzimi nuk ishte i mundur në Angli dhe SHBA , relativisht deri vonë.Gjithashtu edhe vendet që ishin koloni të Anglisë nuk e kanë pranuar për një kohë të gjatë shkurorëzimin.Këto vende ishin nën ndikimin e doktrinës së kishës katolike.Ndërsa vendet koloni të Anglisë që ishin nën ndikimin protestant e kanë lejuar shkurorëzimin.Anglia e ka ruajtur këtë sistem deri në vitin 1857.<sup>47</sup>

### **2.2.Sistemet juridike që e lejojnë shkurorëzimin**

Në kuadër të sistemeve që lejojnë shkurorëzimin dallohen disa sisteme të shkurorëzimit:

1. sistemet që me lehtësi e lejojnë shkurorëzimin ,
2. sistemet që e lejojnë shkurorëzimin si sanksion ,
3. sistemet që e rregullojnë shkurorëzimin për shkak të çrregullimit serioz të marrëdhënieve bashkëshortore dhe
4. sistemi i kombinuar.<sup>48</sup>

<sup>45</sup> Aleks Luarasi, vep.E cit, fq.227

<sup>46</sup> Gani Oruçi, vep. E cit, fq.92

<sup>47</sup> Abdulla Aliu, vep. E cit, fq.161

<sup>48</sup> Gani Oruçi, vep. E cit, fq.93

Sistemet që me lehtësi e lejojnë shkurorëzimin bazohen në një liri absolute të shkurorëzimit. Këto sisteme kryesisht bazohen në të Drejtën e Sheriatit, përkatësisht shtetet myslimane. Në këto shtete burri e gëzonte të drejtën e dëbimit të gruas ( të drejtën e tallakut). Burri mund ta dëbonte gruan sipas dëshirës së tij. Kështu ai kishte një liri absolute në shkurorëzim .Burri kishte të drejtë të krijonte poligininë, të lidhte disa martesë paralele.<sup>49</sup>

### **2.3.Sistemet që e lejojnë shkurorëzimin si sanksion**

Sistemet që e lejojnë shkurorëzimin si sanksion , kryesisht bazohen në fajësinë e bashkëshortit, për shkak të shkeljes së detyrimeve bashkëshortore. Në këto sisteme shkurorëzimi zbatohet si sanksion apo dënim ndaj bashkëshortit që me veprimet e veta të fjahe i ka shkelur detyrimet bashkëshortore. Ndryshe ky sistem emërtohet dhe si sistem i shkaqeve absolute ose të posaçme të shkurorëzimit , sepse gjykata mund të vendos shkurorëzimin vetëm për ato shkaqe që janë caktuar shprehimisht në dispozitat ligjore përkatëse. Bashkëshorti mund të kërkonte shkurorëzim vetëm kur ekzistonin shkaqet e parapara me ligj, p.sh: atentati ndaj bashkëshortit, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, e lë bashkëshortin me qëllim të keq ose pa arsye , keqtrajton bashkëshortin etj. Mirëpo shkurorëzimi nuk lejohej për shkak të tronditjeve të thella të marrëdhënieve bashkëshortore. Ky sistem aplikohet në Francë dhe në vendet anglosaksone. Këto vende për shkaqe objektive , sikur martesë të humbte qëllimin e vet nuk e lejonin shkurorëzimin. Për këto arsye legjislacioni francez dhe anglosakson kanë hequr dorë nga ky sistem.<sup>50</sup>

### **2.4.Sistemi që e lejon shkurorëzimin si një mjet shërues**

Sistemi që e lejon shkurorëzimin për shkak të çrregullimit serioz të marrëdhënieve bashkëshortore , e lejon shkurorëzimin si një mjet shërues. Ky sistem bazohet në kriterin themelor se shkurorëzimi lejohet për çdo shkak që ka sjellë çrregullimin dhe tronditjen serioze të marrëdhënieve bashkëshortore. Ky sistem quhet ndryshe edhe sistemi i shkakut të përgjithshëm (relative) të shkurorëzimit. Këtë sistem e kishte edhe Legjislacioni i Shqipërisë që nga viti 1966. Sipas këtij sistemi lejohet shkurorëzimi për shkak të tronditjeve të thella të marrëdhënieve bashkëshortore si me fajin e njërit bashkëshort apo edhe pa fajin e tyre por për shkaqe objektive marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar seriozisht , p.sh. nuk përputhen karakteret e tyre , ose për ndonjë shkak tjetër të thjeshtë , tronditen marrëdhëniet bashkëshortore. Ky sistem shkurorëzimin e konsideron si mjet shërues , pra si ilaç.<sup>51</sup>

### **2.5.Sistemi i kombinuar**

Sistemi i kombinuar , është sistem i cili në vete përfshin si elementet e sistemit objektiv pra , të çrregullimit serioz të marrëdhënieve bashkëshortore por edhe elementet e veçanta të përcaktuar me ligj. Ky sistem ka qenë fillimisht i përhapur në legjislacionin familjar të Austrisë, Gjermanisë, Zvicrës, Turqisë , e më vonë edhe në shtetet tjera. Sipas këtij sistemi shkurorëzimi mund të kërkohej për shkaqe të parapara me ligj. Kështu p.sh në Kodin Zvicerian përcaktohej si

---

<sup>49</sup> Po aty

<sup>50</sup> Valentina Zaçe, vep. E cit, fq.125

<sup>51</sup> Gani Oruçi, vep. E cit, fq.162



shkak : shkelja e kurorës, atentati kundër jetës së bashkëshortit , keqtrajtimet ose fyerjet e rënda , lënia qëllimkeqe ose sëmundjet psikike.Ndërsa përveç kësaj me nenin 142 , parashihej se “secili bashkëshort mund të kërkoj shkurorëzimin kur marrëdhëniet bashkëshortore janë tronditur aq thellë sa që nuk është e arsyeshme të kërkohet prej tyre vazhdimi i bashkëjetesës“. Nëse kjo është shkaktuar me fajin e njërit bashkëshort , bashkëshorti tjetër mund të ngritë padi për shkurorëzim.<sup>52</sup>

Legjislacionit serb , konkretisht Ligji për Familjen i RS (Gazeta zyrtare RS 18\2005) nuk i ka cekur shprehimisht se për cilat arsye mund të kërkojnë bashkëshortët shkurorëzimin,por vetëm se ka potencuar që duhet të plotësohet njëri nga dy kushtet : a) çrregullimi serioz dhe në mënyrë të vazhdueshme i marrëdhënieve bashkëshortore ose b) nëse nuk mund të realizohet jetesa e përbashkët e çiftit.Pra si arsye për shkurorëzim mund të miren të gjitha ato rrethana apo arsye të cilat kanë sjellur deri te çrregullimi serioz i marrëdhënieve bashkëshortore apo kanë ndikuar që jetesa e përbashkët e bashkëshortëve të bëhet e pamundur. Pra siç mund të shifet Republika e Serbisë ka të inkorporuar në legjislacion e saj sistemin e lejimit shkurorëzimit si ilaç.

---

<sup>52</sup> Gani Oruçi, vep. E cit, fq.162

## KAPITULLI II

### 3.ZHVILLIMI HISTORIK I SHKURORËZIMIT

Shkurorëzimi mund të duket si problem i ditëve të sotme por në fakt është institucion qe daton qysh në kohët e lashta.Lirisht mund të themi se është institucion i lashtë po aq sa është edhe martesë.Kjo duke i marrë për bazë fjalët e Volterit i cili thotë se “shkurorëzimi lindi disa javë pas martesës”.Do të thotë , atëherë kur lindi martesë lindi edhe divorci.<sup>53</sup>

#### 3.1.Shkurorëzimi në shtetet e para skllavopronare

##### 3.1.1.Shkurorëzimi në Egjipt

Në shoqërinë e lashtë egjiptiane, gratë trajtoheshin ndryshe nga gratë e shoqërive të tjera të lashta. Shoqëria egjiptiane e lashtë u ka ofruar grave mundësitë më të mëdhajat(më të mirat) nga të gjitha shoqëritë mesdhetare në lidhje me pozicionet e tyre ekonomike, ligjore dhe sociale. Ato gëzonin të njëjtat të drejta ligjore, ekonomike dhe sociale si burrat egjiptian. Statusi i lartë i femrave është reflektuar në atë se gratë janë trajtuar në mënyrë të barabartë me burrat në sistemin ligjor.Gratë mund të vepronin si paditëse, të pandehura dhe si dëshmitare para gjykatës pa pasur nevojë për një përfaqësues mashkull siç ishte praktikë e zakonshme për gratë në shoqëritë e tjera. Gratë kishin të drejtë të padisnin dhe të mund të hyjnë në kontrata duke përfshirë çdo marrëveshje ligjore në lidhje me martesën, divorcin, pronën, dhe punësimin.Gruaja ishte gjithashtu përgjegjëse, dhe mbante përgjegjësi, për çdo transaksion ose kontratë që ajo vet ka hyrë . Këto të drejta të barabarta ekonomike dhe ligjore nuk ishin të rezervuara vetëm në një klasë sociale dhe ishin në dispozicion për të gjitha nivelet e shoqërisë egjiptiane.<sup>54</sup>

Martesa në Egjiptin e lashtë ishte një çështje tërësisht private, në të cilën shteti nuk ndërmeri asnjë interes dhe për të cilat shteti nuk ka mbajtur asnjë shënim apo dëshmi.Nuk ka asnjë provë për ndonjë ceremoni ligjore apo fetare që të themelohej martesë. Por në thelb martesë ishte një marrëveshje midis dy njerëzve, dhe familjeve të tyre, se ata do të jetojnë së bashku dhe do të krijojnë një familje.Edhe pse gratë kishin më shumë të drejta se gratë në shoqëritë tjera të lashta , shumica e egjiptianëve martoheshin me një person nga klasa e tyre shoqërore.Edhe pse gratë mund të kishin pasuri të tyre ato kishin nevojë për disa garanci që burri i saj do t'i siguronte asaj dhe fëmijëve të mira materiale.Kështu janë zhvilluar të ashtuquajturat “kontrata martesore” të cilat ishin kryesisht ekonomike dhe nuk preknin çështjet sociale fare.<sup>55</sup>

Divorci dhe rimartesa ishin të zakonshme në Egjipt në të gjitha periudhat.Divorci dhe rimartesa duket se ka qenë të lehta dhe të zakonshme.Edhe pse asnjëra palë nuk kishte pse të gjente arsye apo shkaqe për t'u divorcuar(as shkaqe shoqërore as morale as etike as juridike) përgjegjësitë që dilnin nga kontratat martesore e bënin divorcin një hap të rëndësishëm dhe serioz.Ndryshe nga shoqëritë e tjera të lashta, gratë egjiptiane ishin të lira të zgjedhin burrin me

<sup>53</sup> Gani Oruçi, vep. E cit, fq.89

<sup>54</sup> <http://www.ancient.eu/>

<sup>55</sup> <http://fathom.lib.uchicago.edu/>

të cilin donin të martoheshin dhe ato gjithashtu ishin të lira për t'u divorcuar nga burrat e tyre. Kur një çift divorcoheshin, gruaja kishte të drejtë për prikën e saj dhe deri në një të tretën e pasurisë së përbashkët të krijuara gjatë martesës plus ndonjë gjë tjetër nëse ishte paraparë në kontratën e martesës.<sup>56</sup>

Në qoftë se një njeri e divorconte gruan e tij, ai kishte për detyrë t'ia kthente prikën e saj (në qoftë se ajo kishte sjellë një) dhe të paguajë asaj një gjobë; nëse gruaja e divorconte atë, nuk kishte për detyrë ti jepte atij asnjë gjobë. Bashkëshorti i shkurorëzuar për faj (duke përfshirë tradhtin bashkëshortore) e humbte pjesën e tij ose të saj të pasurisë së përbashkët të çiftit. Pas divorcit, të dy ishin të lirë të rimartoheshin. Por, deri sa burri nuk ia kthente prikën gruas së tij dhe asaj nuk ia paguante gjobën, burri mbetej përgjegjës për mbështetjen e saj derisa ti plotësonte këto obligime edhe në qoftë se ata nuk jetonin së bashku.<sup>57</sup> Vlen të përmendet se tradhëtia bashkëshortore në Egjipt ishte e dënueshme si për femrën ashtu edhe për mashkullin.

### 3.1.2. Shkurorëzimi në Babiloni

E një rëndësie të madhe për të drejtën familjare në Babiloni pos të drejtës zakonore ka qenë edhe Kodi i Hamurabit. Ky kod është nxjerrë në gjysmën e parë të shekullit XVII p.e.së në gjatë sundimit të Hamurabit. Këtë kod e nxorri Hamurabi prandaj edhe quhet sipas emrit të tij. Ky kod ka përmbajtur norma mbi gjyqet, mbi sendet, mbi martesën, familjen, trashëgiminë, etj.<sup>58</sup>

Martesa lidhej në formë të kontratës ndërmjet dhëndrit dhe prindërve të vajzës. Kontrata mbi martesën ishte e obligueshme. Me rastin e lidhjes së martesës dhëndrri jepte tirhatën e cila ka qenë dhuratë e jo çmimi i blerjes së gruas. Dhëndrri i jepte familjes së vajzës i jepte edhe një dhuratë të ngjajshme me tirhatën, që quhej bi-bla-ma, që përbëhej prej sendeve të luajtshme. Gruaja me veti sillte shiritkën që ishte një lloj paje ose prike të cilën e sillte nga familja e saj. Ndërsa burri për ta siguruar gruan pas vdekjes së vet eventuale asaj gjatë martesës i dhuronte nudunu-n.<sup>59</sup>

Burri mund ta divorconte gruan pa pasur asnjë shkak ose arsye, por në qoftë se ajo kishte lindur fëmijë ai duhej ti plotësonte disa kushte: fëmijët mbesin nën kujdesin e nënës së tyre pra gruas; ajo merr prikën; burri duhet t'ia japë për shfytëzim një fushe ose pronë në mënyrë që ajo mund të rrisë fëmijët e saj. Kur ish-burri i saj vdes ajo merr një pjesë të pasurisë së tij të barabartë me atë të dhënë për secilin nga djemtë e saj dhe ishte e lirë të martohet me dikë tjetër. Burri e divorconte gruan edhe për mospasje të fëmijëve. Dhe kur një burrë e divorconte një grua pse nuk kishte lindur fëmijë ajo kthehej në shtëpinë e të atit duke marrë me veti prikën e saj (shiritkën) së bashku me një shumë të barabartë me tirhatën. Nëse si kishte dhënë tirhatën atëherë i jepte ari.<sup>60</sup> Sa i përket divorcit duke u bazuar në Kodin e Hamurabit mund të përfundojmë se burri pavarësisht pozitës më ta favorshme prap ai gjatë divorcit duhet ti respektojë disa të drejta pasurore të gruas. Interesant është fakti që mashkulli edhe pse ka të drejtën ta divorcojë gruan edhe pa shkak ai nuk mund të veprojë sipas vullnetit të tij por ka për detyrë t'ia kthejë gruas atë çka ka sjellur e kur kishte fëmijë detyrohej t'ia jepte një tokë për ta

<sup>56</sup> <http://www.ancient.eu/>

<sup>57</sup> Po aty

<sup>58</sup> Hilmi Ismaili Fatmir Sejdiu, vep. e cit, fq. 48

<sup>59</sup> Po aty

<sup>60</sup> <http://www.womenintheancientworld.com/>

shfrytëzuar. Burri poashtu mund ta divorconte gruan edhe për lënie pas dore të burrit dhe shtëpisë , në këtë rast ajo e humbte shiritkën kurse burri kishte të drejtë edhe në kthimin e tirhatës. Gruaja mund të kërkonte zgjidhjen e martesës divorcit vetëm nëse burri për kohë të gjatë e kishte braktisur shtëpinë dhe familjen dhe ishte plangprishës. Në këtë rast ajo merrte shiritkën kurse burri humbte tirhatën.<sup>61</sup> Sipas këtij kodi burri kishte të drejtë ta shkurorëzonte gruan nëse ajo pa lejen e tij buante flinte jashta shtëpisë së burrit nësë e linte burrin pas dore etj. E gruaja kishte të drejtë për shkurorëzim nëse burri zihej rob dhe kjo nuk kishte mjete të mjaftueshme për jetesë.<sup>62</sup>

### 3.1.3. Shkurorëzimi në Athinë

Në Athinën e lashtë, si burri edhe gruaja kishte të drejtën për të nisur një divorc. Burri kishte të drejtë pa kurrfarë arsytimi dhe pa prezenecë të organit shtetëror , ta prishte martesën në mënyrë të thjeshtë, duke e dërguar bashkëshorten te prindërit e saj. Në këtë rast ishte i detyruar ta kthente dotën. Ishte megjithatë një rrethanë ku dëbimi i gruas ishte kusht i detyrueshëm (i pashmnagshëm ) në mënyrë që burri mos t'i humbte të drejtat e tij civile në rastet kur gruaja kishte kryer tradhëti bashkëshortore<sup>63</sup>. Edhe gruaja kishte mundësi të kërkonte prishjen e martesës, por duhej para arkond eponimit t'i provonte arsyet e shkurorëzimit. Si arsye të mjaftueshme për shkurorëzim ishin dënimi me humbjen e të drejtave të nderit (atimia) dhe humbja e lirisë, përkatësisht rënia e burrit në skallvëri. Pas shkurorëzimit, gruaja përsëri kthehet nën pushtetin e babait ose të vëllezërve të saj.<sup>64</sup> Ka pasur dy procedura të tjera me të cilat njerëzit e tjerë përveq çiftit mund ta prishnin një martesë. E para ishte divorci i iniciuar nga babai i nuses i cili lejohej vetëm në qoftë se gruaja nuk i kishte lindur burrit fëmijë. Dhe rasti tjetër ishte në qoftë se një grua bëhej epikleros pas martesës së saj, mashkulli më i afërt me vdekjen e babait të saj kishte të drejtë për t'i dhënë fund martesës së saj të tanishme në mënyrë që të martohej me të. Prika nuk ishte e detyrueshme por paraqiste një siguri për gruan në rast shkurorëzimi, andaj edhe familjet e varfura përpiqeshin t'si siguronin një prikë të vogël për bijat e tyre. Prika ishte një pjesë nga pasuria e babit të cilën e trashëgonte vajza nëse kishte vëllezër. Prikat në periudhën klasike për femrat e familjeve të pasura mund të llogaritej si 5 -10 % nga pasuria e të atit.<sup>65</sup>

Nëse nuk kishte vëllezër ajo trashëgonte tërë pasurinë e babit dhe kështu ajo bëhej një epikleros. Shteti ka ndërhyrë në këtë rast përmes ligjit duke urdhëruar të afërmin mashkull (më të ri duke filluar nga ai më i afërti i babit të saj të martohej me të dhe të kishte kontroll mbi pasurinë që vinte bashkë me gruan. Nëse ai ishte i martuar mund t'a shkurorëzonte gruan dhe të martohej me epiklerosin ose t'ia kalonte të afërmit të dytë më të afërt dhe kështu me rradhë. Edhe në qoftë se gruaja kishte shumë pak ose aspak pasuri të afërmit meshkuj të babait të saj ende kishin detyrim ligjor për ta martuar atë. Nëse anjë i afërm nuk donte të martohej me epiklerosin kur ajo ishte e varfër arkondi gjyqgtar i lartë i shtetit që merrej me çështje sociale ishte i detyruar ligjërisht që të afërmin më të afërt të babait të saj ta ngarkonte me detyrën që t'ia siguronte një prikë nga pasuria e tij apo ti gjente asaj një burrë. Ligjet në lidhje me epikleros-in kanë tërhequr shumë vëmendje në vitet e fundit, dhe shpesh janë interpretuar si mospërfillje e

<sup>61</sup> Hilmi Ismaili Fatmir Sejdiu, vep.e cit, fq.59

<sup>62</sup> Mladenovic Marko, vep.e cit, fq 189

<sup>63</sup> Nigël Wilson, vep.e cit, fq.238

<sup>64</sup> Po aty

<sup>65</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/Marriage\\_in\\_ancient\\_Greece](https://en.wikipedia.org/wiki/Marriage_in_ancient_Greece)

plotë për ndjenjat dhe dëshirat e gruas. Pasi ajo trajtohej si një objekt derisa t'i gjindej një burrë për ta marrë atë dhe pasurinë e saj nën krahun e tij. Fakti se gruaja nuk mund ta donte një burrë të imponuar nuk konsiderohej si e rëndësishme nga shumica e athinasve. Normalisht, martesat nuk ishin të bazuara në dashuri, por në perspektivën e një partneriteti të mirë për të ardhmen. Dashuria dhe respekti midis burrit dhe gruas shpeshohej se do të zhvillohej me kalimin e kohës. Në disa raste, natyrisht, pasioni zinte vendin e parë dhe burrat e Athinës nganjëherë martoheshin me gra tërheqëse, thjesht sepse ato i fascinonin ata, por kjo nuk ishte rregull. Tani, nëse gjykojmë nga shifra jashtëzakonisht e ulët e divorcit në Athinë, në krahasim me shifrat fluturues të divorcit të kohës sonë, ndoshta ne mund të bëhemi më pak kritikues ndaj këtyre lloje të qëndrimeve të Athinasve ndaj martesës dhe jetës familjare.<sup>66</sup>

Meshkujt e kësaj periudhe u janë frikësuar shkurorëzimit pasi detyroheshin të kthenin prikën gjë që mund të falimentonte familjen. Burrat mund të kishin trajtuar gratë e tyre disi më mirë se në qoftë se mes tyre nuk do të kishte para të përfshira. Nëse gruaja ishte e re, kyrios-i i saj do të përdorte prikën që t'a martoj përsëri pas divorcit. Nëse jo, paratë janë përdorur për kujdesin e saj të ardhshëm. Sido që të jetë, një grua nga një familje e pasur ka qenë në mëshirën e familjes së saj. Gratë nga shtresat e ulëta duhej të shpresonin që të afërmit do ti ndihmonin kyriosin e tyre për të mbledhur një prikë për to. Nëse jo, martesat nuk ishin shumë e mundshme për to. Një grua mund të divorcohej, por vetëm nëse familja e saj u pajtoheshin se ajo duhej. Në të gjitha rastet e shkurorëzimit, gratë humbnin fëmijët e tyre, pasi fëmijët qëndronin me babain. Si rezultat i kësaj, është e lehtë për të parë pse shumë femra mund të kenë qëndruar në martesë, edhe në qoftë se ato me të vërtetë të donin të shkurorëzoheshin.<sup>67</sup>

### 3.1.4. Shkurorëzimi në të drejtën Romake

Në të drejtën e lashtë lejohej zgjidhja e martesës me shkurorëzim. Të drejtë që të zgjidhte martesën kishte ekskluzivisht burri dhe pater familias i burrit. Shkurorëzimi lehohej për shkak të shkeljes së kurorës, për shkak të alkoolizimit, për shkak të dështimit të fëmijës dhe për çdo shkak tjetër që e shtynte burrin të zgjidhte bashkësinë ekzistuese martesore. Sipas "dura lex" gruaja nuk e kishte këtë të drejtë, sepse nuk ia lejonte pozita në familje si person alieni juris. Forma e shkurorëzimit ishte korelative ndaj formës së lidhjes: martesat e lidhura në formën *confarreatio* zgjidhej në formën *diffareatio*: martesat e lidhura në formën *comp* zgjidhej në formën *remancipatio*, ndërsa martesat e lidhura në formën e *usus* zgjidhej me shkurorëzim të vërtetë të bashkësisë martesore me urdhër të burrit.<sup>68</sup>

Sipas të drejtës romake klasike martesat pa manus është bazuar me pëlqim. Me lejen e kujdestarëve përkatës një burrë dhe një grua mund të shpallnin veten të martuar përderisa të dy kishin kaluar moshën e pubertetit, dhe kur njëra nga palët tërhiqte pëlqimin martesat mirrte fund. Duke ndjekur këtë parim çdo burrë ose grua që donte ta bënte këtë gjë mund të shkurorëzohej thjesht duke i dërguar partnerit një letër ose duke deklaruar në prani të dëshmitarëve se martesat ka përfunduar. Nuk kishte një gjë siç ishte pasuria e përbashkët martesore, dhe fëmijët nga ajo martesë i takonin babait kështu që nuk kishte shumë çka për të diskutuar. Nëse burri ka iniciuar shkurorëzimin ai kishte për detyrë të kthente pajën e plotë. Veçanërisht prikat e mëdha kanë qenë një pengesë e madhe për divorc, si një dënim i lartë

<sup>66</sup> [http://www.stoa.org/projects/demos/article\\_women\\_and\\_family?page=all](http://www.stoa.org/projects/demos/article_women_and_family?page=all)

<sup>67</sup> <http://www.moyak.com/papers/athenian-women.html>

<sup>68</sup> Ivo Puhar, vep. e cit, fq. 189

financiar është dashur të paguhet nga ai që e ka iniciuar atë. Sa më i madh të ishte përkajoshja aq më shumë pushtet kishte gruaja në një marrëdhënie për sa kohë që ajo ishte e dëlirë (e pafajshme).<sup>69</sup>

Nëse gruaja (ose në disa raste babai i saj) ka iniciuar divorcin, burrit i lejohej të mbante një të gjashtën për çdo fëmijë të moshës deri në tre vjet, e kur bëhej fjalë për tradhëti bashkëshortore të saj edhe një të gjashtë plus. Pasi që fëmijët ishin në potestas të babait ka pasur më pak raste për sa i përket kujdestarisë pas divorcit në Romën e lashtë se sa sot. Një burrë hakmarrës mund të bënte që ish-gruaja e tij kurrë të mos i shihte fëmijët e saj, dhe kjo mundësi mund të ketë bindur disa gra që të mbeteteshin në martesë edhe pse të pakënaqura. Nëse ndarja ishte e mjaftueshme miqësore, prindërit mund të bënin marrëveshje mes veti ku fëmijët, sidomos të rinjtë, të qëndronin me nënën e tyre, por në qoftë se i babai i dëshirote fëmijët ai pothuajse gjithmonë edhe i fitonte, dhe natyrisht kudo që fëmijët jetonin, ai mbetej financiarisht përgjegjës për ta.<sup>70</sup>

Pater familias-i kishte të drejta të rëndësishme sa i përket martesës së fëmijës së tij. Fillimisht ai mund ta detyronte fëmijën e vet që të martohej, por ky pushtet doli jashta përgjithësisht jashtë përdorimit gjatë Republikës (Augustit). Augusti lejoi të mos merrej parasysh nëse ishte refuzuar pa një shak të drejtë. Një pater familias kishte të drejtë gjithashtu edhe fuqinë për të detyruar fëmijën e vet që ti jepte fund një martesë përmes divorcit.<sup>71</sup> Gjatë periudhës republikane u ndalu shkurorezimi pa shkak, burri i cili kishte divorcuar gruan në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të justifikuar goditej me sanksione pasurore.<sup>72</sup>

Megjithatë, ka pasur mosmarrëveshje që kishin shkuar në gjykatë. Në një rast, një nënë ka fituar kujdestarinë e fëmijës së saj për shkak se babai ishte i "keq." Në një rast tjetër gruaja nga gjykata ka kërkuar nga ish-bashkëshorti të siguronte mbështetje financiare për fëmijën. Ka pasur raste kur një grua e kuptonte se kishte mbetur shtatzënë pasi ishte divorcuar dhe i ati e mohonte atë. Në mungesë të analizave të gjakut dhe ADN-së e testeve moderne që mund ta vërtetonin atësinë romakët bazoheshin në kalendar. Një grua që pretendonte se ishte shtatzënë tashmë nga ish-bashkëshorti duhej që këtë ta vërtetonte brenda tridhjetë ditëve nga data e divorcit dhe ajo mund të priste që të vizitohej nga një grup i dëshmitarëve të dërguar prej ish bashkëshortit për t'a verifikuar gjendjen e saj. Ndryshim i madh u bë me Ligjin e Augustit mbi martesën. Një burrë detyrohej ta linte një grua që shkilte kurorën, ose të përballte me akuza për kodoshllëk, dhe ndëshkimi financiar kundër saj është rritur në gjysmën e pajës së saj dhe një e treta e çdo pasurie që ajo zotëronte. Dhe më e rënda ishte se ajo internohej më pas në një ishull. Ne nuk e dimë se si edhe ky ligj është zbatuar, por nuk ka pasur asnjë ndryshim në mundësinë e asnjërit partner për të dalë nga një martesë që nuk ishte njollosur me tradhti bashkëshortore.<sup>73</sup>

Në shekullin e tretë në Romë, shumë njerëz kishin rezerva serioze për lehtësinë me të cilën njerëzit mund të shkurorezoheshin. Disa ishin të shqetësuar për ndikimin që divorci kishte tek fëmijët, por të tjerët thjesht mendonin se shoqëria kishte një interes në ruajtjen e marrëdhënieve ekzistuese dhe kundërshtoi idenë se një burr apo grua mund të prishnin një martesë, kur nuk kishte arsye bindëse për këtë. Në fund të mbretërimit të tij, 331, Konstandini nxori një dekret që përcaktonte ndëshkime të rënda për shkurorezim të njëanshëm, përveç në rrethana të caktuara. Në qoftë se një grua e divorconte burrin e saj, pa provuar që ai ishte "një vrasës, apo përgatitës i helmit ajo humbte të gjithë pajën e saj dhe deportohej në një ishull. Në mënyrë të ngjashme, nëse një njeri shkurorezonte gruan e tij pa provuar se ajo ishte një "shkelëse

<sup>69</sup> <http://www.womenintheancientworld.com/divorceinancientrome.htm>

<sup>70</sup> Po aty

<sup>71</sup> Andrew Borkowski, Paul du Plessis, vep.e cit, fq.168

<sup>72</sup> Ken Dhima, vep.e cit, fq.433

<sup>73</sup> <http://www.womenintheancientworld.com/divorceinancientrome.htm>

e kurorës, përgatitëse e helmit ai detyrohej t'ia kthente pajën e saj. Nëse ai do të rimartohej, ish-gruas së tij i lejohej të hyjë në shtëpinë e tij dhe të marrë pajën e gruas së tij të re. Disa ishin të mendimit se ndikimi i krishterimit ka luajtur një rol për bërjen e një politike të re në lidhje me shkurorëzimin, por shumica e dijetarëve kundërshtojnë idenë. Kundërshtimi i fesë krishtere për shkurorëzimin bëri një shoqëri ku burrat shumë lehtë mund të shkurorëzonin gratë e tyre, duke i dërguar ato në rrugë me vetëm rrobat e trupit. Qëndrimi i krishterë anti-divorc ndoshta u ngrit nga dëshira për të mbrojtur gratë, ndërsa legjislacioni i Kostandinit vendosi dënime më të mëdha për gratë. Çfarëdo që solli Ligji i Konstandinit nuk zgjati shumë, sepse perandorit Julian (360-363) i hoqi të gjitha ato ndëshkime.<sup>74</sup>

Presioni për ta bërë shkurorëzimin të vështirë vazhdoi dhe më 421 Kodi i Theodosit deklaroi se një grua që shkurëzonte të shoqin pa provuar atë si fajtor për krime të mëdha do të humbte dhuratën e saj të martesës dhe pajën dhe të deportohej përjetë. Nëse ajo mund të provojë se i shoqi ishte fajtor urdhri i dëbimit do të hiqej, por ajo kurrë nuk mund të martohej përsëri. Ky version i ligjit të divorcit zbatohet vetëm në gjysmën perëndimore të Perandorisë, dhe dënimet nuk janë aplikuar për shkurorëzimet me pajtimin e të dy bashkëshortëve. I zemëruar me atë se nuk kishte ndëshkime për shkurorëzime të njëanshme të pajustificueshme në Perandorinë Lindore, Valentiniani III në 452 lëshuar një dekret ku e vuri përsëri në fuqi ligjin mbi të shpallur nga Konstandini në 331. Kodi i Justinianit i vitit 449 solli një sërë arsyesh të tjera, për të cilat një grua në pjesën lindore të Perandorisë mund të bënte shkurorëzim të njëanshëm pa u dënuar. Në qoftë se burri i saj kishte tentuar ta vriste atë, nëqoftëse sillte prostituta në shtëpi ose kishte një marrëdhënie me një grua të martuar, atëherë gruaja mund të divorcohej nga burri i saj dhe të ruante pajën e saj. Në Perandorinë perëndimore mbeti pothuajse e pamundur për një grua të shkurorëzohej nga një martesë e pakënaqur vetëm n.q.s burri pajtohej ose ajo provonte se ai ishte një vrasës. Ndërsa ne mund të jetë mjaft e sigurt për atë që tha se ligji në temën e divorcit, prova nuk është aspak e qartë se çfarë ka ndodhur në botën e vërtetë.<sup>75</sup>

Me anë të dispozitës së tretë të tabelës së IV të ligjit të XII, ligjvënësi e rregullon çështjen e zgjidhjes së martesës së lidhur me anë të manus. Në këtë lloj të martesës zgjidhja bëhej me anë të mënyrës reale të ndërprerjes së bashkësisë martesore me urdhrin e burrit. "Ai burri i ka urdhëruar gruas ti mbledh sendet e saja, sipas Ligjit të XII Tabelave, ia ka marrë çelësat e shpisë dhe e ka dëbuar gruan". (I l-lam suam suas res sibi habere iussit ev XII tab., claves ademit, exxgit). Në këtë periudhë përmes dispozitave të së drejtës familjare dhe e anë të rregullave të pashkruara të sjelljes, adeteve (zakoneve) është lejuar divortio pa ndonjë arsye. Në bazë të dhënave nga literature juridike në të drejtën e lashtë civile, për të shkaktuar efektin juridik divorcion, duhej që burri t'i shqiptojë fjalët solemne (formulën). Këtu bëhet fjalë për rapudiumin – deklarimin e njëanshëm mbi shkurorëzimin: pjesën e parë të formulës e thotë burri (ashtu siç e ka rregulluar këtë çështje dispozita e tretë e tabelës IV e Ligjit të XII Tabelave. Burri nëse ka dashur që të zgjidh martesën me anë të shkurorëzimit, i ka urdhëruar gruas: Tuas restibi agito (bajë, mlidhi e merri me veti sendet e tua).<sup>76</sup>

Në të drejtën postklasike për shak të ndryshimeve në pikëpamjet morale që i solli me vet krishterizmi perandorët nxirrnin dispozita rigorozë mbi shkurorëzimin. Në këtë kohë egzistonin dy lloje të shkurorëzimit divortium cum damno dhe divortium sine damno apo shkurorëzim me pasoja të qëjia dhe shkurorëzim pa pasoja të këtilla. Divortium sine damno ndahej në divortium communi consensus apo shkurorëzim me marrëveshje reciproke të bashkëshortëve dhe divortium

<sup>74</sup> <http://www.womenintheancientworld.com/divorceinancientrome.htm>

<sup>75</sup> Po aty

<sup>76</sup> Musli Halimi, vep. E cit, fq.47

bona gratia apo shkurorëzim me vullnetin e njërit bashkëshort por për shkaqe të arsyeshme si janë: impotencia, sëmundjet seksuale, tërheqja në kuvend etj.Divortium cum damno poashtu ndahej në dy lloje repudium sine ulla causa apo shkurorëzim pa shkak të paraparë juridik dhe repudium ex justa apo shkurorëzim i njënjashëm me faj të njërit bashkëshort.Shkaqet që i jepnin të drejtë njërit bashkëshort të pafajshëm të shkurorëzohej pa kurfarrë pasojash të dëmshme ishin këto: shkelja e kurorës, vepra e rëndë penale, rrezikimi i jetës, kodoshllëku, jeta imorale etj.Pasoja e dëmshme e shkurorëzimit për njërin nga bashkëshort fajtor për shkurorëzimiin cum damno ishin humbja e pajës ndalimi i martesës së re , deportimi etj.Forma e shkurorëzimit ishte libellus repudi.<sup>77</sup>

## **3.2.Shkurorëzimi në periudhën e feudalizmit**

### **3.2.1.Shkurorëzimi në shtetin Frank**

Nën ndikimin e të drejtës romake shkurorëzimi mund të bëhej në mënyrë të njëanshme nga ana e burrit , ndërsa prej shekullit VII këtë të drejtë e fiton edhe gruaja.Kisha shumë herët fillon të ndërhyjë në çështjet martesore duke mbrojtur martesën dhe moralin seksual.Ajo thekson pengesat për lidhjen e martesës , bën ndalimin e lidhjes së martesës së re për personat e shkurorëzuar dhe dënon ashpër poligaminë , grabitjen e femrave dhe shitblerjen e tyre.<sup>78</sup>

### **3.2.2.Shkurorëzimi në shtetin Bizantin**

Divorci në shtetin Bizantin – Sipas të drejtës bizantine lehohej zgjidhja e martesës (shkurorëzimi) me ç’rast bëhej dallimi i zgjidhjes së martesës i shkaktuar sipas vullnetit të njërit nga bashkëshortët , më saktë i shkaktuar me fajin e njërit prej tyre ( cum damno) dhe shkurorëzimi që nuk varej nga vullneti i bashkëshortëve ( sine damno) .Në rastin e parë të zgjidhjes së martesës cum damno për palën që ishte fajtor parashihej dënimi i moslejimit të lidhjes së martesës së re.Në këtë rast gruaja humbte të drejtën e alimentacionit dhe të mbajtjes së mbiemrit të burrit. Bashkëshorti mund të shpallej fajtor për prishjen e martesës nëse kishte kryer delikt kundër shtetit , kishte tentuar vrasjen e bashkëshortës, gruaja kishte abortuar , tradhëtuar bashkëshortin.Edhe sjellja me mendjelehtësi e gruas është shfrytëzuar si shkas për prishjen e martesës.<sup>79</sup>Të drejtën e kërkesës për prishjen e martesës e kishte edhe gruaja në këto raste:

- 1) burri e mësitonte gruan në kurvëni,
- 2) nëse burri pa argumente e padiste gruan për kurvëni,
- 3) nëse gjatë fshehej nga bashkëshortja.

Shkaqet e prishjes së martesës sine damno kanë qenë:

- 1) paaftësia për martesë,
- 2) zhdukja pa shenjë për kohë të gjatë ,
- 3) zënia rob në luftë (sepse shëndërrohej në skllav) ,
- 4) sëmundja shpirtërore ,

<sup>77</sup> Ivo Puhan, vep.e cit, fq.190

<sup>78</sup> Hilmi Ismaili Fatmir Sejdiu, vep.e cit, fq.120

<sup>79</sup> Po aty



- 5) hyrja në manastir dhe
- 6) përkushtimi për peshkop.

Gruaja që shkurorëzohej sine damno kishte të drejtë në alimentacion , mund të lidhte martesë të re dhe deri të martohej të mbante mbiemrin e burrit.<sup>80</sup>

### **3.2.3.Shkurorëzimi në Francën feudale**

Në Francë ashti si edhe në vendet tjera të feudalizmit të zhvilluar , e drejta martesore dhe familjare rregullohej me të drejtën kanonike dhe tërësisht bie nën juridiksionin e kishës.E drejta kishtare caktonte kushtet dhe parashihte pengesat për lidhjen e martesës. Martesa ka qenë e pashkëputëshme.Në rastet ekstreme lehohej vetëm ndarja nga shtrati dhe tryeza.Bashkëshortët kanë qenë të detyruar për besnikëri bashkëshortore.Shkelja e këtij obligimi konsiderohej akt i ndëshkueshëm.<sup>81</sup>

## **3.3.Shkurorëzimi në periudhën liberale**

### **3.3.1.Shkurorëzimi në Angli**

Kohë më përpara, kur kisha ishte më e fuqishme se monarku, martesë ishte një institucion i kishës dhe kështu divorci ishte nën mbrojtjen e kishës. Martesa lidhej për tërë jetën dhe ishte jashtëzakonisht i rrallë, edhe pse kisha herë pas here jepte divorcin "a Mensa et Thoro", e cila u ka mundësuar njerëzve të jetojnë të ndarë nëse kanë pasur mosmarrëveshje të mëdha, por jo edhe të rimartoheshin. (Henry VIII, natyrisht, bëri gjithçka që ai donte.) Në shekullin e tetëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë , ishte e mundur për të bërë shkurorëzim të dhënë nga Akti i Parlamentit, por një opsion i tillë ishte i mundur vetëm për të pasurit. The Matrimonial Causes Act 1857 – ishte ligji i parë mbi shkurorëzimin me zbatim të përgjithshëm.Akti i vitit 1857 futi divorcin nëpërmjet gjykatës. Burrat ishin në gjendje të "drejtoheshin gjykatës" për shkurorëzim në bazë tradhëtis së gruas ,e cila tradhëti duhej të provohej.Gratë që dëshironin të shkurorëzoheshin nga burrat e tyre duheshin gjithashtu të provonin një faktor rëndues të tradhëtis , të tilla si përdhunimi apo incesti. Gjykata e Lartë në Londër ka qenë i vetmi vend për t'u shkurorëzuar , dhe procedurat janë mbajtur në gjyq të hapur.<sup>82</sup>

Ndryshimet e mëdha sociale në Angli gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore, sidomos për rolin e gruas në shoqëri, çuan në reformën e ligjit të divorcit.Akti martesor (The Matrimonial Causes Act) i nxjerrë në vitin 1923 i ka vënë burrat dhe gratë në pozita të barabarta për herë të parë, duke bërë të mundur secilit nga bashkëshortët t'i drejtohet gjykatës shkurorëzim në bazë të kurorëshkeljes së bashkëshortit të tyre. Në vitin 1937 një tjetër Akt martesor futi edhe tre opsione për bashkëshortët e pakënaqur , dhe kështu u bë e mundur të shkurorëzohen për shkak të mizorisë, dezertim dhe marrëzi të pashërueshme, si dhe për tradhti bashkëshortore. Këto janë quajtur "Vepra kundër martesës".Çdo pretendim duhej të dëshmohej nga ana e kërkuesit të shkurorëzimit . Lufta e Dytë Botërore solli një tjetër periudhë të ndryshimeve të mëdha shoqërore, si dhe fillim të një epoke të re. Në mesin e 1960tës - Arqipeshkvi i Canterbury-t me zyrën e tij ka përgatitur një raport që kërkonte reformimin e ligjit për të siguruar që njerëzit të

<sup>80</sup> Hilmi Ismaili Fatmir Sejdiu, vep.e cit, fq.144

<sup>81</sup> Po aty

<sup>82</sup> <https://www.theguardian.com>

mund të mund të shkurorëzoheshin në qoftë se ata mund të tregonin se martesë e tyre ka përfunduar, dhe qeveria e caktoi Komisionin Ligjor për të hulumtuar mënyrën më të përshtatshme për të modernizuar ligjet e divorcit. Ky proces solli Aktin Reformues të shkurorëzimit (Divorce Reform Act) të vitit 1969.<sup>83</sup>

Kjo iu mundësoi çifteve të cilëve martesë iu kishte përfunduar që të kërkonin shkurorëzimin në bazë të ndarjes së pakthyeshme të martesës, por kërkohej që ndarja të dëshmohej me dëshminë e një prej këtyre pesë "fakteve": kurorëshkelja, sjellje, dezertim, apo ndarje për 2 vjet dhe pëlqimin e palës tjetër për ndarje për pesë vjet. Poashtu një ndryshim tjetër që solli ky ligj ishte se shkurorëzimi për herë të parë mund të kryhej në gjykatën vendore lokale, në vend që të shkonin në gjykatën e lartë në Londër. Ligji mbi familjen 1996 detyroi të gjithë ata që donin të shkurorëzoheshin që të merrnin pjesë në një takim informativ duke hetuar mundësinë e pajtimit dhe diskutimin e ndërmjetësimit n.q.s kjo nuk ishte e mundur. Nëse ai ose ajo (ose ata) ende kërkonin të shkurorëzoheshin duheshin të bënin deklaratën e prishjes martesore në gjykatë, jo më pak se 3 muaj pas pjesëmarrjes në takimin informativ. Jo më shumë se 14 ditë pas dorëzimit të deklaratës, fillonte periudha e reflektimit që do të zgjaste 9 muaj nëse çifti nuk kishte fëmijë nën moshën 16 vjeç, ose 15 muaj në qoftë se ata kishin fëmijë nën 16 vjeç. Vetëm pas kësaj, gjykata mund të finalizonte shkurorëzimin. Ligji mbi shkurorëzimin në Angli i nxjerrë në vitin 2012 është kryesisht një miks i ligjeve të 1923, 1937 dhe 1969, me politikën e kohëve të fundit të bëra kryesisht nga avokatët.<sup>84</sup>

### 3.3.2. Shkurorëzimi në Gjermani

Shekulli i 19-të solli ndryshime të mëdha në ligjin e divorcit në shtetet gjermane. Rregullat ndryshonin varësisht nës shteti ndjekte traditën katolike apo protestante. Vetëm nga 1 janari e tutje Perandoria Gjermane qeverisej nga një ligj uniform i divorcit. Martesë mund të shkurorëzohej vetëm me urdhër të gjykatës. Arsyet për divorc ndjeknin parimin e fajësisë. Tradhtia, bigamia, vepra të caktuara seksuale, tentativa vrasje dhe dezertimi paraqisnin baza "absolute" për shkurorëzim. Një bashkëshort mund të kërkojë shkurorëzimin edhe kur pala tjetër kishte bërë një shkelje të madhe të detyrave të tij martesore ose me sjellje amorale. Këto ishin bazat "relative".<sup>85</sup>

Gjatë Rajhut të Tretë ligji i divorcit është ndryshuar rrënjësisht duke u shëndrruar në ligj të veçantë "Akti Martesor" i nxjerrë në 1938. Shkurorëzimi tani mund të bëhej edhe kur bashkësia martesore kishte pushuar së ekzistuari prej 3 vitesh dhe nuk kishte pritëshmëri për ribashkim. Megjithatë, edhe këtu çështja e fajit ka luajtur një rol : kur bashkëshorti në faj kërkonte shkurorëzim bashkëshorti tjetër mund ta kundërshtonte atë. Pas luftës së dytë botërore 'Akti martesor' i 1938-tës vazhdoi të aplikohet edhe për shumë kohë. Propozimet për reformim patën shumë pak sukses. Akti Reformues 1961 tentoi të kufizoj të drejtën për të kontestuar shkurorëzimin por nuk pati shumë dobi : Në praktikë, bashkëshortët të cilët kishin qenë të ndarë për 20 vjet ose më shumë shpesh nuk mund të shkurorëzoheshin për shkak të kundërshtimit të bashkëshortit të pafajshëm.<sup>86</sup> Të dy shtetet gjermane, të cilat kanë ekzistuar që nga 1949 deri në vitin 1990, kanë ndjekur qasje shumë të ndryshme ideologjike. Gjermania Lindore RDGJ ishte

<sup>83</sup> <https://www.lawteacher.net>

<sup>84</sup> <http://www.cflp.co.uk/a-brief-history-of-divorce/>

<sup>85</sup> Prof. Dieter Martiny - Grounds for divorce and maintenance between former spouses

<sup>86</sup> Po aty

më i shpejtë në zbatimin e reformës: 'Kodi i të Drejtës Familjare'(Familiengesetzbuch) 20 Dhjetor 1965 tani rregullonte të drejtën familjare jashta Kodit Civil Gjerman.Kishte vetëm një bazë për shkurorëzim e ajo ishte ndarja e pakthyeshme e martesës.Shkurorëzimi jepej për shkaqe të rënda , për të cilat martesë e kishte humbur kuptimin për bashkëshortët , fëmijët dhe për këtë arsye edhe për shoqërinë si tërësi.Pas rënies së regjimit komunist në vitin 1989, "Kodi i të Drejtës Familjare" u reformua tërësisht. Ligji i ri hyri në fuqi për vetëm tri ditë, edhe pse, që nga 3 tetori i vitit 1990 e tutje, të gjitha ligjet të Gjermanisë Perëndimore - Republika Federale e Gjermanisë janë bërë të zbatueshme në territorin e Gjermanisë Lindore - Republikës Demokratike Gjermane .Nga tani e tutje, një ligj uniform aplikohet në të gjithë Gjermaninë.<sup>87</sup>

### 3.3.3.Shkurorëzimi në SHBA

Në Amerikën koloniale, çështjet martesore dhe familjare kryesisht rregulloheshin nga doket zakonet etikën dhe normat fetare të kohës. Udhëheqësit fetarë dhe autoritetet civile kishin marrë idetë teologjike të shoqërisë së tyre në lidhje me fajësinë , pafajësinë dhe ndëshkimet për ata çiftet që kërkojnë divorcin.Shumë shpejt, autoritetet legjislative dhe gjyqësore morën përsipër rregullimin e çështjeve martesore dhe të divorcit. Në 1629, Kolonia e Massachusetts Bay ka krijuar një tribunal gjyqësor për çështjet e divorcit, që kishte kompetenca për të bërë shkurorëzime për shkak të tradhtisë bashkëshortore (arsyetimin kryesor se bashku me provën e fajësisë apo pafajësisë), bigami, dezertim, dhe impotencë.Kolonitë veriore kishin zhvilluar statutet për trajtimin e shkurorëzimeve , ndërsa kolonitë jugore ishin përqendruar në përpjekje për të ndaluar shkurorëzimin në përjashtim të rasteve të tradhtisë bashkëshortore të provuara ose pranuar.<sup>88</sup>

Deri në fillim të 1770 qëndrimet ndaj shkurorëzimit ishin më strikte,por më pas sidomos pas revolucionit Amerikan qëndrimi i përgjithshëm i shoqërisë kundrejt shkurorëzimeve ishte më i butë.Pas vitit 1777 shtetet e pavarura nxorën juridiksion për shkurorëzim.Pas vitit 1776, shtetet e pavarura filluan me krijimin e juridiksionit për divorc.Ligjvënësit e kuptuan se seancat e shkurorëzimit iu merrnin shumë kohë nga punët e tyre të rëndësishme të nxjerrjes të ligjit,andaq dhënia e shkurorëzimeve iu dha si detyrë gjyqësorit.<sup>89</sup>

Deri në fund të shekullit të 18-të, ka pasur shtete të shumta vende të tilla si Indiana, Utah, dhe Dakota ku njerëzit shkonin dhe të merrnin një divorc. Shumë qytete ofronin akomodim, restorante, bare ishte bërë dhe kjo kishte filluar ti ngajë një tregtie. Në vitin 1887, Kongresi urdhëroi përpilimin e parë të statistikave të shkurorëzimit në nivel federal për të parë se sa i madh ishte bërë problem i shkurorëzimit.Në 1920 u krijuan gjyqet martesore që lejonin një çiftit për të provuar martesën pa qenë të martuar ;por që nuk ka fëmijë apo ndonjë angazhim financiar gjatë gjithë jetës. Në një mënyrë ajo ishte thjesht dy njerëzi të gjinisë së kundërt që jetonin në të njëjtën vend.Por për atë kohë, ajo ishte një koncept i ri dhe ishte një nga mënyrat e para në të cilat ligji u përpoq për të akomoduar kontratat paramartesore. Në kohën kur kombi amerikan u gjend i përfshirë në dy luftëra botërore, shkurorëzimi u vu në plan të dytë mori gjë që i bëri ligjvënësit të shqetësoshin. Megjithatë, sistemi i Gjykatave Familjare që filloi në 1950 ishte hera e parë në dekada që legjislatura dhe sistemi gjyqësor në SHBA trajtoi çështjen e divorcit.Ndoshta ndryshimi më i madh për ligjin e shkurorëzimit në historinë e SHBA- ve erdhi

<sup>87</sup> Prof. Dieter Martiny - Grounds for divorce and maintenance between former spouses

<sup>88</sup> <http://www.lifemanagement.com/fsa8.2.1137/>

<sup>89</sup> <http://historycooperative.org/the-history-of-divorce-law-in-the-usa/>

me shkurorëzimet pa faj në vitin 1970. Deri atëherë për tu shkurorëzuar patjetër duhej që njëra palë të ishte fajtores. Por me këtë ndryshim shkurorëzimi mund të bëhej edhe nëse asnjëri bashkëshort nuk ishte me faj.<sup>90</sup>

### 3.3.4. Shkurorëzimi dhe Revolucioni Francez Borxhez

Në Francë ligji i parë për shkurorëzimin u paraqit në vitin 1792. Ky ligj krijoi një gjykatë të familjes (të ashtuquajtur tribunal de famille) për të trajtuar rastet e shkurorëzimit. Duke u bazuar në këtë ligj gjykata e familjes ishte kompetente të jepte shkurorëzimin në bazë të "incompatibilité d'humeur" që do të thotë papajtueshmërinë e palëve ose e karaktereve të tyre. Kjo gjykatë përpiquej ti pajtonte bashkëshortët. Gjykata familjare gjithashtu kishte juridiksion për të dhënë shkurorëzimin për arsye që kishin të bënin vetëm me njërin palë, të tilla si sëmundje mendore, të qenurit i dënuar me një dënim të turpshëm, keqtrajtimi i bashkëshortit, sjellje e pamoralshme (për shembull tradhti bashkëshortore), dezertim dhe emigrim. Në ligjin e parë francez të shkurorëzimit ne shohim pothuajse të njëjtat arsye për shkurorëzim sikur në antikitet ku arsyet për shkurorëzim ishin dezertimi, sjellje jomorale të tilla si tradhëti bashkëshortore dhe të qenurit i dënuar me dënim të turpshëm. Ligji i parë francez mbi shkurorëzimin pati një ndikim të madh në Francë. Në Paris papritmas kishte më shumë shkurorëzime se sa martesat.<sup>91</sup>

Megjithatë, pas revolucionit Francez qëndrimi mbi jetën familjare ndryshoi tërësisht. Projekt-ligji i ri reformues i Jacqueminot (1799) propozoi shërimin (rimëkëmbjen) e familjes dhe reduktimin e shkurorëzimeve. Në Kodin Civil Francez vihet re dukshëm ndikimi i fuqishëm i patria potestas-it. Në veprën e famshme të Robert Joseph Pothier - it "*Traité de la puissance du mari sur la personne et les biens de la femme*" ne mund të lexojmë dhe shohim se burri ishte përsëri shefi i martesës dhe kishte autoritet mbi gruan e tij. Në Francë lidhja martesore filloi të konsiderohej shumë e rëndësishme dhe kështu shkurorëzimi u bë më i vështirë si pasojë e zvogëlimit të numrit të arsyeve për shkurorëzim. Në Kodin Civil të Francës (1804) shkurorëzimi në bazë të "incompatibilité d'humeur" nuk lejohej më. Vetëm "séparation des corps" (ndarja e trupave) ishte i mundur, një shkurorëzim për arsye të veçanta. Arsyet siç janë: sëmundje mendore, dezertim dhe emigrim nuk njiheshin më, dhe u bë më e vështirë të bëhet një shkurorëzim me pëlqim reciprok të palëve. Arsyet e vetme për shkurorëzim në Kodin Civil Francez ishin: shkelja e kurorës (tradhëti bashkëshortore), sjellje devijante, mizoria (sjellja e ashpër ose e egër), fyerja ose nëpërkëmbje, dhe dënimi i njërit bashkëshort me dënime të rënda. Këto arsye për shkurorëzim filluan të aplikoheshin edhe në Hollandë në vitin 1811 kur ajo u bë provincë e Francës.<sup>92</sup>

<sup>90</sup> <http://historycooperative.org/the-history-of-divorce-law-in-the-usa/>

<sup>91</sup> Emese von Bóné, vep. E cit, fq.1010

<sup>92</sup> Po aty

## KAPITULLI I TRETË

### 4.SHKURORËZIMI NË REPUBLIKËN E SERBISË

#### 4.1.Rregullimi juridik i shkurorëzimit në Republikën e Serbisë

##### 4.1.1.Kushtetuta e Republikës së Serbisë

Republika e Sërbisë i takon vendeve që në legjislacionin e tyre kanë pranuar sistemin e shkurorëzimit si mjet shërues ilaç , për shkak të të çrregullimit serioz të marrëdhënieve bashkëshortore.<sup>93</sup> Kushtetuta e Republikës së Serbisë garanton gjithkujt të drejtën për vendosje të lirë si për kurorëzim ashtu edhe për shkurorëzim.<sup>94</sup>

##### 4.2.2.Ligji për Familjen i Republikës së Serbisë

Ligji për familjen në fuqi i Republikës së Serbisë është publikuar në Gazetën Zyrtare të Serbisë me numër 18/2005 ndërsa ka hyrë në fuqi pas 8 ditësh më 1 korrik 2015. Ligji ka dymbëdhjetë pjesë dhe ka gjithsej 363 nene. Ky ligj rregullon: martesën dhe marrëdhëniet në martesë, marrëdhëniet në bashkësi jashtëmartesore, marrëdhënieve mes fëmijës dhe prindërve, adoptimin, kujdestarinë, mbajtjen, marrëdhëniet pasurore në familje, mbrojtjen kundër dhunës në familje, si dhe emrin personal.<sup>95</sup> Ligji për familjen i Republikës së Serbisë ka paraparë dy mënyra të shkurorëzimit të martesës : shkurorëzimi me marrëveshje të bashkëshortëve që duan të shkurorëzohen edhe shkurorëzimi me padi nga ana e njërit bashkëshort.

Neni 40 i këtij ligji rregullon shkurorëzimin me marrëveshje.Ky nen iu jep të gjithë bashkeshortëve të drejtën e shkurorëzimit nëse arrijnë marrëveshje me shkrim mbi shkurorëzim.Marrëveshja me shkrim patjetër duhet të përfshijë edhe marrëveshjen mbi kryerjen e të drejtave prindërore si dhe marrëveshjen mbi ndarjen e pasurisë.

Neni 41 rregullon shkurorëzimin me padi.Ku thotë se çdo bashkëshort ka të drejtën e shkurorëzimit për shkak të të çrregullimit serioz dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve bashkëshortore ose nëse nuk mund të realizohet bashkëjetesa e bashkëshortëve.

Rolin të cilin ja jep Ligji për Familjen autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve tek shkurorëzimi i martesës në thelb nënkupton mospasjen e brengosjes së interes shoqëror.Interesi i familjes dhe vet shoqërisë për stabilitetin e fmiiljes është zhdukur gati ndaj interesit nga ana e secilit bashkëshort si interese personale të veqanta.Kjo mënyrë e liberalizimit të madh të shkurorëzimit e dobëson familjen si celulën më të rëndësishme të shoqërisë.<sup>96</sup>

---

<sup>93</sup> Zoran Ponjaviq, vep. E cit, fq.168

<sup>94</sup> Kushtetuta e Serbisë , neni.62

<sup>95</sup> Neni 1 i Ligjit për Familjes i RS

<sup>96</sup> Zoran Ponjaviq, vep.e cit, fq.123

### 4.2.3.Konventat dhe dokumentet ndërkombëtare që e rregullojnë shkurorëzimin

Konventat ndërkombëtare që rregullojnë materien e martesës familjes janë dokumenta të cilat përpilohen me qëllim të mbrotjes së të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe në kuadër të tyre bën pjesë edhe e drejta e njeriut për të lidhë martesë si dhe e drejta për të zgjidhur martesën poashtu.Rregullimi i shkurorëzimit me dokumente ndërkombëtare është një domosdoshmëri për të futur parimet e mbrotjes së të drejtave të njeriut në legjislacionet dhe kushtetutat e shteteve përkatëse.Republika e Serbisë ka marrë statusin e vendit kandidat për të hyrë në Unionin Evropian andaj ajo ka nënshkruar dhe po nënshkruan konventa të shumta me qëllim të harmonizimit të legjislacionit të saj me atë të UE-së si dhe me qëllim të mbrotjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut. Dokumentet më të rëndësishme për të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me rregullimin juridik të marrëdhënieve familjare janë:

- a) Deklarata e përgjithshme për të drejtat e njeriut (1948)
- b) Konventa e Hagës për njohjen e shkurorëzimit dhe ndarjes ligjore(1970)
- c) Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut
- d) Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave(1979)
- e) Konventa për të drejtat e fëmijës (1990)
- f) Rekomandimi nr.R(98) 1 i Këshillit të Evropës mbi ndërmjetësimin në marrëdhëniet familjare
- g) Konventa mbi të drejtën e cila aplikohet të detyrimet e ushqimisë (alimentacionit) ndaj fëmijëve (1958)
- h) Konventa mbi njohjen dhe egzekutimin e vendimeve mbi alimentacionin (ushqimisë)1973
- i) Konventa mbi kompetencën,të drejtën kompetente,njohjen,ekzekutimin dhe bashkëpunimin në çështjet e përgjegjësisë prindërore dhe masave mbi mbrotjen e fëmijëve 1996.<sup>97</sup>
- j) Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1996).

Nga dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare sa i përket shkurorëzimit do të thosha është Konventa e Hagës për njohjen e shkurorëzimit dhe ndarjes ligjore(1970) ka për qëllim lehtësimin e njohjes së shkurorëzimit dhe të ndarjes ligjore nga ana e shteteve nënshkruese të kontratës me çka mundësohet njohja e vendimeve të mara nga një shtet në shtetin tjetër dhe me këtë i iket përsëritjes së procedurava për të njejtën çështje , dhe në këtë mënyrë harxhimeve që shkaktohen .Poashtu dokument tjetër shumë i rëndësishëm është edhe Deklarata e përgjithshme e të drejtave të njeriut ku parashihet e drejta e lidhjes së martesës çdo burri dhe gruaje të moshës madhore pa dallim race shtetësie apo besimi.Kjo e drejtë e barabarësisë u njihet apo garantohet si me rastin e lidhjes , gjatë martesës si dhe në rast të shkurorëzimit.<sup>98</sup>

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave është poashtu instrument i rëndësishëm që i obligon shtetet anëtare që të sigurojnë mbi bazën e barabarësisë së burrit dhe gruas , të drejtën e barabartë si gjatë lidhjes së martesës ashtu edhe gjatë zgjidhjes së saj.Konventa poashtu iu garanton te drejta dhe obligime të njejta mes burrit dhe gruas si prindër pavarësisht nga gjendja martesore.Në të gjitha rastet interesi i fëmijëve duhet të jetë primar.<sup>99</sup>

<sup>97</sup> Asllan Billalli, Hajredin Kuçi, vep.E cit, fq.148

<sup>98</sup> Neni 16 alinea.1 e Deklaratës së përgjithshme të të drejtave të njeriut

<sup>99</sup> Neni 16,alinea 1-5 e Konventës për eliminimin e diskriminimit ndaj grave

Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut instrument i rëndësishëm i mbrotjes së të drejtave të njeriut. Sipas nenit 7 të kësaj konvente: Bashkëshortët do të gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësish të karakterit të së drejtës private midis tyre dhe në marrëdhënie me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rastin e zgjidhjes së saj.<sup>100</sup>

Rekomandimi nr.R(98) 1 i Këshillit të Evropës mbi ndërmjetësimin në marrëdhëniet familjare është instrument juridik ndërkombëtar i cili vendos parimet që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin në marrëdhëniet familjare. Rekomandimi afirmon :

- a) pjesëmarrja konsensuale dhe zvogëlimi i konfliktit në interes të të gjithë anëtarëve të familjes ,
- b) mbrojtjen më të mirë të interesave të fëmijëve,
- c) reduktimin apo minimizimin e pasojave negative të shpërbërjes së familjes,
- d) mbajtja e përhershme e marrëdhënieve mes anëtarëve të familjes , veçanërisht në mes prindërve dhe fëmijëve të tyre,
- e) reduktimin e kostove ekonomike dhe sociale të shkurorëzimit si për familjen ashtu edhe për shtetin.

Parimet më të rëndësishme të ndërmjetësimit familjar përfshijnë:

1) aplikimin e ndërmjetësimit familjar në kontestet ndërmjet anëtarëve të familjes , pa marrë parasysh nëse janë të lidhur me farsifisni , martesë apo janë në ndonjë marrëdhënie që ligji nacional i konsideron marrëdhënie familjare;

2) organizimin e ndërmjetësimit në mënyrë që secila palë të marrë pjesë në procedurë vullnetarisht, se ndërmjetësimi kryhet në sektorin publik ose privat , por me ekzistimin e procedurave të veçanta për përzgjedhjen , trajnimin dhe kualifikimin e ndërmjetësuesit dhe të respektohen standardet në procedurën e ndërmjetësimit,

3) rregullat e sjelljes së ndërmjetësuesit ( paanësia, neutraliteti, respektimi i pozitës së secilës palë dhe ruajtja e barazisë së pozicioneve të tyre negociuse, privatësia, konfidencialiteti, dhënia e mundësisë që kontesti të zgjidhet përmes këshillimit martesor, kujdesi i veçantë për mirëqenien e fëmijëve, kujdesi në rastet e dhunës në familje etj).<sup>101</sup>

Konferenca e Hagës për të drejtën ndërkombëtare private dhe Këshilli i Evropës , kanë rol aktiv në sferën e së drejtës familjare .Gjatë dhjetë viteve të fundit janë sjellur shumë konventa, në sferën e të drejtës familjare në përgjithësi e në veçanti edhe të njohjes së shkurorëzimit. Edhe Unioni Evropian kishte interes për të drejtën familjare duke i sugjeruar për harmonizim të legjisllacioneve mes shteteve anëtare por edhe të atyre që pretendojnë të hynë në Union. Këshilli i Evropës në vitin 200 ka sjellur Rregullativën Brisel 2 e cila në 2003tën u zëvendësua me Brisel 2 Bis , e cila ka të bëjë me juridiksionin dhe njohjen dhe përmbarimin e vendime gjyqësore me shkurorëzim.<sup>102</sup>

<sup>100</sup> Arta Mandro, vep.E cit, fq.302

<sup>101</sup> Marija Drashkiq, vep. E cit, fq.150

<sup>102</sup> Liljana Spirovik Trpenovska, vep.E cit, fq.45

## 4.2.Shkaqet e shkurorëzimit sipas legjislacionit të Republikës së Serbisë

Rregullat e mëhershme të së drejtës familjare zakonisht përmbanin një seksion të emërtuar "Shkaqet për shkurorëzim të martesës".<sup>103</sup> Shkaqet për shkurorëzim janë fakte ose rrethana të cilat janë të parapara me ligj si të mjaftueshme për përfundimin e martesës së vlefshme gjatë jetës së të dy bashkëshortëve.E drejta martesore pozitive e R.Serbisë miraton sistemin e shkurorëzimit si mjet shërues pra si ilaç.Të gjitha shkaqet për shkurorëzim të martesës mund të klasifikohen në bazë të disa kriteriumeve:

a) *Shkaqet absolute dhe shkaqet relative për shkurorëzimin e martesës.*Për shkaqet absolute është karakteristike se atyre ligji iu jep kuptim si shkaqe të pavarura për shkurorëzim.Ndërsa shkaqet relative të shkurorëzimit nuk janë fakte që kanë kuptim të pavaruara por prania e tyre është e nevojshme por jo edhe kusht i mjaftueshëm për kërkimin të shkurorëzimit.Me fjalë të tjera këto fakte nuk janë të mjaftueshme që vetë të sjellin shkurorëzimin e martesës por duhet të jenë të lidhura me rrethana të tjera plotësuese ashtuqë gjykata të shkurorëzojë martesën e caktuar.Këto shkaqe janë rezultat i vendimit dhe dëshirës së ligjvënësit dhe teknikës ligjore përkatëse.Prandaj një fakt i njejtë mund të jetë shkak absolute në një legjislacion ndërsa shkak relativ në një legjislacion tjetër.Në të drejtat bashkëkohore shkaqet absolute janë shumë të rralla pothuajse janë zhduk.<sup>104</sup>

b) *Shkaqet e përgjithshme dhe shkaqet e veqanta për shkurorëzimin e martesës.*Me shkak të përgjithshme nënkuptohet ai fakt ose më shumë fakte të tilla që përfshin në vete një numër të madh të shkaqeve për shkurorëzim. Shkak i padefinuar mir një numer shkaqesh te njeja ose te ngjajshme qe mund te grumbullohen nje nje shkak te vetëm.Shkaku i përgjithshëm është rezultat i asaj se është e pamundur të bëhet numrimi i të gjitha shkeljeve të mundshme të obligimeve martesore ose të bëhet një listë e situatave jetësore që mund të qojnë në shkurorëzim.Për dallim nga shkaqet e përgjithshme shkaqet e veqanta për shkurorëzim janë ato të cilat ligjvënësi saktësisht dhe në mënyrë specifike emërton faktin ose rrethanën për të cilën mund të kërkohet shkurorëzimi.<sup>105</sup>

c) *Shkaqet e fshehura dhe jo të fshehura për shkurorëzim .*Kjo ndarje bazohej në sjelljen e bashkeshortit gjatë jetesës së përbashkët.Në shkaqet e fshehura bëjnë pjesë faktet apo rrethanat të cilat llogariten si veprime të palejuara të njërit ose të dy bashkëshortëve (tradhëtia bashkëshortore, braktisja me qëllim të keq ose për shkak të pajustificuar, dënimi për vepër të turpshme , shkelja e rëndë e obligimeve martesore). Shkaqet jo të fshehura janë ato të cilat lindin nga realiteti i jetës dhe nuk kanë lidhje me dëshirën apo veprimin e gabuar të bashkëshortit tjetër pra shkurt nuk janë në dorë të bashkëshortit tjetër(zhdukja , sëmundje mendore, çrregullimi serioz dhe i vazhdueshëm i marrëdhënieve bashkëshortore). Kjo ndarje ka prejardhjen nga juristi gjerman Savini.Shkaqet më të vjetra për shkurorëzim kanë qenë të bazuara në teorin e fajësisë, vetë Savini ka konsideruar se vetëm shkaqet e fshehura mund të jenë arsye të justifikuar për shkurorëzim.Edhe shkaqet e fshehura gati pothuajse janë zhdukur nga e drejta familjare krahasuese.Në sistemin e shkurorëzimit si ilaç si shkak jo i fshehur zakonisht formulohet si çrregullimi i rëndë i marrëdhënieve bashkëshortore.<sup>106</sup>

<sup>103</sup> Zoran Ponjavić, vep. E cit, fq.169

<sup>104</sup> Marija Drashkiq, vep. E cit, fq.138

<sup>105</sup> M. Mladenović,S. Panov, vep. E cit, fq.239

<sup>106</sup> Po aty



Ligji Familjar i Serbisë nuk e përmban më seksionin ‘‘Shkaqet për shkurorëzim’’ por vetëm titull brenda seksionit të tretë – ‘‘Shkurorëzimi i martesës’’.Këtu nuk bëhet fjalë për shkaqet e shkurorëzimit të martesës.Kjo mënyrë e redaktimit të rregullave të shkurorëzimit të martesës në Ligjin mbi Familjen të Serbisë nxjerr në pah përfundimin se ato janë mënyra të kërkimit të shkurorëzimit, mënyra të inicimit të procedurës, e jo shkaqe të shkurorëzimit.Ato janë të kufizuara në dy mundësi : shkurorëzimi me marrëveshje (me kërkesë të dy bashkëshortëve) , dhe shkurorëzimi me padi ( me kërkesë të njërit bashkëshort).<sup>107</sup>

### 4.3.Procedura e shkurorëzimit në Republikën e Serbisë

#### 4.3.1.Mënyrat e zgjidhjes së martesës

Siç e kam cekur edhe më lart Ligji mbi Familjen i Republikës së Serbisë ka parashikuar dy mënyra të shkurorëzimit :

- 1)shkurorëzimin me padi nga ana e njërit bashkëshort dhe
- 2)shkurorëzimi me marrëveshje të bashkëshortëve.

*Shkurorëzimi me padi* - Kjo mënyrë e shkurorëzimit në të drejtën serbe është e definuar si çrregullim serioz dhe i vazhdueshëm i marrëdhënieve bashkëshortore ose pamundësia objektive e realizimit të jetesës së përbashkët të bashkëshortëve. Kjo zgjidhje është bashkëkohore dhe shumë e sukseshme në pikepamje të kasaj mënyreje të shkurorëzimit. Është aq gjithëpërfshirëse saqë përjashton nevojën e ekzistencës së çfarëdo shkakut të veçantë.Ky në thelb shkak i përgjithshëm përmban shkaqe konkrete të panumërta të cilat sjellin çrregullimin serioz dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve bashkëshortore ose pamundësin objektive të realizimit të bashkëjetesës së bashkëshortëve.

Megjithatë e drejta serbe nuk i potencon këto shkaqe konkrete as edhe si shembuj , siç ka qenë rasti dikur më herët , kështuqë ato shtrihen në të gjitha ato shkaqe të panumërta që sjellin deri të mos realizimi i jetesës së përbashkët.Me këtë edhe shkak de facto ka humbur rëndësin , tani rëndësia kryesore kanë pasojat.Shkaqet janë të shumta saqë çdo përpjekje për ti përmbledhur është jo i plotë.Këtu mund të ishin përfshirë : mosmarrëveshja lidhur planifikimin e familjes , vendi ku do të jetojnë , mosmarrëveshje me të afërmit e njërit bashkëshort , alkoolozmi , tradhëtia bashkëshortore , trajtimi i fëmijëve dhe shumë e shumë shkaqe të paemërtuara.Më e rëndësishme është se ai shkak në të shumtën e rasteve disa shkaqe sjellin çrregullimin serioz dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve bashkëshortore ose vinë në një situatë që nuk mund të realizohet jetesa e përbashkët e bashkëshortëve.<sup>108</sup>

Por megjithatë që çrregullimi i marrëdhënieve bashkëshortore të jetë shkak i vlefshëm ajo duhet të jetë serioze dhe i gjatë.Serioze është ai çrregullim i cili i ka prekur rëndë marrëdhëniet bashkëshortore , i ka goditur thellë vetë themelet e martesës dhe ka ndërprerë plotësisht çdo komunikim ndërmjet bashkëshortëve.Çrregullim permanent ose i vazhdueshëm është ai çrregullim që zgjat një kohë të gjatë dhe e cila nuk ka perspektivë që kriza e krijuar ndërmjet bashkëshortëve të përfundojë.Pamundësia objektive e realizimit të jetesës së bashkëshortëve është gjithashtu shkak i përgjithshëm relativ dhe jo i fshehur për tu shkurorëzuar në të drejtën serbe.Qëllimi i martesës është krijimi dhe mbajtja e jetesës së përbashkët të bashkëshortëve,

<sup>107</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.170

<sup>108</sup> Po aty

jetesës së vërtetë të plotë dhe harmonike. Nëse jetesa e tillë nuk është fare i mundur të realizohet, secili nga bashkëshortët ka të drejtën për të kërkuar shkurorëzimin.<sup>109</sup>

*Shkurorëzimi me marrëveshje* - Shkurorëzimi i martesës i cili bazohet vetëm në pëlqimin e të dy bashkëshortëve emërtohet si shkurorëzim me marrëveshje. Pra shkurorëzimi me marrëveshje ekziston atëherë kur të dy bashkëshortët duan dhe kërkojnë shkurorëzimin. Shkak për shkurorëzim në këtë rast nuk mund të jetë asnjë fakt që konsiderohet si shkak për tu shkurorëzuar, por vetëm pëlqimi (i padyshimt) i shprehur i bashkëshortëve që martesa e tyre të shkurorëzohet. Te shkurorëzimi i martesës me marrëveshje bashkëshortët përpiqen që me pëlqimin e vullnetit të tyre të ndërpresin martesën e tyre, për të cilën konsiderojnë se nuk mund të mbijetojë. Me këtë rast bashkëshortët nuk i potencojnë shkaqet, të ashtuquajturat fakte dhe rrethana për të cilat nuk mund të jetojnë më bashkë. Pikërisht një nga arsytet e ekzistimit të shkurorëzimit me marrëveshje qëndron mos-potencimin e këtyre fakteve dhe rrethanave, me çka bashkëshortët arrijnë të ruajnë intimitetin. Gjykata nuk mund të shyrtojë (të pyet) shkaqet e çrregullimit të marrëdhënieve bashkëshortore.<sup>110</sup>

Shkurorëzimi me marrëveshje në të drejtën serbe është e rregulluar me nenin 40 të Ligjit mbi Familjen. Sipas tij “Bashkëshortët kanë të drejtën e shkurorëzimit të martesës nëse arrijnë marrëveshje me shkrim për shkurorëzim. Kjo marrëveshje i shkruar dhe nënshkruar nga bashkëshortët prodhon efekte juridike vetëm nëse futet në dispozitivin e aktgjykimit mbi shkurorëzimin e martesës. Bashkëshortët miren vesh mbi shkurorëzimin dhe pasojat e tij dhe gjithë kjo është nën kontroll të gjykatës. Shkurorëzimi me marrëveshje i rregulluar në këtë mënyrë iu jep mundësi bashkëshortëve që vet të vendosin për fatin e martesës, në të njëjtën kohë me kontrollën e shoqërisë të drejtuar në atë që para se gjithash të sigurohen interesat e fëmijëve. Kjo kontrollë e shoqërisë në rastin konkret realizohet nëpërmes obligimit të bashkëshortëve që të arrijnë jo vetëm marrëveshje me shkrim mbi shkurorëzimin por edhe të përmbajë marrëveshje mbi kryerjen e të drejtave prindërore dhe marrëveshje për ndarjen e pasurisë.<sup>111</sup> Është padyshim në interes të fëmijëve që faktet që janë me rëndësi për sjelljen e vendimit mbi dhënie në kujdestari për rritje dhe edukim njërit prej prindërve, vendimin mbi përcaktimin e mbajtjes (ushqimia), vendimin për përcaktimin e mënyrës me të cilën do të realizohen marrëdhëniet personale mes fëmijut dhe prindit tjetër, ti nënshtrohen një analize të hollësishme para gjykatës. Për atë edhe gjykata kur mungojnë marrëveshja mbi kryerjen e të drejtave prindërore apo marrëveshja mbi ndarjen e pasurisë së përbashkët do të veprojnë si parashtrësë e parregullt dhe ua kthen propozimin për shkurorëzim me marrëveshje për ta plotësuar dhe iu jep afat për ta paraqitur prap propozimin. Nëse bashkëshortët nuk veprojnë në bazë të urdhërit të gjykatës nuk e sjellin propozimin në afatin e përcaktuar propozimi për shkurorëzim me marrëveshje konsiderohet si i tërhqur, ndërsa nëse e sjellin jo të kompletuar pa e përmirësuar gjykata propozimin për shkurorëzim me marrëveshje do ta hedhi poshtë me vendim si i çrregullt.<sup>112</sup>

Autorizimi tjetër i gjykatës është të vlerësojë nëse marrëveshja për kryerjen e të drejtave prindërore është në interesin më të mirë për fëmijun. Gjykata pra nuk përzihet për shkurorëzimin e martesës por te marrëveshja mbi kryerjen e të drejtave prindërore do të ndërhyjë për ti mbrojtur interesat e fëmijut. Kështu nëse gjykata vlerëson se marrëveshja korrespondon me interesin e fëmijëve e fut atë në aktgjykim si vendim të gjykatës dhe në këtë mënyrë e bën të

<sup>109</sup> Zoran Ponjavić, vep. E cit, fq.176

<sup>110</sup> Po aty

<sup>111</sup> Marija Drashkiq, vep. E cit, fq.86

<sup>112</sup> Po aty

ekzekutueshme. Në të kundërtën nëse gjykata vlerëson se marrëveshja nuk është në dobi të fëmijës ,atëherë të drejtat prindërore mund ti rregullon ndryshe nga ajo si janë marrë vesh prindërit. Në të drejtën serbe është përcaktuar me ligj që bashkëshortët janë të detyruar që në marrëveshjen për shkurorëzim të përpilojnë edhe marrëveshje mbi ndarjen e pasurisë së përbashkët. Qëllimi i ligjdhënësit ka qenë të inkurajojë bashkëshortët që edhe këtë segment të marrëdhënieve të tyre ta rregullojnë mes veti me marrëveshje në mënyrë që të kenë të drejtën e shkurorëzimit të martesës me marrëveshje.<sup>113</sup>

### 4.3.2. Inicimi i procedurës

Në çështjet martesore fillimi i procedurës është i lidhur vetëm për personalitetin e bashkëshortëve .Kjo rregull vlen vetëm në çështjet gjyqësore për shkurorëzim të martesës pa marr parasysh nëse procedura inicohet me padi ose me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje. Këtë të drejtë nuk e kanë trashëgimtarët e tyre. Por kjo nuk do të thotë që procedura nuk mund të inicohet përmes përfaqësuesit me prokurë. Kjo mundësi është e paraparë me ligj në nenin 221 të Ligjit të Familjes të R. Serbisë .Prokura duhet të jetë e vërtetuar dhe e lëshuar posaqërisht vetëm për përfaqësim në çështjen martesore. Mundësia e përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit të autorizuar është e paraparë pa marr parasysh nëse është paraqitur padi apo propozim për shkurorëzim me marrëveshje. Te procedura e shkurorëzimit me marrëveshje të dy bashkëshortët nuk mund ti përfaqësojë i njëjti përfaqësues. Për tu shkurorëzuar me marrëveshje të dy bashkëshortët duhet të kenë zotësinë për të vepruar. Nëse njëri prej tyre nuk e ka zotësinë për të vepruar atëherë procedura mund të fillojë vetëm me padi. Akti inicues - Kur ekziston kontesti procedura fillon me padi. Ndërsa kur mes bashkëshortëve nuk ekziston kontesti procedura nuk fillon me padi por me propozim për shkurorëzim me marrëveshje.<sup>114</sup>

### 4.3.3. Kompetenca e gjykatës

Kompetenca vendore është e rregulluar me Ligjin për Procedurën Kontestimore. Kompetencë vendore ka gjykata në teritorin e së cilës i pandehuri ka vendbanimin ose vendqëndrimin (kompetenca vendore e përgjithshme) respektivisht gjykata në teritorin e së cilës bashkëshortët kanë pasur vendbanimin ose vendqëndrimin e fundit të përbashkët. Kompetencë lëndore gjithmonë kanë gjykatat me kompetencë lëndore të përgjithshme. Kompetenca lëndore është e rregulluar me ligj të posaqëm. Sipas Ligjit për rregullimin e gjykatave në shkallë të parë janë kompetente gjykatat themelore ndërsa në shkallë të dytë gjykatat e Apelit. Kompetenca funksionale është e rregulluar në atë mënyrë që në shkallë të parë gjykon gjygtari i vetëm dhe dy porotë , ndërsa në shkallë të dytë gjykojnë tre gjygtarë.<sup>115</sup>

<sup>113</sup> Marija Drashkiq, vep. E cit, fq.85

<sup>114</sup> Zoran Ponjavić, vep. E cit, fq.182

<sup>115</sup> Po aty

#### 4.3.4.Parimet e procedurës së shkurorëzimit

Marrëdhëniet të cilat rregullohen kontestet martesore janë të natyrës personale prandaj dallojnë nga marrëdhëniet tjera juridike si për nga rëndësia ashtu edhe nga natyra. Martesa është institucion shoqëror dhe juridik andaj ajo rregullohet me norma urdhëruese ligjore dhe me anë të saj shoqëria synon realizimin e qëllimeve konkrete. Kur këto qëllime nuk arrihen martesa duhet të zgjidhet me vendim të gjykatës e cila vlerëson plotësimin e kushteve të parapara me të drejtën material. Për këtë arsye gjykata ka detyrë të rëndësishme të vërtetojë të vërtetën dhe të vlerësojë arsyen e të qenit të mëtejshëm të martesës. Nisur nga kjo rregullat që zbatohen në procedurën e zgjidhjes së martesës janë të veçanta. Në kontestet martesore zbatohen rregullat e procedurës civile vetëm në rastet kur nuk janë paraparë rregulla të veçanta me normat e Ligjit për Familjen.<sup>116</sup> Parimet kryesore të procedurës së shkurorëzimit janë:

##### a) Parimi i barabarësisë së bashkëshortëve gjatë procedurës së shkurorëzimit

Marrëdhëniet martesore janë rregulluar mbi parimin e barabarësisë së bashkëshortëve si me rastin e lidhjes së martesës ashtu edhe gjatë ekzistimit dhe zgjidhjes së martesës. Kjo nënkupton faktin se gjatë procedurës së shkurorëzimit asnjëri nga bashkëshortët nuk mund të jeta i privilegjuar, por që të dy duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë nga gjykata gjatë gjithë procesit të shkurorëzimit.<sup>117</sup>

##### b) Parimi i mbrojtjes së veçantë të disa personave në procedurë

Me këtë parim nënkuptojmë se gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të procedurës së shkurorëzimit gjykata duhet të ketë parasysh mbrojtjen e interesave të fëmijëve të mitur, të personave të sëmurë dhe me zhvillim të metë psikik, të cilët nuk mund të kujdesen për interesat e veta.<sup>118</sup>

##### c) Parimi i përjashtimit të publikut

Qëllimi i këtij parimi është deklarimi i lirë i bashkëshortëve përpara gjykatës për të gjitha faktet nga sfera intime e martesës. Duke qenë e pamundshme që publiku të informohet për marrëdhëniet e tyre intime, palët do të tregojnë shkaqet e vërteta që jetesën e mëtutjeshme bashkëshortore e bëjnë të pamundshme. Për këtë arsye, gjykata do ta ketë më të lehtë për ta vërtetuar gjendjen materiale dhe për të nxjerrë një aktgjykim të drejtë.<sup>119</sup>

ç) Te kontestet familjare vihet re zgjerimi i konsiderueshem i aplikimit të *parimit të hetimit* dhe kufizimit të *parimit të dispozicionit*, që do të thotë se në procedurë në lidhje me kontestet familjare gjykata mund të vërtetojë faktet edhe atëherë kur për palët ato janë të pakontestueshme, si dhe mund të hetojë vetë faktet për të cilat palët as nuk i kanë paraqitur.<sup>120</sup> Parimi i dispozicionit nënkupton faktin se bashkëshortët gjatë procedurës në kontestet martesore mund të paraqesin të gjitha faktet dhe provat të cilat i konsiderojnë sitë rëndësishme. Kufizimi i parimit të dispozicionit në fakt është *parimi i kufizimit të disponimit me objektin e kontestit*. Për dallim nga rregullat e procedurës civile, palët në kontestet martesore nuk mund të kenë në dispozicion objektin e kontestit.<sup>121</sup>

<sup>116</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.179

<sup>117</sup> Abdulla Aliu, vep. E cit, fq.166

<sup>118</sup> M. Mladenoviç, S. Panov, vep. E cit, fq.253

<sup>119</sup> Hamdi Podgorica, vep. E cit, fq.129

<sup>120</sup> Marija Drashkiq, vep. E cit, fq.89

<sup>121</sup> Po aty

### 4.3.5.Fazat e procedurës së shkurorëzimit

Në kuadër të shkurorëzimit me padi ligji ka parashikuar procedurën e ndërmjetësimit , në mënyrë që bashkëshortët të pajtohen ose të arrijnë marrëveshje rreth çështjeve të rëndësishme.Ndërmjetësimi pra i paraprin procedurës së shkurorëzimit. Pjesë përbërëse e procedurës në kontestet martesore që janë inicuar me padi nga njëri bashkëshort është edhe procedura e ndërmjetësimit.Ndërmjetësimi është mënyrë e zgjidhjes së kontesteve, që i mundëson palëve kundërshtarë që kontestin ta zgjidhin në mënyrë paqësore.Ndërmjetësimi pra shërben që në vend të procedurës kontestimore që zakonisht zgjat gjatë , kushton shumë dhe është stresues , vlerësimi i rastit nga ana e një pale të tretë të paanshme rrit mundësin e zgjidhjes së suksesshme të kontestit.Ndërmjetësimi i ndihmon palëve që të kuptojnë më mirë natyrën e problemit të tyre si dhe të kuptojnë se ekzistojnë disa mundësi alternative që të vie deri te zgjidhja në tërësi apo pjesërisht.<sup>122</sup> Ndërmjetësimi përbëhet prej dy fazave :

- procedura për arritjen e pajtimit (pajtimi) dhe
- procedura për përpjekje që me marrëveshje ti jepet fund konstesit (ujdi).

Natyrisht te procedura e shkurorëzimit me marrëveshje nuk mund të kemi ndërmjetësim sepse aty nuk ka kontest.Sidomos procedurë të ndërmjetësimit nuk do të ketë në kontestet martesore në disa raste të cilat ligji në mënyrë taksative i ka paraparë:

- 1)kur ndonjëri nga bashkëshortët nuk pranon të bëhet ndërmjetësim
- 2)nëse njëri nga bashkëshortët është i paasftë për të gjykuar
- 3)nëse vendbanimi i njërit prej bashkëshortëve është i panjohur
- 4)dhe nëse njëri apo të dy bashkëshortët jetojnë jashtë vendit.

Suksesi i ndërmjetësimit varet nga vullneti dhe dëshira e bashkëshortëve.Ata mund të heqin dorë nga ndërmjetësimi në çdo fazë të ndërmjetësimit.<sup>123</sup> Ndërmjetësimin e bën gjykata.Megjithatë ndërmjetësimi mund të kryhet edhe jashtë gjykatës.Mund ti besohet organit të kujdestarisë , këshillimoreve për martesë dhe familje etj. Nëse ndërmjetësimin e bën gjykata atëherë këtë e bën një gjykatës i vetëm, dhe ky gjykatës nuk mund të marrë pjesë në sjelljen e vendimit në fazat e mëvonshme , në përjashtimit të rasteve kur ndërmjetësimi ka pasur sukses.Me marrjen e padisë gjykatësi cakton seancë për ndërmjetësim.Padia në këtë fazë akoma nuk i është dorëzuar palës tjetër për përgjigje.

Nëse në këtë seancë nuk vijnë bashkëshortët ndërmjetësimi nuk do të ndodhë dhe në këtë rast konstesti martesor do të zgjidhet në procedurë kontestimore. Nëse në seancën e caktuar për ndërmjetësim vijnë të dy bashkëshortët ndërmjetësimi mund të bëhet.Gjykatësi që e udhëheq seancën ndërmjetësimin është i obliguar të iu rekomandojë bashkëshortëve t’iu nënshtrohen këshillimit psikosocial.Vetëm nëse bashkëshortët pranojnë atë, tërë procedurën e ndërmjetësimit gjykatësi ia beson organit të kujdestarisë , këshillimoreve për martesë dhe familje,përkatësisht institucionit që është i specializuar për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare.Delegimi në këtë rast bëhet në atë mënyrë që gjykata ia dërgon padin për shkurorëzim të martesës.<sup>124</sup>Procedura e ndërmjetësimit përbëhet prej dy fazave.Faza e parë e ndërmjetësimit pa marrë parasysh se kush e udhëheq atë , emërtohet si procedura për tentimin e pajtimit të bashkëshortëve ( pajtimi ) .Faza e dytë emërtohet procedura e tentimit për ti dhënë fund kontestit (ujdia-nagodba).

Përpjekjet për pajtim apo séance për pajtim - bëhet në kontestet martesore që janë inicuar me padi për shkurorëzim të martesës pa marrë parasysh se a kanë a po jo bashkëshortët

<sup>122</sup> Marija Drashkiq, vep. E cit, fq.148

<sup>123</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.185

<sup>124</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.186

fëmijë të përbashkët të mitur. Pajtimi zhvillohet në gjykatë apo ndonjë tjetër institucion , në fillim të kontestit për shkurorëzim të martesës kur bashkëshortët akoma nuk kanë marrë një qëndrim të fortë në pikëpamje të dëshirës për shkurorëzim. Përmes bisedës joformale me bashkëshortët dhe prezantimit të pasojave , në këtë fazë tentohet të arrihet qëllimi i pajtimit: duke zgjidhur marrëdhëniet e tyre të çrregulluara pa konflikt dhe pa shkurorëzim. Përpjekja e ndërmjetësuesit duhet të jetë i përqëndruar tek çiftet ndërmjet të cilëve sipas vlerësimit të tij , marrëdhëniet martesore akoma nuk janë të çrregulluara thellë dhe për një kohë të gjatë , pasi në të kundërtën do të ishte e kotë dhe humbje kohe. Nëse ndërmjetësimi zhvillohet para gjykatës gjithmonë caktohet një seancë e veçantë për pajtim në të cilën thirren të dy bashkëshortët. Ata nuk mund ti përfaqësojë i njëjti përfaqësues dhe as ata nuk mund të marrin pjesë në pajtim.<sup>125</sup>

Nëse bashkëshortët pajtohen, konsiderohet se padia për shkurorëzim të martesës është tërhequr. Në të kundërtën nëse nuk vie deri te pajtimi ose nëse njëri apo të dy nga bashkëshortët nuk i përgjigjen ftesës për pajtim konsiderohet se pajtimi ka dështuar dhe vazhdohet me procesin e marrëveshjes (negodba). Nëse shifet se ka gjasa për pajtim , faza e tentimit për pajtim mund të vazhdohet. Për pajtimin përpilohet procesverbal i cili duhet të përmbajë deklaratat e bashkëshortëve në lidhje me atë se janë pajtuar , ose se pajtimi ka dështuar. Nëse pajtimi është zhvilluar në ndonjë institucion që i është besuar procedura e ndërmjetësimit ai institucion është i obliguar që ta informojë gjykatën me rezultatet e tentimit për pajtim dhe t'ia dorëzojë procesverbalin mbi tentim pajtimin. Procedura e tentim pajtimit nuk mund të zgjas më tepër se dy muaj nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë, respektivisht në institucionin të cilit i është besuar procedura e ndërmjetësimit , ndërsa me kalimin e afatit prej tre muajve gjykata do ta merr procedurën e pajtimit nëse institucioni përkatës nuk e informon gjykatën për rezultatet e tentim pajtimit.<sup>126</sup>

Faza për arritjen e zgjidhjes apo faza për arritje të marrëveshjes (faza e ujdís) është pjesë e procedurës së ndërmjetësimit e cila zhvillohet në kontestin martesor që është inicuar me padi për shkurorëzim të martesës , në të cilën tentimi për pajtim ka dështuar. Qëllimi i kësaj faze është që me ndihmën e ndërmjetësuesit , pa konflikt dhe me marrëveshje ti zgjidh dy çështjet më të diskutueshme që i rëndojnë marrëdhëniet bashkëshortore kur është e qartë se martesa e tyre nuk mund të mbijetojë. Gjykata respektivisht institucioni që i është besuar procedura e ndërmjetësimit do të përpiqet që në procedurën e zgjidhjes bashkëshortët të arrijnë marrëveshje mbi kryerjen e të drejtave prindërore dhe marrëveshje lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët. Për dallim nga tentim pajtimi te seanca për tentim të marrëveshjes thirren jo vetëm bashkëshortët por edhe përfaqësuesit e tyre të cilët duhen të kontribojnë që të arrihet marrëveshja sa më shpejtë dhe sa më thjeshtë.<sup>127</sup>

Përpjekjet për marrëveshje konsiderohen të suksesshme nëse bashkëshortët arrijnë marrëveshje për kryerjen e të drejtave prindërore dhe marrëveshje për ndarjen e pasurisë së përbashkët , ndërsa do të konsiderohet pjesërisht e suksesshme nëse arrihet vetëm njëra nga këto dy marrëveshje. Në secilin rast marrëveshja mbi ndarjen e pasurisë do të futet në aktgjykimin për shkurorëzimin e martesës, që nuk është rast me marrëveshjen për kryerjen e të drejtave prindërore pasi ajo futet në aktgjykim vetëm nëse gjykata vlerëson se ajo marrëveshje është në interes të fëmijës. Në të kundërtën marrëveshja konsiderohet e pasuksesshme nëse njëri ose të dy bashkëshortët edhe pse të thirrur nuk i përgjigjen ftesës për marrëveshje ose nëse nuk arrijnë asnjërin nga marrëveshjet e caktuara , por nëse gjykata përkatësisht institucioni që i është besuar

<sup>125</sup>Zoran Ponjavić, vep. E cit, fq.186

<sup>126</sup>Marija Drashkić, vep. E cit, fq.93

<sup>127</sup>Po aty

procedura e ndërmjetësimit mund të vazhdojë procedurën nëse vlerëson se ka gjasa që marrëveshja të arrihet. Sa i përket procesverbalit dhe kohëzgjatjes për tentim të marrëveshjes vlejné të njejtat rregulla si edhe për procedurën e tentimit të pajtimit (procerverbali duhet të përmbajë marrëveshjen e bashkëshortëve mbi kryerjen e të drejtave prindërore dhe ose marrëveshjen mbi ndarjen e pasurisë, përkatësisht deklaratat e bashkëshortëve që marrëveshja nuk është arritur pra ka dështuar ; kohëzgjatja e tentimit për arritjen e marrëveshjes nuk mund të jetë më shumë se dy muaj nga dita kur ka përfunduar procedura e pajtimit, përkatësisht nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë apo institucion përkatës, dhe pas përfundimit të afatit prej tre muaj procedurën për marrëveshje e zhvillon gjykata.<sup>128</sup>

#### 4.3.6. Sjellja e vendimit

Marrja e vendimit është fazë e fundit në procedurën e shkurorëzimit. Gjykata vendos me aktgjykim, pavarësisht se procedura është inicuar me padi apo me propozim të përbashkët. Gjykata me aktgjykim mund të refuzoj padinë dhe propozimin për shkurorëzim ose të lejoj shkurorëzimin. Nëse gjykata e lejon shkurorëzimin në aktgjykim konstaton faktet në bazë të cilave shqiptohet shkurorëzimi. Aktgjykimi përmban hyrjen dispozitivin , arsyetimin dhe udhëzimin për mjete juridike. Në hyrje të aktgjykimit shënohet përbërja e gjykatës , emri i palëve, objekti i kontestit dhe data e nxerrjes së aktgjykimit. Në dispozitiv të aktgjykimit shënohet vendimi i gjykatës mbi refuzimin ose lejimin e shkurorëzimit.

Kur gjykata e lejon shkurorëzimin në dispozitiv vendoset edhe për kryerjen e të drejtave prindërore dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Poashtu gjykata mund të vendos edhe për çështje tjera si psh mund të përcaktojë një apo më shumë masa mbrotjeje nga dhuna në familje. Në arsyetim gjykata e arsyeton marrjen e aktgjykimit duke i potencuar të gjitha faktet mbi të cilat e bazon vendimin e saj. Ndërsa aktgjykimi e përmban edhe udhëzimin për mjetet juridike . Me nxerrjen e vendimit përfundon procedura në gjykatën e shkallës së parë. Kështuqë procedura e mëtejme lidhur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë mund të vazhdoj vetëm sipas mjeteve juridike. Ndryshe nëse palët nuk e goditin vendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda afatit të paraparë me ligj , vendimi bëhet i plotëfuqishëm.<sup>129</sup>

#### 4.3.7. Mjetet juridike

Kundër aktgjykimit të shqiptuar në procedurat nga marrëdhëniet martesore pala e pakënaqur ka të drejten e mjetit të rregullt juridik (ankesës) dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike. Ankesa – pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga sjellja e aktgjykimit. Ankesa mund të paraqitet për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Ndërsa kur procedura ka filluar me propozimin e përbashkët të bashkëshortëve ankesa është e kufizuar. Aktgjykimi me të cilin zgjidhet martesa sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore ose për arsye se propozimi është dhënë në lajthim ose nën ndikimin e dhunës , kanosjes, ose mashtrimit. Pasi të ketë vendosur gjykata e shkallës së dytë lidhur me ankesën,

<sup>128</sup> Marija Drashkiq, vep. E cit, fq.94

<sup>129</sup> Abdulla Aliu, vep. E cit, fq.175

aktgjykimii e merr formën e prerë.Poashtu aktgjykimi e merr formën e prerë edhe atëherë kur vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është goditur me ankesë brenda afatit të paraparë me ligj.<sup>130</sup>Meqenëse edhe procedura e shkurorëzimit është procedurë civile si mjete të jashtëzakonshme do të duhej të konsideroheshin : revizioni , kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe propozimi për përsëritjen e procedurës.Por sipas nenit 227.alinea 2 i Ligjit të Familjes nëse martesë është zgjidhur me aktgjykimin e formës së prerë vendimi për shkurorëzim nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme juridike.Me këtë rast vendimi me të cilin gjykata e ka lejuar ose refuzuar shkurorëzimin nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme vetëm në pjesën që i përket lejimit ose refuzimit.Ndërsa në pjesët tjera të aktgjykimit siç janë : vendosja lidhur me kujdestarinë e fëmijëve , te drejtat prindërore ,mbajtjen e bashkëshortit etj mund të goditen me mjete të jashtëzakonshme.Në të gjitha rastet në mungesë të dispozitave të veçanta për procedurën e shkurorëzimit në mënyrë subsidiare zbatohen dispozitat e procedurës kontestimore.<sup>131</sup>

#### **4.4.Pasojat e shkurorëzimit**

Shkurorëzimi si dukuri krijon konsekuenca të natyrave të ndryshme dhe mjaft komplekse.Shumë autorë përmendin si efekte të shkurorëzimit : pasoja emocionale, pasoja ligjore, pasoja ekonomike, pasoja rreth bashkëpunimit me rastin e shkurorëzimit, pasoja sociale dhe pasoja psikike.Të gjitha këto pasoja kanë të bëjnë me ish bashkëshortët dhe fëmijët.Me lidhjen e martesës krijohet familja e cila përbëhet nga bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të përbashkët ose edhe persona të tjerë.Gjithashtu në martesë deri sa zgjatë ajo krijohet pasuri e përbashkët e bashkëshortëve.Pastaj bashkëshortët me rastin e lidhjes së martesës e kanë ndryshuar statusin e tyre.Andaj zgjidhja e martesës kërkon adresimin dhe zgjidhjen e të gjitha këtyre çështjeve.Vendimi gjyqësor pasi të merr formën e prerë i jep fund martesës dhe prodhon efekte juridike të karakterit personal dhe pasuror të lidhura me bashkëshortin dhe fëmijët.<sup>132</sup>Andaj efektet juridike të shkurorëzimit zakonisht ndahen në: efekte juridike ndaj ish bashkëshortëve dhe efekte juridike ndaj fëmijëve.

##### **4.4.1.Pasojat ndaj ish bashkëshortëve**

Me rastin e zgjidhjes së martesës rrjedhin disa pasoja juridike ndaj ish bashkëshortit të cilat mund ti ndajmë në dy grupe : pasoja të natyrës personale dhe pasoja të natyrës pasurore.

###### **4.4.1.1.Efektet e karakterit personal**

Kur pushon martesë pushon bashkëjetesa dhe si pasojë pushojnë edhe të drejtat dhe detyrimet që i bartë ajo.Me pushimin e martesës ndryshohet edhe *gjendja statusore* e bashkëshortëve nga të martuar kalojnë (në statusin e personit të shkurorëzuar) në beqar.Me rastin e zgjidhjes së martesës pushon martesë si pengesë martesore.Efekti më i rëndësishëm i shkurorëzimit është e drejta e ish bashkëshortëve që të mund përsëri të lidhin martesë të re, e drejta serbe nuk njeh kurrfarë kufizimi apo pengese.

<sup>130</sup> Abdulla Aliu, vep. E cit, fq.175

<sup>131</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.191

<sup>132</sup> Abdulla Aliu, vep. E cit, fq.177



Efekt tjetër është edhe *ndryshimi i mbiemrit*. Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve e ka ndërruar mbiemrin gjatë lidhjes së martesës, me kryerjen e shkurorëzimit, ai bashkëshort mund ta mbajë atë mbiemër ose mund ta ndërrojë atë dhe ta merr mbiemrin e vjetër të mëhershëm. Deklarata për ndryshimin e mbiemrit i paraqitet zyrës së regjistrimit të gjendjes civile (ofiçarisë) në afat prej dy muajsh nga zgjidhja e martesës.<sup>133</sup>

#### 4.4.1.2. Efektet e karakterit pasuror

Pos efekteve të karakterit personal me shkurorëzim krijohen edhe efektet me karakter pasuror. Këto janë:

1. pjesëtimin e pasurisë së përbashkët,
2. kthimi i dhuratave,
3. mbajtja (ushqimia) e bashkëshortit të pasiguruar,
4. e drejta e banimit
5. trashëgimia ligjorë dhe testamentale.

*Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët* - Me shkurorëzimin e martesës vie edhe detyrimisht ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve të cilët ata e kanë fituar gjatë martesës. Pasuria e përbashkët mund të ndahet me marrëveshje të bashkëshortëve dhe me rrugë gjyqësore.

a) *Ndarja e pasurisë me marrëveshje të bashkëshortëve* – kjo mënyrë e të ndarit të pasurisë së përbashkët është mënyra më e mirë për ndarjen e pasurisë pasi që ata kanë kontribuar bashkarisht dhe më së miri e din si do të duhej të ndahej. Kjo marrëveshje duhet të jetë me shkrim. Ndarja e pasurisë së përbashkët me marrëveshje të bashkëshortëve është e obligueshme në rast të shkurorëzimit me marrëveshje të bashkëshortëve dhe është pjesë përbërëse e marrëveshjes për shkurorëzim. Ata mund të dakordohen që tërë pasurinë e përbashkët ta shesin dhe të hollat ti ndajnë. Apo që pasuria e përbashkët ti takoj vetëm njërit bashkëshort dhe tjetri të marrë kompensimin në të holla. Gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët me marrëveshje bashkëshortët nuk janë të detyruar t'iu përmbahen rregullave të cilat iu përmbahet gjykata gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët. Ata mund të dakordohen që njërit prej tyre ti takoj pjesë më e madhe duke pasur arsye të fortë. Motiv për këtë mund të jetë fakti që fëmijët iu kanë besuar pikërisht atij bashkëshort i cili ka marrë pjesën më të madhe.<sup>134</sup>

b) *Ndarja e pasurisë së përbashkët nga ana e gjykatës* – Në rast të bashkëshortët nuk mund të bien dakord në lidhje me ndarjen e pasurisë së përbashkët, atëherë ndarjen e pasurisë së përbashkët e bënë gjykata. Në bazë të Ligjit për Familje pasuria e përbashkët e bashkëshortëve ndahet në pjesë të barabarta. Kjo del nga parimi i barabarësisë së bashkëshortëve në martesë dhe faktit që kontributi i tyre në arritjen e pasurisë së përbashkët në parim është i njëjtë. Edhe arsyet praktike e arsyetojnë këtë mënyrë të ndarjes së pasurisë së përbashkët pasi është shumë e vështirë të dihet sakti kontributi i secilit bashkëshort dhe me këtë mënyrë pasuria mund të ndahen relativisht shpejt dhe në mënyrë efikase. Ky sistem i ndarjes së pasurisë së përbashkët në pjesë të barabarta është supozim ligjor. Cdo njëri nga bashkëshortët i cili nuk është i kënaqur me ndarjen e pasurisë në pjesë ta barabarta mund të kërkojë të vërtetohet pjesa e tij më e madhe. Detyra e të provuarit të pjesës së tij më të madhe i takon atij bashkëshort i cili kërkon pjesë më të madhe nga pasuria e përbashkët. Vetëm në këtë rast vërtetohet kontributi i bashkëshortit në arritjen e pasurisë së përbashkët. Pjesa më e madhe në arritjen e pasurisë vërtetohet për të gjitha të drejtat dhe detyrimet pra për pasurinë e përbashkët në tërësi në

<sup>133</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.195

<sup>134</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.406

momentin e përfundimit të martesës. Por mund që të kërkohet pjesë më e madhe vetëm të një të drejte të vetme nga pasuria e përbashkët. Kjo do të thotë që do të vërtetohet kontributi i bashkëshortit në arritjen e vetëm asaj të drejte, dhe jo në të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga pasuria e përbashkët. Për t'u bërë kjo e mundur është e nevojshme që të plotësohen dy kushte kumulative: që ajo e drejtë të jetë ekonomisht e pavarur në marrëdhënie me të drejtat tjera nga pasuria e përbashkët dhe që në fitimin e asaj të drejte bashkëshorti të ketë kontribuar me të ardhurat nga pasuria e tij e veçantë.<sup>135</sup>

Që të mund gjykata ta realizoj ndarjen e pasurisë së përbashkët, së pari duhet që të përcaktojë përbërjen e saj. Nëse bashkëshortët nuk janë të pajtimit në lidhje me atë se çka bie në pasurinë e përbashkët, është e nevojshme që këtë ta bëjë gjykata. Gjykata së pari nga masa pasurore ndan të drejtat sendore dhe obligatore si dhe obligimeve të pasurisë së tyre të veqanta. Gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët duhet të bëhet llogaritja e aktivës dhe pasivës së saj si dhe llogaritja në mes pasurisë së përbashkët dhe asaj të veçantë. Pasi pasuria e përbashkët mund të keta kërkesa dhe borxhe ndaj personave të tretë dhe ndaj bashkëshortëve. Pas gjithë kësaj bëhet llogaritja e vlerës së pasurisë së përbashkët. Vlera relevante e pasurisë bëhet sipas çmimeve në kohën e sjelljes së vendimit gjyqësor, ndërsa sipas gjendjes së saj në momentin e përfundimit të bashkësisë martesore. Pas gjitha këtyre gjykata sjell vendim për ndarjen e pasurisë në pjesë të barabarta, ose në bazë të kontributit nëse është bërë kërkesë e tillë. Nga ai moment pushon së egzistuari pasuria e përbashkët ndërmjet bashkëshortëve dhe ata bëhen bashkëpronarë përkatësisht bashkëpronarë të pjesës së caktuar të pasurisë së përbashkët. Sipas parimit ato pjesë janë ose të barabarta 50% - 50% ose jo të barabarta si p.sh 70% - 30% nëse kanë kërkuar ndarjen e pjesëve në bazë të kontributit. Pas sjelljes së vendimit mbi vërtetimin e pjesëve bashkëshortët mundën vetë me bënë ndarjen fizike të sendeve dhe të të drejtave. Nëse rreth kësaj nuk mund të miren vesh, ndarjen fizike e bënë gjykata.<sup>136</sup>

*Kthimi i dhuratave* - Ligji për Familjen e rregullon edhe çështjen e dhuratave pas shkurorëzimit të martesës. Bëhet fjalë për dhuratat të cilat bashkëshortët ia kanë bërë njëri tjetrit gjatë kohës së martesës. Dhuratat janë dhënë si shenjë e të shprehurit të dashurisë (animus donadi). Përfundimi i martesës me shkurorëzim bie edhe motivi i të dhuruarit dhe për këtë arsye shtrohet edhe pyetja për fatin e tyre. Ligji për Familjen e bënë dallimin midis dhuratave të zakonshme dhe dhuratave me vlerë të madhe. Dhuratat e përditshme të zakonshme të cilat i japin bashkëshortët me raste të ndryshme nuk kthehen. Kthehen ato dhurata vlera e të cilave është jashtëzakonisht e madhe në krahasim me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, të cilat dhurata ia kanë dhuruar bashkëshortët njëri tjetrit gjatë bashkësisë martesore. Të drejtën e kthimit të dhuratave nuk e ka bashkëshorti nëse pranimi i kërkesës së tij për kthim të dhuratave do të paraqiste padrejtësi të madhe për bashkëshortin tjetër. Sipas kësaj padrejtësi do të ishte nëse kthimin e kërkon bashkëshorti i cili në martesë është sjellur ashpër duke thyer të drejtat dhe detyrimet bashkëshortore. Dhuratat kthehen në gjendjen që janë në momentin e përfundimit të bashkësisë martesore. Nëse dhurata marrësi e ka tjetërsuar dhuratën atëherë ai e kthen të njëjtën vlerë në të holla në momentin e tjetërsimit.<sup>137</sup>

*Mbajtja (ushqimia) e bashkëshortit të pasiguaruar* - Ky detyrim rrjedh nga ligji për Familjen dhe është e lidhur ekskluzivisht vetëm me pamundësinë e bashkëshortit që vet ti zgjidh nevojat e veta pas shkurorëzimit. Ligji poashtu parashikon kushtet për mbajtjen e bashkëshortit pas shkurorëzimit. Kushtet për të mbajturin mund të jenë të përgjithshme dhe të veqanta.

<sup>135</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.408

<sup>136</sup> Po aty

<sup>137</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.419

Kushtet e përgjithshme – Këto kushte për të mbajturin janë:

- 1) që nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje dhe
- 2) që të jetë i paaftë për punë ose i papunsuar.

Kushti i veçantë - Pa marrë parasysh nëse i mbajturi i plotëson kushtet e përgjithshme mundet që të dëshmohet se do të ishte e drejtë ta fitonte atë, duke marrë parasysh sjelljen e tij gjatë martesës apo rrethana tjera. Sipas të drejtës positive serbe ky kusht është i formuluar në atë mënyrë që nuk ka të drejtë për mbajtje bashkëshorti nëse pranimi i kërkesës së tij për mbajtje do të paraqiste padrejtësi të madhe për bashkëshortin tjetër. Rrethanat që do të paraqisni padrejtësi të madhe në praktikë janë më së shpeshti të natyrës subjektive dhe janë të lidhura me sjelljen e bashkëshortit i cili ka shkelur në ndonjë obligim martesor. Refuzimi do të ishte i asryetur si mënyrë e ndëshkimit të asaj sjelljeje. Si p.sh: kur mbajtjen e kërkon bashkëshorti i cili ka bërë vepër penale ndaj të afërmit të bashkëshortit, bashkëshorti i cili ka sjell vet veten në pozitë të paaftë duke e tjetërsuar pronën e tij, nëse qëllimisht e ka braktisur bashkësinë martesore pa arsye etj. Këto rrethana mund të jena edhe të natyrës objektive ku nuk ka asnjë sjellje të fshehtë të bashkëshortit si p.sh: kohëzgjatja e shkurtë e martesës do të ishte rrethanë që dhënia e mbajtjes do të ishte e padrejtë. Për këtë kusht pra nëse do të ishte padrejtësi e madhe dhënia e mbajtjes gjykata nuk vepron sipas detyrës zyrtare pra ajo vërtetohet vetëm me kërkesë të bashkëshortit nga i cili kërkohet mbajtja. Kjo bëhet pra me kërkesë në kuadër të shkurorëzimit parimisht por mund të bëhet edhe më pas pas shkurorëzimit në seancë procedurë të veçantë.<sup>138</sup>

Kushtet për mbajtësin – Sa i përket mbajtësit i vetmi kusht është mundësia e tij të jep mbajtjen. Mbajtjen e jep në bazë të mundësive të tij.

*E drejta e banimit* - Bashkëshortët mund ta shfrytëzojnë banesën në bazë të së drejtës së qiramarrjes dhe në bazë të pronësisë. Nëse apartamenti i përbashkët shfrytëzohet në bazë të qiramarrjes, me përfundimin e martesës nëse bashkëshortët nuk mund të mirren vesh atëherë gjykata do të vendos në procedurë jashtëkontestimore se kush do të vazhdoj ta shfrytëzojë banesën. Gjykata e merr vendimin duke u bazuar në nevojat dhe mirëqenien e fëmijëve, gjenden pasurore të bashkëshortëve etj. Ndërsa nëse banesa apo shtëpia është blerë atëherë çështja rregullohet në mënyrë tjetër. Nga momenti i blerjes banesa apo shtëpia është bërë pjesë përbërëse e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe kur bëhet ndarja e saj pra ndarja apo pjesëtimi i pasurisë së përbashkët zgjidhet edhe çështja e banesës apo shtëpisë.<sup>139</sup>

*E drejta e trashëgimisë ligjore dhe testamentare* - Është rregull që me përfundimin e martesës me anë të shkurorëzimit ndërpritet apo pushon edhe e drejta e trashëgimisë ligjore ndërmjet bashkëshortëve. Ligji i trashëgimisë nuk përmban ndonjë dispozitë të qartë me të cilin do të rregullohej trashëgimia testamentare në rast të shkurorëzimit të martesës. Këtu duhet të dallojmë dy situata: nëse testamenti është hartuar gjatë kohës së martesës e cila më vonë ka përfunduar me shkurorëzim apo testamenti është hartuar pas shkurorëzimit. Në rastin e parë, ish bashkëshorti pas jetues e humb të drejtën e trashëgimisë nëse martesë është shkurorëzuar, pasi që me shkurorëzimin e martesës bie edhe motivi i trashëgimisë. Pasiqë në të drejtën pozitive serbe nuk ka dispozitë të qartë lidhur me këtë, duhet të nisemi nga rregulla e interpretimit të trashëgimisë e paraparë me nenin 135 të Ligjit të Trashëgimisë siç edhe sugjerohet në teorinë tonë juridike. Në rastin tjetër nëse testamenti është hartuar pas shkurorëzimit të martesës, ai është i vlefshëm.<sup>140</sup>

<sup>138</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.371

<sup>139</sup> Zoran Ponjaviç, vep. E cit, fq.196

<sup>140</sup> Po aty

#### 4.4.2.Pasojat ndaj fëmijëve

Njëra ndër çështjet më të rënda dhe më të rëndësishme në të njejtën kohë është dhe çështja e pasojave të shkurorëzimit apo efekteve juridike të shkurorëzimit ndaj fëmijëve. Pas zgjidhjes së martesës , fëmijët e përbashkët humbin mundësinë që të realizojnë të drejtën e jetesës së përbashkët me të dy prindërit. Pa mëdyshje , kjo është pasoja më e madhe që shkaktohet me rastin e shkurorëzimit<sup>141</sup>. Sipas detyrës zyrtare (ex officio), gjykata ka për detyrë që në dispozitiv të aktgjykimit për shkurorëzimin e martesës të vendosë edhe cilit prind i besohet fëmija për ruajtje dhe mbajtje. Po në dispozitiv të aktgjykimit gjykata duhet të vendosë edhe për kontaktet personale të fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar ruajtja dhe mbajtja e tij. Duhet të theksojmë se për ruajtjen dhe mbajtjen e fëmijëve prindërit mund të merren vesh vetë njëri me tjetrin. Kjo marrëveshje duhet të vlerësohet patjetër nga gjykata , se ajo marrëveshje mës bashkëshortëve respektivisht prindërve a është apo nuk është në interes të fëmijëve. Gjukata do të gjejë nesë marrëveshja është apo s'është në interes të fëmijëve. Kur gjykata gjen se ajo është në interes të fëmijëve, ajo mund ta miratojë atë ne tërësi , ta ndryshojë apo ta harmonizojë me interesat e fëmijëve, në pjesë që gjen se nuk janë të mbrojtura mjaft interes e fëmijëve , apo edhe ta refuzojë në tërësi atë.<sup>142</sup>

Aktgjykimi i gjykatës gjithashtu duhet të përmbajë njërin prej këtyre tre vendimeve :

1. të gjithë fëmijët mund t'i besohen në ruajtje dhe mbajtje njërit prind,
2. që fëmijët të ndahen , ashtu që një apo më shumë prej tyre ti besohen nënës dhe një apo më shumë ti besohen babait, dhe
3. që ti besohen një personi të tretë apo ndonjë institucioni tjetër.

Me rastin e vendosjes për besimin e fëmijëve në ruajtje dhe mbajtje, gjykata në mënyrë ekskluzive do të keta kujdes për interesin e fëmijëve , pa marrë parasysh fajësinë apo pafajësinë me rastin e shkurorëzimit. Në kuadër të kësaj ajo do të marrë parasysh moshën dhe dëshirën e fëmijëve, gjendjen shëndetësore të fëmijëve dhe prindërve , kushtet e jetesës dhe kushtet material të secilit prind , veçanërisht aftësinë e tyre për ruajtje, edukim , mirërritje, shkollim dhe për mbajtje. Bashkëshortit të cilit i besohen fëmijët e përbashkët për ruajtje dhe mbajtje , përveq pjesës së tij , i jepen edhe sendet që u shërbejnë vetëm fëmijëve ose që janë të destinuara vetëm për përdorimin e tyre të drejtëpërdrejtë, përveç nëse vlera e tyre është jo proporcionalisht e madhe në krahasim me vlerën e pasurisë së përgjithshme të përbashkët. Poahut , prindit të cilit nuk i janë besuar në ruajtje dhe mbajtje fëmijët ka të drejtë të mbajë kontakte personale me fëmijët e vet. Cëshjta e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijët mes ish-bashkëshortëve mund të rregullohet me marrëveshje, mirëpo gjykata ka detyrë që me aktgjykim për zgjidhjen e martesës të vendos edhe për çështje të mbajtjes së kontakteve personale të fëmijëve me prindin që nuk i është besuar. Sepse e drejta e mbajtjes së fëmijëve , edhe pas zgjidhjes së martesës nuk pushon.<sup>143</sup> Janë të shumta problemet psikologjike që vuajnë fëmijët. Le të përmendim disa:

1- Divorci ndikon në formimin normal të fëmijës, sepse fëmija ka nevojë për dy modele, të babait dhe të nënës, për autoritetin e babait dhe për dhembshurinë e nënës. Një fëmijë me prindër të divorcuar, djalë apo vajzë, do të ketë konfuzion në formimin e personalitet të tij, sepse, siç thamë, mungon modeli i prindit që ai duhet të imitojë.

2- Te fëmijët krijohet një stres i vazhdueshëm në kërkim të shkakut se pse prindërit e tyre u ndanë. Fëmija, duke qenë i paafte për të gjykuar sjelljet e të rriturve, mund të krijojë një

<sup>141</sup> Zoran Ponjavić, vep. E cit, fq.197

<sup>142</sup> Hamdi Podvorica, vep. E cit, fq.139

<sup>143</sup> Po aty

gjykim të gabuar për prindërit, deri në urrejtje . Ose, fëmija ndihet fajtor dhe shkaktar i këtij divorci dhe i paaftë për t'i bashkuar prindërit dhe kjo e torturon çdo ditë zemrën e tij.

3- Fëmijët me prindër të divorcuar ndihen të ndryshëm nga fëmijët e tjerë me familje të rregullt. Kjo gjë u krijon stres, i mbyll në vetvete, i bën të mos jenë të çiltër në të shprehur, gjë që krijon çrregullim psikologjik dhe marrëdhënie jokorrekte me të tjerët.

4- Divorci krijon probleme ekonomike dhe fëmijët me prindër të divorcuar detyrohen të rriten në kushte të vështira, jo me arsimimin e duhur, ose detyrohen të punojnë që në moshë të mitur për të plotësuar mungesat ekonomike që vijnë për shkak të divorcit të prindërve.

5- Fëmijët rriten pa dashurinë natyrale të të dy prindërve së bashku dhe kjo do të ndikojë në jetën e tyre private, sidomos kur ata do të krijojnë familjen e tyre, duke rrezikuar të bëjnë të njëjtën gjë në jetë si prindërit e tyre. Kështu shembulli i keq divorcit rrezikon të përsëritet e të përhapet nga brezi në brez.<sup>144</sup>

Psikologja, Donika Tahirsylaj- Alidemi ka thënë se kur prindërit divorcohen, fëmijët zakonisht bëhen më indiferent sepse nuk duan që rrethi shoqëror ta kuptojnë që prindërit e tyre janë ndarë. "Fëmijët me prindër të divorcuar paraqesin në përgjithësi një rënie lidhur me vetëvlerësimin, kompetencën sociale, shfaqje të problemeve emocionale dhe të sjelljes. Djemtë dhe në përgjithësi fëmijët me temperament të vështirë janë të prirur të braktisin shkollën dhe të demostrojnë sjellje antisociale gjatë adoleshencës. Analiza cilësore tregon për qëndrimin dhe sjelljen e fëmijëve ndaj divorcit të prindërve. Rezulton se fëmijët kanë një ndjenjë frike dhe pasigurie nga mungesa e njërit prind. Ata nuk janë gati të pranojnë situatën në të cilën ndodhen. Fëmijët kanë një shmangie ndaj shkollës, bashkëmoshatarëve, mësueses në mënyrë që të mos mësohet divorci i prindërve", ka thënë ajo.<sup>145</sup>

Fëmijët e prindërve të divorcuar kanë rreth 1.5 herë më shumë mundësi që të jenë në mbipeshë. Hulumtuesit norvegjez kanë treguar se fëmijët që kanë prindërit e ndarë kanë shumë mundësi që të jenë në mbipeshë se sa fëmijët e prindërve të martuar. Kërkuesit, të cilët paraqiten rezultatet e tyre në Kongresin Evropian për Shëndoshje në Sofje, maten perimetrimin e lartësisë, peshën dhe belin e 3166 fëmijëve të shkollave norvegjeze. Ata krahasuan këto të dhëna kundër statusit martesor të prindërve të tyre dhe arritën në përfundimin se obeziteti është më i zakonshëm në mesin e fëmijëve prindërit e të cilëve ishin të divorcuar. Përderisa ata nuk sqaruan se përse është ky trend, hulumtimet e mëparshme nga Universiteti Rice nga Teksasi, sugjeruan se kjo mund të ndodh për shkak se fëmijët që jetojnë me të dy prindërit kanë mundësi t'i kenë më shumë burime të disponueshme për ta. Ndërsa fëmijët me prindër të ndarë mund të shpenzojnë më shumë kohë vetëm në shtëpi, duke u dhënë atyre qasjen në ushqime dhe ndoshta më pak shans për të ushtruar.<sup>146</sup>

---

<sup>144</sup> <http://www.balkanweb.com>

<sup>145</sup> <http://www.kosovapress.com/>

<sup>146</sup> Po aty

#### 4.5. Të dhëna mbi shkurorezimin në Serbi nga Enti Statistikor Republikan

Pikëpamjet (kuptimi) mbi martesën dhe familjen sidomos dy dekadat e fundit kanë pësuar ndryshime drastike andaj edhe në të gjithë botën është rritur numri i shkurorezimeve dhe zvogëluar numri i martesave. Kjo pasi martesat dhe familja në kuptimin tradicional fillon të zhduket, martesat si institucion ka filluar të humb rëndësinë dhe rolin e saj që ka pasur dikur. Martesat nuk shifet më nga gjeneratat e reja si gjë e shenjtë.

Të dhënat e publikuara nga EUROSTAT tregojnë qartë një grup trendesh që dalin në pah që nga 1970-tat : numri i martesave nëpër të gjithë Evropën po bie ndërsa numri i shkurorezimeve po rritet. Eurostat raporton se ka pasur një zvogëlim prej 34 % të numrit të martesave të lidhura në 27 shtetet anëtare ndërmjet 1970 – 2009 , dhe dyfishimi i numrit të shkurorezimeve për periudhën në fjalë kjo si pasojë e liberalizimit të ligjeve të shkurorezimit në mbarë Evropën.<sup>147</sup> Tendencat e rritjes së numrit të shkurorezimeve dhe zvogëlimit të martesave është prezent edhe në Republikën e Serbisë që një kohë të gjatë. Duket se martesat sot më shumë se kurrë është në krizë të thellë , megjithëse prap nëse e krahasojmë me vendet perëndimore është jo aq keq. Arsyet janë të shumta dhe nga më të lloj llojshmet. Zhvillimi i hovshëm shoqëror, ndryshimi i sistemit të vlerarave , papunësia, varfëria janë vetëm disa nga arsyet që vështirësojnë funksionimin e bashkësisë martesore dhe familjare.

Partnerët si arsye më të shpeshta japin pikëpamjet e ndryshme mbi martesën dhe rolet e tyre në martesë , mungesa apo humbja e ndjenjave ndaj partnerit , tradhëtia bashkëshortore, problemet financiare. Poashtu vihet re edhe shtimi i rasteve të dhunës në familje. Edhe pse çdo çift i ndarë është i veçantë janë disa arsye të përbashkëta dhe që përsëriten. Një ndër më të shpeshtit është edhe papjekuria e partnerit apo të dyve që e shoqëruar edhe me arsye tjera sjellin ndarjen e çiftit. Papjekuria çon edhe deri te tradhëtia, nuk i lejon partnerëve të zgjedhin problemet e tyre , dhe për shkak të saj nuk dinë si të komunikojnë dhe të zbulojnë qfarë në të vërtetë i mundon. Komunikimi i mirë dhe respekti reciprok janë kryesorët për një martesë të suksesshme , ndërsa mungesa e tyre shkakton shkurorezimin . Si shkaqe të shkurorezimit mund të përmendim edhe arsimimin sa më i lartë të jetë ai shtohen gjasat më shumë për shkurorezim pasi edukim më i lartë do të thotë edhe pozitë më e mirë sociale dhe mundësi më shumë për të zgjedhur. Ndërsa ata me shkollim të ulët nuk janë në pozitë të mirë sociale dhe personat e tillë pa perspektivë solide për sjelljen e vendimeve të lira në jetën e tyre.<sup>148</sup>

Shkaqe të shkurorezimit janë edhe varësitë e ndryshme si psh: alkoolizmi, droga, lojërat e fatit etj. Poashtu edhe deri të shkurorezimi tek çiftet e reja vie si pasojë e asaj se kanë hyrë në martesë shpejt dhe pa menduar mirë, pastaj te disa edhe situata ekonomike etj. Shkaktarë të tjerë të shkurorezimit poashtu janë edhe përzierja apo ndërhyrja e prindërve , imponimi i mendimeve dhe vendimeve të tyre bashkëshortëve të rinj. Kur është në pyetje partnerët më të vjetër si shkaktarë të shpeshtë janë xhelozia , shkelja e integritetit të njërit bashkëshort , dhuna në familje etj. Poashtu rritjes së numrit të shkurorezimeve i ka ndihmuar edhe ajo sepse në ditët e sotme njëri është më pak tolerant dhe shikojnë më shumë të drejtat që kanë duke i anashkaluar përgjegjësit apo detyrimet. Për një martesë stabile është e domosdoshme mirëkuptimi dhe sakrifica. Shkaktarë tjerë është edhe fokusimi të kariera duke lënë anash martesën, apo edhe planifikimi i jetës në ndonjë vend tjetër. Shkurorezimet e martesave para se të mbushin as edhe një vjet nuk janë raste të rralla në Serbi dhe si shkak kryesor përsë bashkëshortët vendosin të shkurorezohen është bashkëjetesa me prindërit e bashkëshortit apo me

<sup>147</sup> Jens M. Shcherpe , vep e cit. fq.85

<sup>148</sup> Slobodan Panov, vep. E cit, fq.132

prindërit e bashkëshortes. Nga 1350 çifte sa janë ndarë në 2013-tën më shumë së një e pesta janë ndare në vitin e parë të martesës. Sipas ekspertëve në Qendrën për punë sociale të qytetit të Beogradit çdo ditë e më shumë çiftet e reja vendosin të shkurorëzohen akoma pa bërë një vjet martesë dhe si shkaktarin kryesor ekspertët thonë se është bashkëjetesa me prindërit e njërit prej bashkëshortëve. Nëse pyesim se përse ndodh kjo e para është sepse gjeneratat e reja rriten me frymën e individualizmit dhe jo të bashkësisë, si dhe përzierja dhe ndikimi i tepërt e prindërve të njërit bashkëshort në martesën e çiftit si dhe përzierja dhe ndikimi i tyre tek mënyra e prindërimit pra se si çifti i ri rrit dhe edukon fëmijët e tyre. Ekspertët nga kjo qendër konstatojnë se numri i shkurorëzimeve është në rritje e sipër, si dhe në rritje është edhe numri i atyre që nuk po mund të mirren vesh në lidhje me kryerjen e të drejtave prindërore pas shkurorëzimit, në vitin 2013 vetëm në Beograd, numri i fëmijëve ishte 8621 prindërit e të cilëve kanë argumentuar në lidhje me mënyrën e kryerjes së të drejtave prindërore.<sup>149</sup> Për shkak të rrezikut që i kanoset fëmijëve prindërit e të cilëve kanë mosmarrëveshje lidhur me të drejtat prindërore qendra për punë sociale iu ofron ndihmë profesionale për zgjidhjen e konfliktit si dhe merr masa për mbrotjen e të drejtave të fëmijëve. Poashtu nga analiza e martesave të shkurorëzuara konstatojnë se fëmijët më së shumti iu besohen nënës. Gjithashtu ekspertët nga përvoja e tyre që kanë thanë se fatkeqësisht raportet e këqija mes çifteve vazhdojnë akoma edhe pas shkurorëzimit, një numër i madh i baballarëve nuk e paguajnë alimentacionin, si dhe plot raste kur nënat nuk iu lejonë baballarëve ti shohin fëmijët e tyre, gjëra këto që i komplikojnë akoma më shumë raportet mes tyre.<sup>150</sup>

Ditët e sotme me zhvillimin e teknologjisë është rritur edhe shfrytëzimi i rrjeteve sociale të cilët poashtu kanë ndikim për shkurorëzim. Në Evropë shumë çifte fajësojnë Facebook-un për shkurorëzimin e tyre. Në Sërbë shkurorëzimi është akoma temë tabu dhe shumë e ndjeshme dhe shumë pak njëriëz flasin hapur për të. At që flasin theksojnë se pasojat më të mëdha i bartin fëmijët dhe po të mos kishin qenë fëmijët do ishin ndarë edhe më parë. Por nuk është vetëm problemi të fëmijët, të shumtë janë ata që e shtyejnë shkurorëzimin e një martese të palumtur për shkak të frikës nga paragjykimet e rrethit shoqërisë, reagimit të familjes etj.<sup>151</sup>

Punësimin e gruas disa autor e shohin edhe si shkaktar të shkurorëzimit. Studimet kanë treguar se punësimi i gruas ka ndikim në shifrat e shkurorëzimit. Sipas studimeve gratë e martuara të cilat punojnë jashtë shtpësië janë më të predispozuara të shkurorëzohen se sa gratë që nuk punojnë, kjo lidhet me faktin e të ardhurave pasi ajo ka mundësi ta mbaj veten ekonomikisht.<sup>152</sup> Mungesa e komunikimit gjithashtu është një ndër shkaktarët e shpeshtë të shkurorëzimit pasi të gjitha problemet mund të zgjidhen me komunikim të sinqertë dhe të hapur. Komunikimi është qelës për zgjidhjen e problemeve pasi shpesh herë shkaqet e frustrimit të partnerit nuk i dimë dhe vetëm duke komunikuar do mund ti kuptojmë dhe ti zgjidhim ato. Në anën tjetër partneri i frustruar duhet të flasë hapur dhe qartë për atë qfarë realisht e mundon, të flasë poashtu dhe për ndjenjat e tij dhe së bashku me partneren e tij të kërkojnë zgjidhje. Më e keqja në këtë situatë është se partnerët në vend së të gjejnë zgjidhje ata fillojnë të akuzojnë njëri tjetrin apo edhe ta injorojnë njëri tjetrin. Të rinjtë kanë gjithnjë e më shumë liri. Një njeri i ditëve të sotit nuk është shumë tolerant ndaj dobësive të partnerit. Ne kemi pritje të ekzagjeruara, shumë idealizojnë një imazh se si do të duhej që martesja të duket, ne jemi plot pritje dhe shpresa joreale dhe në fund vie zhgënjimi.

<sup>149</sup> <http://www.lepaisrecna.rs>

<sup>150</sup> Po aty

<sup>151</sup> <https://www.vesti.rs>

<sup>152</sup> Andrew J. Cherlin, vep. E cit, fq. 356

Është interesant fakti që Serbia qëndron jashtëzakonisht mirë sa i përket statistikave të shkurorëzimit të cilat në Serbi shfaqen në numër dukshëm më të vogël se në Unionin Evropian. Në 2011 vetëm tri vende anëtare të UE kanë pasur numër më të vogël të shkurorëzimeve. Serbia ka zënë vendin e 26-të sipas numrit të shkurorëzimeve, që në përgjithësi është një nga rezultatet më të mira. Edhe pse në Serbi po i kushtohet një vëmendje e madhe fenomenit të shkurorëzimit që është gjithnjë e në rritje Serbia në krahasim me vendet e UE në këtë fushë të statistikave familjare tregohet si një nga vendet më të shëndetshme në Evropë.<sup>153</sup> Grindjet e shpeshta përmenden si shkaqe kryesore të shkurorëzimit ato në fakt janë rezultat i pakënaqësisë së akumuluar, komunikimit të dobët dhe neglizhimit të problemeve. Ndër vrasësit e bashkësisë martesore janë edhe jeta e përditshme monotonja dhe neglizhimi i partnerëve, idealizimi i partnerit pas së cilës është zhgënjimi i pashmangshëm, situata e vështirë financiare, komunikimi i dobët, problemet në intimitet etj.<sup>154</sup>

Vështirësitë bëhen akoma më të mëdha me ardhjen e fëmijës, sepse atëherë prioritetet ndryshohen, ku përveç stresit detyrimeve të shumta dikush e më së shpeshti bashkëshorti i vuan , që është gabim, sepse marrëdhënia bashkëshortore është themeli i çdo gjëje. Nëse kësaj ia shtojmë edhe bashkëjetesën me prindërit, fitojmë një përzierje të gjeneratave dhe roleve të ndryshme, ku përsëri viktimë është marrëdhënia midis partnerëve pra sakrifkohet. Tek ne pretendohet se arsyeja kryesore pse ndodh kjo janë vështirësitë financiare që i detyrojnë të jetojnë së bashku pra në bashkësi, por përvoja tregon se njerëzit shpesh nuk duan të heqin dorë nga komoditeti që kanë në shtëpinë e prindërve të tyre, sepse ata janë të papërgatitur për jetë të pavarur dhe nuk dalin dot nga roli i fëmijës shpesh deri në moshën dyzetvjeçare. Por kjo gjithnjë ka çmimin e saj , bashkëshortët duhet të shqyhen ndërmjet prindërve, partnerëve dhe fëmijëve, të cilët përveç punës dhe problemeve ekzistenciale paraqesin një situatë pothuajse të padurueshme që shpesh rezulton me shkurorëzim.<sup>155</sup>

Përveç familjeve me shumë breza, Serbia ka edhe një veçori tjetër sa i përket shkurorëzimeve : papjekuria e personit që hyn në martesë, ekspertët theksojnë se kjo nuk ka të bëjë me vitet, por me përvojën e jetës, autonominë dhe vetëdijesimin. Në shkurorëzim, gruaja ka 39 vjet mesatarisht, ndërsa burri 43 vjeç, dhe martesat në Serbia shkurorëzohen mesatarisht pas 13 vitesh. Mjaft autorë e kanë analizuar divorcin dhe intensitetin e problemeve që krijon ai, edhe në raport me integrimin në komunitetin fetar , me shkallën e besimit, shpeshësinë e pjesëmarrjes në ceremoni dhe rite fetare apo me frekuentimin e institucioneve fetare. Studimet janë përqëndruar edhe në të tjerë tregues që ndikojnë mbi shkurorëzimin siç janë : liberalizmit të shoqërisë, tipi dhe mosha e martesës, numri i fëmijëve deri të shpeshësia e shtatzanive, niveli i punësimit, të ardhurat mesatare , diferenca e të ardhurave mes partnerëve, simptomat e depresionit etj.<sup>156</sup>

Pavarësisht nga motivi i divorcit, ai është pothuajse gjithmonë i vështirë. Sipas shkallës së stresit, ai është në pozitë të dytë pas vdekjes së personit të afërt. Është e vërtetë që më mirë një shkurorëzim i mirë se një martesë e keqe , por shkurorëzimi fatkeqësisht në realitet shume rrallë është i mirë. Për fat të keq, ka shumë pak shkurorëzime të civilizuar dhe të shëndetshëm. Dominojnë shkurorëzimet ku ata kanë ndarje armiqësore dhe të rënda në të cilat fëmijët janë viktimat të manipulimit prindëror. Nëse jeni i divorcuar, përparësia është që ndaj fëmijëve tuaj të keni një marrëdhënie të sinqertë me ta dhe të kuptoni se të dy prindërit janë të rëndësishëm për

---

<sup>153</sup> <https://pescanik.net>

<sup>154</sup> Po aty

<sup>155</sup> <http://www.novosti.rs>

<sup>156</sup> Hamit Beqja Lekë Sokoli, vep. E cit, fq.58



të.Është gjithashtu e rëndësishme që të kërkojmë mbështetje nga njerëz që na kuptojnë dhe izohemi nga presioni i rrethit. Një vendim divorci është një çështje personale dhe askush nuk ka të drejtë të paragjykojë. Ilaqi më mirë për gjdo sëmundjë është parandalimi. E njejta vlen edhe për shkurorëzimin. Kjo do të thotë një zgjedhje më e kujdesshme e partnerit me të cilin do të hymë në martesë dhe do të krijojmë familje. Pastaj, duke ruajtur vazhdimisht martesën nëpërmjet respektit reciprok në radhë të parë, komunikimit të mirë si dhe duke i kujtuar kujtimet pozitive të partnerit dhe arsyen pse e duam këshillojnë psikologët.<sup>157</sup> Serbët më së shumti shkurorëzohen 5 vitet e para të martesës.

Tabela 1

| VITI | NUMRI I MARTESAVE | NUMRI I SHKURORËZIMEVE | KOHËZGJATJA MESATARE E MARTESËS |
|------|-------------------|------------------------|---------------------------------|
| 2010 | 35.815            | 6.664                  | 12,5                            |
| 2011 | 35.808            | 8.251                  | 12,7                            |
| 2012 | 34.639            | 7.372                  | 12,9                            |
| 2013 | 36.209            | 8.170                  | 13,4                            |
| 2014 | 36.429            | 7.614                  | 13,6                            |
| 2015 | 36.949            | 9.381                  | 13,3                            |

Tabela 1 – të dhëna të marra nga Enti Republikan për Statistika i Serbisë<sup>158</sup>

Siç mund të shihet nga tabela në Sërbi për vitin 2010 ka pasur gjithsej 35.815 kurorëzime, ndërsa 6.664 shkurorëzime. Kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar për këtë vit është 12,5 vite. Sa i përket moshës së bashkëshortëve , mesatarja e moshës së burrit për vitin 2010 është 42 vjet , ndërsa moshë mesatare e gruas është 39 vite.

Numri i martesave për vitin 2011 është 35.808 që në krahasim me vitin 2010 – 35.815 nuk paraqet ndonjë ndryshim shumë të madh. Mirëpo me shkurorëzimin nuk është e njejta gjë, pasi të dhënat tregojnë një rritje të shkurorëzimit nga 6.664 shkurorëzime në 2010 në 8251 shkurorëzime në 2011 që do të thotë një rritje prej 24.19%. Të dhënat për vitin 2011 tregojnë së moshë mesatare e çiftit që është shkurorëzuar për gruan është 39 ndërsa për burrin është 43 vite, ndërsa kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar është 12,7 vite. Numri më i madh i shkurorëzimeve ka qenë i atyre çifteve që nuk kishin fëmijë gjithsej 45% e numrit të të shkurorëzuarve për vitin 2011. Sa i përket çifteve të shkurorëzuar që kishin fëmijë 79% të rasteve kujdestaria i ka takuar nënës. Në Serbi një rëzimit nuk martohen të rinjë , moshë mesatare kur të rinjë martohen për herë të parë është për gruan 27 vite ndërsa për burrin 30 vite.

Në vitin 2012 kishte 34.639 martesë ndërsa 7.372 shkurorëzime. Moshë mesatare e çifteve të shkurorëzuara për gruan ishte 39 ndërsa për burrin 43 vite, kurse moshë mesatare e martesave të shkurorëzuara ishte 12,9 vite. Vlen të përmendet se 46% e çifteve të shkurorëzuara ishin pa fëmijë , që edhe njëherë tregon se shkurorëzimi më së shumti ndodh të çiftet pa fëmijë. Sa i përket në cilat vite të martesës më së shumti janë shkurorëzuar çiftet dominojnë vitet e para të martesës : 21,7 % janë ndarë vitet prej 1 – 4 vite martesë si dhe 22,2 prej 5 - 9 vite martesë.

<sup>157</sup> Po aty

<sup>158</sup> <http://www.stat.gov.rs/>

Viti 2013 në krahasim me vitin 2012 duket se ishte më i mirë sa i përket numrit të kurorëzimeve pasi nga 34.639 kurorëzime sa kishte në 2012-tën u rrit në 36.209 në 2013 tën pra ka pasur 1570 kurorëzime më tepër. Ndërsa sa iu përket shkukurorëzimeve edhe ato patën rritje nga 7.372 në 2012tën në 8170 në 2013tën ose 11% më shumë së vitin paraprak. Kohëzgjatja mesatare e martesës së shkukurorëzuar për vitin 2013 ishte 13,4 vite. Sa i përket moshës mesatare gruaja 39 ndërsa burri 43 vite. Për këtë vit më së shumti ka pasur shkukurorëzime të çifteve më fëmijë me rreth 55% të të shkukurorëzuarve. Ndërsa sa i përket kujdestarisë 78 % të rasteve kujdestaria iu ka takuar nënës.

Sa i përket vitit 2014 në Sërbi kishte 36.429 kurorëzime dhe 7.614 shkukurorëzime. Moshë mesatare e çiftit të shkukurorëzuar për gruan ishte 39 ndërsa për burrin 43 vite. Jetëgjatësia mesatare e martesës së shkukurorëzuar për këtë vit ishte 13,6 vite. Sa iu përket fëmijëve dominojnë çiftet e shkukurorëzuara që kanë fëmijë me gjithsej 57 % nga numri i të shkukurorëzuarve. Edhe në këtë vit çiftet janë shkukurorëzuar më së shumti në vitet e para të martesës: 1-4 vite martesë 19,7 % e të të shkukurorëzuarve dhe 21% 5-9 vite martesë. Ndërsa sa i përket kujdestarisë ajo i ka takuar më së shumti nënës me 73 % të çifteve të shkukurorëzuarve me fëmijë.

Në vitin 2015 është rritur numri i kurorëzimeve nga 36.429 në 2012tën në 36.949 kurorëzime. Por gjithashtu vihet re një rritje e konsiderueshme e numrit të shkukurorëzimeve, 7.614 shkukurorëzime sa pati në 2014 në 9.381 shkukurorëzime. Kohëzgjatja mesatare e martesës së shkukurorëzuar për këtë vit ishte 13,3 vite. Moshë mesatare e çiftit të shkukurorëzuar për gruan ishte 40 vite ndërsa për burrin 44 vite. Këto të dhëna që i mora nga Enti Statistikor edhe njëherë demantojnë tezën se fëmijët janë një shtyllë që e mbajnë familjen së bashku sepse më shumë së gjysma respektivisht 56 %e çifteve të shkukurorëzuar kanë qenë me fëmijë. Edhe këtë vit më së shumti shkukurorëzime ka pasur : 1-4 vite martesë 21,7 % e të të shkukurorëzuarve, 5- 9 vite martesë 20,5 % e të shkukurorëzuarve, që edhe njëherë na dëshmon faktin se çiftet më shumti shkukurorëzohen në vitet e para të martesës. Edhe në vitin 2015 sa i përket kujdestarisë së fëmijëve kanë dominuar nënat me rreth 72 % ta rasteve.

## **4.6. Vështrime krahasuese mbi shkukurorëzimin në shtetet fqinje**

### **4.6.1. Shkukurorëzimi në Shqipëri**

Shkukurorëzimi, ky fenomen në rritje ka prekur edhe shoqërinë shqiptare. Shqipëria është futur tashmë në procesin e integritit evropian dhe shoqërië shqiptare i duhet të përballet me dukuri të reja, pozitive si dhe me probleme të rënda e shqetësuese. Një prej tyre është divorci, I cilësuar si zgjidhja e vetme për një familje jofunksionale e një martesë të dështuar, por edhe si shkatërrimi përfundimtar i një lidhjeje martesore me pasoja negative për çiftin, por mbi të gjitha për fëmijët.

Numri i divorceve në Shqipëri ka pësuar rritje të ndjeshme vit pas viti sidomos pas viteve '90, një tregues ky edhe i emancipimit të gruas shqiptare. Kryesisht në kohën e monizmit femrat shqiptare për hir të fëmijëve dhe nivelit të ulët ekonomik pranorin të mbanin një bashkëshort jo të denjë edhe pse vuanin psikologjikisht apo keqtrajtoheshin. Megjithatë në ditët e sotme numri i divorceve ka alarmuar jo vetëm shoqërinë shqiptare, por edhe agjensitë ndërkombëtare të statistikave. Shkukurorëzimi në Republikën e Shqipërisë rregullohet me Kodin e Familjes.<sup>159</sup>

<sup>159</sup> <https://www.slideshare.net>

Sipas të dhënave më të fundit të publikuara nga Instituti i Statistikave, në 100 martesë në Shqipëri 31 shkonin në ndarje, me një rritje të ndjeshme në krahasim me vitin e mëparshëm, kur ky tregues ishte rreth 22. Në këtë mënyrë, Shqipëria ka hyrë në zonën e kuqe, në grupin e vendeve të cilët kanë një normë divorci 30-39 për 100 martesë. Në të njëjtin nivel me ne, për sa i përket divorceve janë Italia, Greqia dhe Turqia. Vendet e rajonit janë pjesë e grupit të vendeve me normë më të ulët të divorceve për 100 martesë.<sup>160</sup>

Sipas kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë, janë parashikuar raste të ndryshme të zgjidhjes së martesës:

- 1) Me pëlqimin reciprok të dy bashkëshortëve (Nenet 125-128 të KF).
- 2) Për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët (Nenet 129-131 të KF).
- 3) Me kërkesën e njërit bashkëshort (Nenet 132-133 të KF).

*Pëlqimi reciprok i bashkëshortëve* - Zgjidhja e martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve, bazohet në një marrëveshje reciproke, të përbashkët, të tyre, e cila ka për qëllim dhënien fund të martesës që ekziston midis dy bashkëshortëve. Zgjidhja e martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve, rregullohet nga nenet 125-128 të Kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë. Nga parashikimet e ketyre dispozitave përcaktohet se si procedohet nepermjet zgjidhjes së martesës me pëlqimin e bashkëshortëve. Së pari, e gjithë procedura gjyqësore fillon me paraqitjen e një kërkesë të përbashkët të të dy bashkëshortëve, të cilët përcaktojnë se duan që të zgjidhin martesën e tyre. Kjo kërkesë mund të paraqitet në gjykatë ose nga bashkëshortët personalisht ose nga përfaqësuesit e tyre respektivë. Së dyti me kërkesën për zgjidhjen e martesës, bashkëshortët duhet t'i paraqesin gjykatës edhe një projekt marrëveshje në të cilën të jetë parashikuar mënyra e rregullimit të pasojave që vijnë si rrjedhojë e zgjidhjes së martesës, të cilat janë: Lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të mitur dhe përcaktimin e të ardhurave për rritjen dhe edukimin e tyre. Kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar. Rregullimin e marrëdhënieve pasurore midis bashkëshortëve. Së treti, gjykata ka për detyrë të shqyrtojë kërkesën e dy bashkëshortëve. Nëse gjykata bindet për sa më sipër, vendos zgjidhjen e martesës dhe në të njëjtin vendim, miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Vendimi i gjykatës, si çdo vendim gjyqësor, mund t'i nënshtrohet mjeteve të ankimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.<sup>161</sup>

*Për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët* - Kodi i Familjes parashikohet se bashkëshortët kanë detyrimin e jetesës së përbashkët. Mungesa e jetesës së përbashkët të bashkëshortëve, mund të përbëjë shkak për zgjidhjen e martesës, nëse zgjat tej një afati të caktuar në ligj (tre vjet). Zgjidhja e martesës sipas nenit 129 të Kodit të Familjes, është e lidhur ngushtë me dy elemente faktike. Së pari duhet që bashkëshortët të jetojnë faktikisht dhe fizikisht të ndarë dhe së dyti duhet që kjo gjendje të vazhdojë që prej tre vjetësh. Bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët, duhet të paraqesë në gjykatë një kërkesëpadi. Gjkata që shqyrton kërkesëpadinë për zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët për mbi tre vjet, duhet që të caktojë në fillim një seancë pajtimi ku të respektohen parashikimet e neneve 134-136 të Kodit të Familjes.<sup>162</sup>

<sup>160</sup> <http://www.javanews.al>

<sup>161</sup> <http://portal.tlas.org.al>

<sup>162</sup> Po Aty

*Me kërkesën e njërit bashkëshort* - Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort është një nga rastet që haset më shpesh në praktikë. Kjo formë e zgjidhjes së martesës mund të zbatohet kur paraqiten shkaqet e parashikuara shprehimisht në Kodin e Familjes.( neni 132 i KF).Shkaqet të cilat justifikojnë ngritjen e padisë për zgjidhjen e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort janë:

- 1-Grindjet e vazhdueshme.
- 2-Keqtrajtimet.
- 3-Fyerjet e rënda.
- 4-Shkelja e besnikërisë bashkëshortore.
- 5-Sëmundja mendore e pashërueshme.
- 6-Dënimi penal i rëndë i bashkëshortit.
- 7-Çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve martesore.

Të gjitha shkaqet e sipërpërmendura kanë të përbashkët faktin se përbëjnë shkelje të përsëritura të detyrimeve që rrjedhin nga martesë dhe për pasojë jetesa e përbashkët e bashkëshortëve, bëhet e pamundur dhe martesë humbet qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët. Në shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës, gjykata cakton fillimisht një seancë pajtimi, në të cilën duhet të paraqiten personalisht bashkëshortët. Nëpërmjet zhvillimit të kësaj seance gjykata shikon mundësinë e pajtimit midis palëve, duke jua ofruar atyre këtë mundësi. Me zgjidhjen e martesës mbaron pushon edhe bashkëjetesa e bashkëshortëve si një nga elementët bazë që karakterizojnë martesën. Për rrjedhojë, ky ndryshim pasqyron edhe ndryshime të tjera lidhur me banimin e veçantë dhe marrëdhëniet personale të secilit prind me fëmijën.<sup>163</sup>

### *Statistikat e shkurorëzimeve Shqipëri*

Statistikat lidhur me divorcin janë të shumta, të siguruar nga INSTAT, studimet e “Nation Master”, Gjykatat e Shkalles së Parë, etj. Po fillojmë me statistikën nga INSTAT-i duke filluar nga viti 1990 – 2003.<sup>164</sup>

| 1990 | 1991 | 1992 | 1993 | 1994 | 1995 | 1996 | 1997 | 1998 | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 |
|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| 2675 | 2236 | 2480 | 2251 | 2108 | 2331 | 1901 | 1430 | 2005 | 2114 | 2168 | 2462 | 3494 | 3634 |

<sup>163</sup> <http://portal.tlas.org.al>

<sup>164</sup> <https://www.slideshare.net>

Të dhënat nga Nation Master janë për shkurorëzimet 2004 – 2009.

| VITI | SHKURORËZIMET |
|------|---------------|
| 2004 | 3670          |
| 2005 | 4633          |
| 2006 | 4727          |
| 2007 | 5335          |
| 2008 | 6109          |
| 2009 | 5621          |

Të dhëna statistikore mbi shkurorëzimet nga viti 2010-2016<sup>165</sup>

| VITI | SHKURORËZIMET |
|------|---------------|
| 2010 | 5970          |
| 2011 | 4807          |
| 2012 | 5157          |
| 2013 | 6712          |
| 2014 | 7214          |
| 2015 | 7080          |
| 2016 | 7645          |

Siç shihet,shkurorëzimi tashmë është një dukuri mjaft e përhapur në shoqërinë shqiptare dhe shifrat e publikuara nga gjykatat dhe media e dëshmojnë këtë të vërtetë të hidhur. Nga studimet e agjencisë “Nation Master” Shqipëria renditej e 14-ta në botë,e 5-ta në Evropë dhe e para në Ballkan sa i përket numrit të divorceve. Divorci padyshim është zgjidhja për një martesë të dështuar e një familje jofunksionale,por nga ana tjetër ai është shkatërrimi i familjes dhe ndoshta një nga dëmet më të mëdha për fëmijët.<sup>166</sup>

---

<sup>165</sup> <http://www.drejtësia.gov.al>

<sup>166</sup> Po aty

#### 4.6.2. Shkurorëzimi në Kosovë

Shkurorëzimi është gjithnjë në rritje si shkak i shumë faktorëve të ndryshëm duke përfshirë këtu edhe Kosovën, ku kohës së fundit divorci ka filluar që të marrë përmasa të mëdha. Periudha e tranzicionit, elementet e ndryshimit në strukturën e familjes, por edhe vetë elementet tjera kanë ndikuar që në Kosovë të rritet divorci me të madhe. Hulumtimet e bëra nga shumë organizata tregojnë se ka një rritje të divorcit në Republikën e Kosovës, Sociologët mundohen që të japin shpjegime të ndryshme lidhur me shkaqet e lindjes së divorcit në shoqërinë tonë. Disa e lidhin me ndryshimin e strukturës së familjes kosovare, mirëpo disa e lidhin me faktorë tjerë. Megjithatë, mund të themi se disa nga shkaqet e lindjes së divorcit në shoqërinë tonë janë :

1. konfliktet në mes të bashkëshortëve (mos koordinimi, mos kompromisi adekuat),
2. dobësimi i rolit në familjen kosovare, rënia e një prestigji familjar krahasuar më parë,
3. diferencat në moshë ku shumica e vajzave martohen të reja dhe ende nuk ka një pjekuri psikologjike dhe sociale andaj vie deri tek ndarja,
4. kriza e sistemit të vlerave,
5. tradhtia bashkëshortore,
6. konfliktet e ndryshme në familje e sidomos në relacionet nuse – vjehërr, nuse – kunatë (motra e burrit),
7. divorci mund të lind si pasoj e shkaqeve ekonomike (papunësi e madhe, varfëria tejet e lartë në disa raste 40 %),
8. nuk duhet harruar se shumë raste të divorcit tek shoqëria kosovare bëhen edhe për përfitime materiale, në këtë mënyrë duke bërë divorc me bashkëshorten vetëm për t'i fituar shtetësinë e ndonjë vendi perëndimor (shkurt – shqip për letra), e pastaj disa ribashkohen, disa jo.

Këta janë disa nga faktorët që çojnë drejt divorcit, mirëpo në këtë drejtim nuk mund të anashkalohen edhe shumë faktorë tjerë.<sup>167</sup> Në Kosovë egziston Ligji për Familjen Nr. 2004/32 i miratuar më 20 Janar 2006. Sipas këtij ligji :

1) Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës.  
(2) Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente.

(3) E drejta për ngritjen e padis për shkurorëzim nuk mund të kalohet te trashëgimtarët, por trashëgimtarët e paditësit mund të vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë.

(4) Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozimin për shkurorëzim me marrëveshje.<sup>168</sup>

Sa iu përket shkaqeve të shkurorëzimit legjislacioni i Kosovës ka paraparë si shkaqe të shkurorëzimit :

1) marrëdhëniet e çrregulluara martesore seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, ose kur për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pa kthyeshme

2) jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme,

<sup>167</sup> <https://telegrafi.com/>

<sup>168</sup> Neni 68 i Ligjit për Familjen i Kosovës

sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme.<sup>169</sup>

Se trendi i divorceve po shkon vetëm duke u rritur, sociologu Besian Gollopeni, thotë se në një nga studimet që kanë realizuar gjatë viti 2007, kanë ardhur në përfundim se në vitin 1970 çdo i 44 çift i kurorëzuar shkurorëzohej, ndërsa në vitin 2007 çdo i 11-ti çift i kurorëzuar shkurorëzohet. Sociologu Besim Gollopeni thekson arsyet e shkurorëzimeve të shumta që po ndodhin në Kosovë. Sipas tij, njëri ndër shkaktarët kryesor për kërkesa divorci është tradhtia bashkëshortore. “Bazuar në studimet e mëparshme, ndër arsyet kryesore për shoqërinë kosovare, që shpie drejt shkurorëzimit janë: tradhtia bashkëshortore që paraqitet si një ndër shkaktarët kryesor që shpie drejt shkurorëzimit, mospërshtatja e karaktereve, implikimet familjare (përzija e anëtarëve tjerë në jetën bashkëshortore)”, ka deklaruar ai.<sup>170</sup> Sipas Gollopenit, ndikim jo të vogël ka edhe emigracioni, situata e pavolitshme ekonomike dhe raste të tjera. “Një ndër arsyet mjaft prezentë dhe me rëndësi në shkurorëzim të qifteve në Kosovë është edhe prezenca e dhunës familjare, posaçërisht e dhunës së ushtruar ndaj gruas nga ana e bashkëshortit apo anëtarët tjerë të familjes së bashkëshortit”, shton më tej sociologu. Sociologët ngrisin shqetësimin se rritja e trendit të divorceve vjen edhe si rezultat i hyrjes në moshë të re në martesë, diferencat për nga mosha dhe niveli i shkollimit, niveli i punësimit të burrat dhe gratë, të ardhurat personale, e faktorë tjerë socio-ekonomik. Sipas Besim Gollopenit, sociolog, i pari nga shkaqet e divorcit në shoqërinë kosovare renditet tradhtia bashkëshortore, pastaj mospërshtatja e karaktereve, e implikimet familjare (përzija e anëtarëve tjerë në jetën bashkëshortore).<sup>171</sup>

Për të parë më mirë trendin e rritjes së shkurorëzimit në vazhdim do të paraqesë një tabelë ku do të mund ti shohim më saktë shkurorëzimet në Kosovë.

Të dhëna statistikore mbi shkurorëzimet marrë nga Agjensioni i Statistikave të Kosovë<sup>172</sup>

| VITI        | SHKURORËZIMET |
|-------------|---------------|
| <b>2010</b> | <b>1453</b>   |
| <b>2011</b> | <b>1469</b>   |
| <b>2012</b> | <b>1329</b>   |
| <b>2013</b> | <b>1040</b>   |
| <b>2014</b> | <b>1243</b>   |
| <b>2015</b> | <b>1268</b>   |
| <b>2016</b> | <b>1 110</b>  |

Viti me më shumë shkurorëzime ka qenë viti 2010 ndërsa viti me më pak shkurorëzime ka qenë viti 2013. Mund të konkludojmë se megjithëse shkurorëzimet janë në rritje nëse krahasojmë më vendet tjera Kosova ndër shtetet me shifrat më të ulta në rajon.

<sup>169</sup> Neni 69 i Ligjit për Familjen i Kosovës

<sup>170</sup> <http://aktivpress.com/>

<sup>171</sup> <http://www.gazetamonitor.com/>

<sup>172</sup> ASK-Agjensioni i Statistikave të Kosovës

### 4.6.3.Shkurorëzimi në Maqedoni

Edhe në Maqedoni sikurse në të gjitha shtetet tjera të Ballkanit po vërehet një rritje e numrit të shkurorëzimit.Në Maqedoni po zvogëlohet numri i kurorëzimeve, ndërsa rritet numri i divorceve.Kështu flasin statistikatat. Numri i divorceve gati dyfishohet kohën e fundit tek çiftet bashkëshortore në vendin tone, ndërsa të rinjtë shumë më rëndë vendosin që të kurrorëzohen. Kështu flasin të dhënat më të reja të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave në Maqedoni.<sup>173</sup>

Ligji mbi Familjen i RM-së ka paraparë dy mënyra të inicimit të procedurës për shkurorëzim:

- 1) me marrëveshje (propozim) të përbashkët të bashkëshortëve
- 2)me anë të padisë së ngritur nga ana e njërit bashkëshort.<sup>174</sup>

Ky ligj parasheh tri shkaqe të shkurorëzimit :

- a)pëlqimi i përbashkët i bashkëshortëve për ndarjen e tyre
- b) jetesa e përbashkët është bërë e padurueshme
- c) marrëdhëniet martesore në mënyrë faktike kanë pushuar të funksionojnë më gjatë se një vit.<sup>175</sup>

Pas pranimit të padisë për shkurorëzim ose propozimit për shkurorëzim me marrëveshje, para dorëzimit të padisë të paditurit mbahet seancë për pajtim të bashkëshortëve.Seancë për pajtim të bashkëshorteve nuk do mbahet në këto raste:

1. nëse njëri nga bashkëshortët është i paaftë për të gjykuar
2. nëse njëri ose të dy bashkëshortët jetojnë në botën e jashtme
3. nëse është i pa njohur vendbanimi i njërit nga bashkëshortëve më tepër se 6 (gjashtë) muaj
4. nëse pas parashtrimit të kundërpadisë për shkurorëzim, pa marrë parasysh kur është parashtruar, tentimi për pajtim të bashkëshortëve ka qenë i pasuksesshëm.<sup>176</sup>

Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar ushtrimi i të drejtës prindërore, tentimi për pajtim të bashkëshortëve realizohet nga qendra për punë sociale. Në raste nga al.3 e këtij neni gjykata në afat prej 8 (tetë) ditësh njofton me shkrim qendrën për punë sociale lidhur me të dhënat se kur është iniciuar procedura e shkurorëzimit, arsye kryesore pse kërkohet shkurorëzimi dhe të dhënat për fëmijët. Qendra punë sociale është e obliguar që në afat prej 3 (tre) muajve nga pranimi i njoftimit me shkrim ta përfundoj Seancën për pajtim të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të përbashkët ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar ushtrimi i të drejtës prindërore, procedurën për pajtimin e bashkëshorteve e zhvillon gjykata, por vetëm nëse nuk vlerësohet se është më mirë që procedura për pajtim të zhvillohet nga qendra për punë sociale.<sup>177</sup>

<sup>173</sup> <https://telegrafi.com/>

<sup>174</sup> Neni 39 dhe 40 i Ligjit për Familjen i RM-së

<sup>175</sup> Nenet 39, 40 dhe 41 i LF të RM-së

<sup>176</sup> Neni 237 i LF i RM-së

<sup>177</sup> Po aty



Tabela në vazhdim do të paraqese statistikën e shkurorëzimeve në Republikën e Maqedonisë, që të kemi një pasqyrim më të saktë të numrit të shkurorëzimeve.<sup>178</sup>

| VITI | SHKURORËZIMET |
|------|---------------|
| 2010 | 1720          |
| 2011 | 1 753         |
| 2012 | 1 926         |
| 2013 | 2 045         |
| 2014 | 2 210         |
| 2015 | 2 200         |
| 2016 | 1 985         |

Tradhtia dhe pamundësia për të paguar borxhet janë dy arsye kryesore për shkak të të cilave më së shpeshti ndodh që vjen deri te divorci në Maqedoni, tregojnë analizat e publikuara në Shkup. Në 90 % të rasteve, praktika tregoi se iniciator për ndërprerjen e martesës janë gratë, përderisa burrat nuk janë vendimtar për një hap të tillë. Statistika ka treguar se sipas moshës së gruas, pjesa më e madhe e divorceve ka ndodhur në moshën nga 30 deri në 34 vjeç, ndërsa për burrat nga 35 deri në 39 vjeç. Megjithatë, avokatët thonë se kohët e fundit po hetohet një trend i rritjes së numrit të personave që ndahen në moshën e vonshme, gjegjësisht mbi 50 vjeç.<sup>179</sup>

Viti me më shumë shkurorëzim ka qenë viti 2014 ndërsa viti me më pak shkurorëzime ka qenë viti 2010. Bazuar në këto të dhëna mund të themi se pavarësisht faktit që ka një rritje të shkurorëzimit Maqedoni krahasuar me vendet tjera ka shifrat më të ulta në Ballkan.

<sup>178</sup> <http://www.stat.gov.mk>

<sup>179</sup> <http://www.gazetaexpress.com/>

## KAPITULLI I KATËRT

### 5.AKTUALITETI I SHKURORËZIMIT NË KOMUNËN E PRESHEVËS

#### 5.1.Shkaqet aktuale të shkurorëzimit në Komunë të Preshevës

Me zhvillimin e hovshëm të shoqërisë , zhvillimin e teknologjisë, ndryshimi i sistemit të vlerave , papunësia,varfëria,liritë më të mëdha të njeriut, të drejtat e grave ,rrjetët sociale janë vetëm disa nga shkaqet e ditëve të sotme që ndikojnë dukshëm në bashkësinë martesore dhe familjare në përgjithësi.Martesa dhe familja e kanë humbur rolin dhe rendësinë që kanë pasur dikur.Familja si celula më e rendësishme dhe njëherit më delikate e shoqërisë nuk po shikohet më nga gjeneratat e reja si një gjë e shenjtë siç është parë dikur.Njeriu i ditëve të sotit është më tepër egoist dhe më shumë shikon të drejtat që ka dhe jo aq shumë detyrimet.Njerëzit janë bërë më pak tolerant.

Trendi i rritjes së shkurorëzimeve ka kapluar mbarë botën, e këtij trendi nuk ka mundur t'i iki as komuna e Preshevës.Ashtu sikur në të gjitha vendet edhe në komunën tonë vihet re një rritje e konsiderueshme e numrit të shkurorëzimeve.Nëse e krahasojmë me dhjetë vite më parë ,ku tema e shkurorëzimit ka qenë një temë tabu, ku njerëzit nuk kanë folur hapur për të , rastet e shkurorëzimit kanë qenë shumë të rralla , edhe kur ka pasur ndonjë rast të rrallë njerëzit nuk kanë folur shumë hapur në lidhje me shkaqet e shkurorëzimit.Femra në krahasim me mashkullin ka qenë në një pozitë më të disfavorshme pasi që është etiketuar nga shoqëria si e shkurorëzuar.Etiketimi ka pasur një efekt të rëndë pasi përveq stigmatizimit që iu është bëra nga ana e shoqërisë , përveq paragjyqimeve të shumta , vazhdimi i jetës për ato femra ka qenë shumë i vështirë , kjo për shkak të mentalitet patriarkal.Ka patur plot raste edhe më të rënda kur femra ndonëse e pakënaur , e palumtur apo edhe më keq e keqtrajtuar psikikisht apo fizikisht edhe nëse ka dashur të ndahet, për shkak të fëmijëve ka duruar dhe nuk është shkurorëzuar.Por kjo më nuk është kështu , edhe pse ndoshta prap ka raste të tilla por janë të rralla.Pasi që femrat në komunën tonë po vetëdijësohen , po arsimohen , po punosohen janë ta pavarura ekonomikisht, kanë të drejta më shumë se në ta kaluarën, janë më të lira në përgjithësi, edhe nuk durojnë aq shumë sa kanë duruar më parë, kjo është edhe njëra ndër shkaqet që ka ndikuar në rritjen e shkurorëzimit në komunën e Preshevës.

Për ti kuptuar më mirë shkaqet aktuale të shkurorëzimit në Komunën e Preshevës unë kam vajtur në gjykatë për të parë dhe analizuar disa nga raste të shkurorëzimit.Kam intervistuar dy gjyqtar dhe një avokat. Poashtu kam shkuar në zyrën e ofiçarisë së Komunës së Preshevës ku aty më është dhënë mundësia ti shof të gjitha rastet e shkurorëzimit në Komunën e Preshevës për vitet 2010-2015,aty kam shkuar çdo ditë nga ora 7 e mëngjesit deri ora 3 për gati 4 javë me rradhë ku kam pasur rastin ti shof të gjitha rastet , ku kam studiuar çdo rast të shkurorëzimit veq e veq.Përveq tjerash kam intervistuar disa persona të shkurorëzuar këto 5 vitet e fundit.Kam bërë këto intervista me qëllim që ti analizoj disa nga rastet e martesave të shkurorëzuara , që ti kuptojmë më mirë shkaqet aktuale që kanë qar dhe po qojnë çiftet drejt shkurorëzimit në komunën tonë.Gjithsej kam bërë njëzetë intervista me persona që janë shkurorëzuar, prej tyre 13 kanë qenë të gjinisë femërore dhe 7 të gjinisë mashkullore.Dhe bazuar në to këto janë disa nga shkaqet aktuale të shkurorëzimit në komunën e Preshevës :

1) **mospërputhje e karaktereve dhe jetesa e padurueshme** – nga rastet e shikuara në gjykatë kam parë se ky ka qenë shkaktari më i shpeshtë i shkurorëzimit, çiftet nuk kishin hyrë shumë në detaje në lidhje me atë se përse ishin shkurorëzuar por si shkaktarë kryesor jepnin mospërputhjen e karaktereve dhe si pasojë e kësaj janë shkaktuar zënka të shumta të përditshme saqë jetesa e tyre e përbashkët është bërë e padurueshme.

2) **tradhëtia bashkëshortore** - nga rastet e studiuara kam parë se tradhëtia ishte ndër shkaktarët e shpeshtë të shkurorëzimit. Nga intervistat që kam realizuar me persona të shkurorëzuar dy nga njëzetë rastet gjithsej që kam intervistuar kanë pohuar se shkaktari i shkurorëzimit të tyre ka qenë tradhëtia bashkëshortore. “*Kemi pasur 12 vite martesë ,në fillim kemi kaluar mirë vitet e para por pastaj fillova me dyshu sepse mungojke shumë në shtëpi, pas 5 vitesh martesë e kam zbulu se është duke më tradhëtu por për shkak të fëmiut ia kam falë dhe kemi vazhdu deri në vitin e 12-të të martesës kur më ka thënë se e dashuron ni tjetër dhe më ka lënë mua bashkë me një fëmi- kështu ka pohuar njëra ndër personat e intervistuar. Në rastin tjetër ku shkaktar ka qenë prap tradhëtia i intervistuari ka thënë : “Gruaja më ka tradhëtu njëherë përmes rrjeteve sociale por pasi e kam kuptu ia kam falur për shkak të fëmijëve, por kur e kam kuptuar se më ka tradhëtu përsëri atëherë kam vendosur dhe jam shkurorëzuar”.*

3) **implikimet familjare** apo përzierja e anëtarëve të familjes në jetën e çiftit bashkëshortorë – nga rastet e studiuara kam ardhur në përfundim se implikimi apo përzierja e anëtarëve të familjes në jetën e çiftit është ndër shkaktarët e shpeshtë të shkurorëzimit. Katër raste nga njëzetë që kam intervistuar me të shkurorëzuarit kanë qenë raste ku si shkaktarë kanë fajësuar implikimet familjare. Pra përzierja e familjes në jetën e çiftit si shkaktarë të shkurorëzimit nuk janë raste të rralla në komunën tonë. Tre nga rastet kanë fajësuar vjehrrën si shkaktare të shkurorëzimit të tyre ndërsa një rast ka qenë nëna e nuses apo vjehrra dhëndrit.

“*Shkaktare e divorcit tim ka qenë kryesisht vjehrra pasi na është përzi shumë në jetën tonë bashkëshortore, burri im ka qenë nën ndikim të plotë të saj ka qenë sikur i hipnotizuar , aq shumë ka qenë i lidhur dhe aq shumë e ka dasht nënën e tij saqë nuk i shihte të bëmat e saj edhe kur i shihte bëhej sikur nuk i shihte edhe nëse ishte gabim vjehrra prap e mbronte edhe i jepte asaj të drejtë mu gjithmonë më shantë më akuzonte se nuk e doja nënën e tij, përkundër faktit që un e kam respektu i kam shku perqefi e kam nderu kam punu e gjithçka po kur e kam pa që ska ilaq për këtë gjendje e kam pa se ai dhe ajo nuk do të ndryshonin kurrë vendosa mu nda sepse u binda që kjo gjendje gjithmonë ka me vazhdu edhe vendosa mu nda më mirë së me më shku jeta me njerëz të tillë”.* – kështu është shpreh njëra ndër personat e shkurorëzuar që kam realizuar intervistë.

“*Unë me ish burrin tim jemi lidhur shumë të rinj me mbarimin e shkollës së mesme kemi vazhduar studimet jashtë vendit gjatë studimeve kemi bashkëjetuar edhe çdo gjë ka qenë në rregull kemi kalu mirë derisa erdhi momenti të kthehem në vendlindje dhe të martohemi, u kthyem dhe u martuam. Por menjëherë pas martesës filluan problemet. Nuk e kisha problem pse jetonin me prindërit e tij , por nëna e tij sillej shumë keq me mua nuk më dontë as respektonte më ofendonte çdo ditë. Në fillim e duroja thosha mos po përmirësohej me kalimin e kohës apo nëse do të bëhesha me fëmi. Por kur mbes shtatzanë e shof se ajo nuk e kishte ndërmend të ndryshonte. Un flas me burrin ia sqaroj gjendjen dhe pres nga ai mbrojtje dhe të më jepte të drejtë por ndodhi e kundërta filloi edhe burri me akuzat me ofendime , nuk e kisha ditur deri atëherë se si ishte puna , nuk di si ta sqaroj burri ishte i lidhur në mënyrë patologjike me nënën e tij , i besonte nënës së tij verbërisht ndërsa mua më shante dhe akuzonte se gënjej dhe po shpifi për nënën e tij. Un edhe pse e dërmuar psikologjikisht prap vazhdoj për shkak të dashurisë së madhe që kisha për të vazhdoja ditë pas dite e duroja nënën e tij derisa një ditë ndodhi që ajo*

*ushtroi dhuna fizike ndaj meje përshkak se un e kundërshtova sepse sapo kisha lindur isha lehonë dhe ajo më tha të qohem ti bëj punët ndërsa un nuk isha mirë aspak sepse kisha lindur fëmijun me operacion dhe aty më plasi dhe e kundërshtova për herë të parë i them jo sepse nuk mundesha të ngrihem nga shtrati pastaj ajo më rrahu. Kur vie burri i tregoj se çka kishte ndodhur edhe nga ai nuk mar përkrahje përkundrazi u nervozua me mua dhe aty bindem se martesë ime nuk ka shpëtim dhe se duhet të shkurorëzohesha sa më parë. Edhe pse ishte shumë e vështirë për mua sepse e doja dhe sepse kisha fëmijë u binda se kështu do të ishte më mirë dhe se fëmija im më mirë do të rritej në një ambient të qetë se sa të rritej në një shtëpi ku nuk i respektohet nëna në një shtëpi plot zënka sharje ofendimesh”-kështu pohoi njëra ndër personat e intervistuar.*

*“Në rastin tim shkaktare ka qenë vjehrra pasi ka qenë shumë xhelozë. Kur na shifte të ulur bashkë me burrin vinte na ulej në mes , nëse na shifte duke biseduar vinte dhe na ndërprente , nuk më linte ti shërbej ndonjëher mi merrte nga dora enët dhe ia mbushte me gjellë , kur vinte burri në shtëpi nuk më linte të dal ta pres por dilte ajo e para, nëse burri donte të dilte nga shtëpia ai duke mu drejtuar mu ose un isha gati tu desht me pyet ajo ma ndërpriste fjalën dhe e pyete ku po shkonte nuk më linte të ma thoshte mua se ku shkonte, nëse donim të dilnin vetëm nuk na linte edhe ajo vinte me neve. Në vend së ti bëhej qefi sepse kishim një raport shumë të mirë me burrin ndodhi e kundërta. Nuk i dukesha e dënjë për djalin e saj, sipas saj djali i saj e meritonte një më të mirë një grua më të bukur së unë dhe se un isha e paaftë. Burri ndikohej shumë nga ajo dhe e ndëgjonte për çdo gjë aq shumë i bindej sa që edhe u ndamë” – ka thënë një e intervistuar tjetër.*

*“Kemi pasur shumë mosmarrëveshje me ish gruan për shkak të nënës së saj e cila përzihej shumë në jeten tonë bashkëshortore. Edhe pse nuk ka jetuar me ne ajo e thërriste vazhdimisht në telefon ose vinte tek ne shumë shpesh dhe përzihej shumë në punët tona dhe kjo situatë ishte shumë e bezdisshme. Jam përpjekur kam folur me gruan por ajo nuk më dëgjonte ishte shumë e lidhur me nënën e saj sa që nuk e shifte se ajo na e dëmtonte lidhjen tonë. Kjo gjendje nuk kishte mbarim e kam paralajmëruar gruan se kjo situatë po më bezdis shumë dhe se po bëhet e padurueshme por nuk ma vinte veshin, un nuk kam lejuar askush të ndikoj martesën time as edhe nënën time, në anën tjetër gruas iu dukej normale që nëna e saj përzihej për çdo gjë e nuk na linte të qetë aspak. Kishim shumë mosmarrëveshje çdo ditë sa që jetesa u bo e padurueshme dhe vendosa të shkurorëzohem”- ka thënë njëri ndër të intervistuarit.*

**4)dhuna** – poashtu është një ndër shkaktarët e shkurorëzimit në Komunën tonë. Edhe pse nuk flitet shumë hapur në lidhje me të , shpeshherë çiftet në gjykatë nuk i shpalosin në detaje problemet e tyre. Por në intervistat e realizuara me persona të shkurorëzuar dy nga njëzetë rastet që kam intervistuar më kanë pohuar se iu janë nënshtruar dhunës gjë që tregon se është shkaktar i shkurorëzimit. Këtu vlen të theksojmë se literaturë zakonisht dhuna definohet si përdorim i dhunës , ndërsa dhuna në familja nënkupton përdorimin sistematik të dhunës fizike dhe psikike , kërcënimin anëtarëve të familjes me rrezikimin apo cenimin e sigurisë.<sup>180</sup>

*“Me ish burrin gjithçka në fillim dukej mirë ishte i dashur në fillim derisa u martuam. Pas martesës ndryshoi gjithçka , nuk dinte të zhvillonte një bisedë normale ishte i dhunshëm ushtronte ndaj meje dhunë psikike e fizike bile edhe me tradhëtonte. Un e duroja derisa një ditë erdh edhe në prani të fëmijës tonë më tha se un nuk të du ty, po du me gjejt dashurinë time të vërtetë dhe po du me kriju një familje dhe më la. Fëmija me lot në sy më tha nanë po na a nuk jemi familje me babin a?! Mu duk sikur mu shemb toka nën këmbë.” –pohoi një ndër të intervistuarat. Ky ishte një rast tjetër i dhimbshëm i shkurorëzimit.*

<sup>180</sup> Marina J. Komar Slobodan Panov , vep. e cit, fq.88

*“Kemi qenë shumë të ri kur jemi martuar dhe në fillimet e martesës çdo gjë shkonte mirë derisa filluan problemet e para si çdo çdo çift që ka probleme por ne nuk mund ti zgjidhnim asesi sepse burri nuk më linte as të flas as të shpreh mendimin tim thoshte se un jam rob dhe se duhet vetëm të punoj të fshi të laj dhe të mos përzihem në asgjë thjesht sikur të mos kem gojë, nuk më linte as të flas ,as të shprehi mendimin deri në fund e lërë më të vendos në lidhje me diçka , thoshte se burri duhej të komandoj të sundoj në shtëpi ndërsa gruaja duhet vetëm të punojë dhe asgjë tjetër.Në fillim e durojsha nuk bëja zë sepse nuk doja të krijoja zënka pasi jetonin edhe me vjehrria nuk doja që edhe ata ta dinin dhe të ndiheshin keq sepse me ata kam pasur një raport shumë të mirë më kanë konsideruar si bijën e tyre mundohesha i thosha duhe të bisedojmë vetëm ti sqarojmë disa gjërë po nuk më dëgjonte , kalonte shumë kohë jashtë shtëpisë, durova derisa filloi edhe me dhunë nuk më linte as gojën me hap akoma pa fol un ma mëshonte , nuk më rrihte aq shumë por për mua mjaftonte një shuplakë apo një shkulje flokësh që të më mbyste psikikisht nuk mundesha mu pajtu me atë gjendje si ka mundsia që njeri mos me pas të drejtën e fjalës dhe lirisë së shprehjes, e durojsha ashtu derisa e pash se ai nuk ka për të ndryshu sepse dhunën ai e mori shprehi iu bë shprehi të më dhunonte edhe ndoshta pse nuk kisha fëmijë e pata pakëz më të lehtë të vendosja për shkurorëzim.” -tha njëra ndër të shkurorëzuarat.*

**5)shkurorëzimi për letra** – kjo dukuri është e njohur në komunën tonë kur burri shkurorëzohet nga gruaja e tij me qëllim që të shkojë në perëndim dhe të lidhë atje martesë fiktive vetëm për ti fituar letrat.Kjo është e lidhur ngushtë më gjendjen ekonomike me varfërinë pasi njëherë që e bëjnë këtë gjë zakonisht e kanë gjendjen e vështirë ekonomike dhe me qëllim të përmirësimit të gjendjes shkurorëzohen nga gratë për ti fituar letrat në perëndim që të punojnë atje dhe me qëllim që pas fitimit të letrave të shkurorëzohen dhe të marrin pastaj atje me vete ish gruan dhe fëmijët nëse kanë.Kjo gjë shihet edhe të intervistat e realizuara me të shkurorëzuarit nga gjithsej njëzetë raste tre prej tyre kanë qenë shkurorëzime të tilla.

*“ Un jetoj në perëndim jam me letra, ndërsa ish burri jo.U martuam dhe pas martesës kuptohet e mora në perëndim dhe filluam jetën së bashku.Në fillim çdo gjë dukej shkëlqyeshëm ishte i dashur i sjellshëm i butë punonte derisa një ditë hapa Facebook- un e tij dhe zbulova të vërtetën e hidhur.Burri kishte pasur të dashur para meje dhe kishin planifikuar çdo gjë bashkë që të martohej me mu vetëm sa për letra ,dmth derisa ti fitonte ai letrat dhe pastaj do të divorcohej prej meje dhe do të martohej me të.Për fat të mirë nuk i kishim 6,7 muaj martesë edhe fëmijë nuk kishim dhe mënjëherë me të marrë vesh të vërtetën ndahem nga ai”- ka thënë kështu një e intervistuar.*

*“Unë dhe ish burri për shkak të gjendjes së keqe ekonomike vendosëm bashkarisht të shkurorëzoheshim me marrëveshje me qëllim që ai të shkonte në perëndim të kurorëzohej me ndokënd vetëm sa për letra.Pasi ti fitonte letrat të shkurorëzohej dhe pastaj të më merrte edhe mua me vete.Por nuk ndodhi kështu , u shkurorëzuam , burri shkoi në perëndim u martua.Filloi dal nga dalë ti rrallontë telefonatat nuk më merrte shpesh ,dhe pas ca vitesh un kuptoj se ai kishte krijuar edhe familje me të se kishte edhe fëmijë.Kur e kuptova këtë gjë u bëra shumë keq u mundova ta kontaktoja por kot ai thotë se nuk do ta linte.Dhe këtu u binda se ishte më të vërtetë fundi nga shkurorëzimi për letra u bë shkurorëzim i vërtetë”-tha njëra ndër të shkurorëzuarat e intervistuar.*

*“Pas një viti martesë burri përkundër dëshirës timë vendosi të shkojë në Gjermani të punojë dhe mua më la.Vie në pushim veror dhe më thotë se duhet të shkurorëzohemi për shkak se ai do të lidhi martesë fiktive atje vetëm sa më i marrë letrat , më premtoi se pasi ti bënte letrat do më merrte edhe mua me veti.Un pranova u shkurorëzuam.Ai lidhi martesë të re atje por pas një kohe*

*dashurohet me të dhe më njofton se nuk do të shkuroëzohet dhe se jam e lirë “ – flet njëra ndër të shkurorëzuarat.*

6)***martesat me shkuesi*** – dy raste nga të intervistuarit ishin martesat të shkurorëzuara që ishin kurorëzuar me shkuesi që flet se në komunën tonë akoma disa martesat lidhen me shkuesi apo mësit siç u themi në gjuhën popullore.

*“Ne me ish gruan ishim njoftuar me mësit dhe shumë shpejt brenda dy javësh kemi vendosur të martohemi. Nuk e kemi njoft sa duhet njëri tjetrin edhe si pasojë pas fillimit të jetës së përbashkët e kemi parë se nuk jemi për njëri tjetrin dhe kemi vendos akoma pa bërë një vjet martesë të shkurorëzohemi” – kështu më tha një i intervistuar tjetër.*

*“Unë dhe burri jemi martu me mësit ,nuk e kemi njoft njëri tjetrin para martesës , vetëm jemi parë dy tre herë,duhej të vendosnim shpejt sepse burri shkonte pas dy jave kthehej në përendim kur jetonte dhe vepronte. Vendosëm të fejohehim menjëherë ndërsa verës u martuam. Përkundër faktit se mësit na kishte siguruar se jemi për njëri tjetrin të përshtatshëm dhe ashtu na u dukte edhe neve në fillim rezultoi që sishim për njëri tjetrin, ishim dy njëzëz me botëkuptime të kundërta, mentalitete të kundërta dhe nuk kishim shumë gjëra të përbashkëta dhe vendosëm së bashku që shkurorëzimi ishte zgjidhja më e mirë, nuk jemi ndarë armiqësisht përkundrazi në mënyrë paqësore jemi ndarë “- ka thënë kështu një e shkurorëzuar.*

7)***mospasja e fëmijëve*** – poashtu është një ndër shkaqet e shkurorëzimit. Njëri rast nga të shkurorëzuarit që kam intervistuar kishte të bënte pikërisht me këtë pra me mospasjen e fëmijëve si shkak të shkurorëzimit.

*“Arsyja pse jemi divorcu me ish bashkëshortën ka qenë ajo se skemi pas fëmi. Ajo vuante shumë edhe un poashtu aq shumë dëshironin fëmijë sa që filluam edhe ziheshim me të madhe shpesh herë akuzonin njëri tjetrin për mospasjen e fëmijëve. Në fund un vendosa që më së miri ishte të shkurorëzoheshim i thash asaj për vendimin edhe ajo pranoi të shkurorëzoheshim me marrëveshje” – flet kështu njëri ndër të shkurorëzuarit e intervistuar.*

8)***gjendja ekonomike*** - poashtu paraqitet si shkak i shkurorëzimit. Dihet se gjendja ekonomike ndikon edhe në jetën bashkëshortore të çiftit. Këtë e dëshmon edhe një rast nga të intervistuarit. *“Tek na ka ndikuar shumë gjendja ekonomike pasi kishim shumë probleme shumë debate për lamje kryesisht për këtë shkak. Ishim në gjendje jo të mirë ekonomike andaj nuk mund të bënim edhe një jetë siç duhej kjo ndikonte në disponimin tonë në çdo gjë. Ziheshim shumë gati çdo ditë sa që edhe jetesa e përbashkët më nuk mund të vazhdonte dhe vendosëm të shkurorëzoheshim” – ka thënë njëri ndër të shkurorëzuarit.*

9)***mospërshtatje e mentaliteteve*** – është një shkak tjetër i shkurorëzimit pohon një i shkurorëzuar tjetër ku thotë: *“Jam ndarë nga gruaja sepse kishim mentalitete të kundërta. Ziheshim gati për çdo gjë, ajo preferonte shumë me dal , më shumë i rrihej në kafe restauranta se në shpi, nuk kishte shumë dëshirë të gatuate , kalonte shumë kohë me shoqe, i neglizhonte obligimet e saj si bashkëshorte si e martuar , kam provu ti flas se nuk kalohet kështu jeta dhe se duhet të jetë më e pjekur i flisja shumë por nuk pata sukses sepse ajo bënte edhe gjëra kundër dëshirës timë , nuk i bindej fjalës timë dhe vendosa të shkurorëzohem me të”.*

10)***jeta e shturur*** – poashtu është ndër shkaktarët e shkurorëzimit. Askush nuk do të donte të ishte në një martesë me një njeri të tillë. Njëra ndër të intervistuarat tha :*“Arsyja pse u ndava nga ish bashkëshorti ishte se ai bënte një jetë të shturur. Un isha tërë kohës vetëm. Ai bënte një jetë beqari edhe pse ishte i martuar ndërsa un bëja një jetë sikur më qenë e vejë. Nuk e di as çka bënte as nuk tregonte ku shkonte tërë ditën tërë natën nuk ishte , më shumë nuk ishte në shtëpi se që ishte, edhe nuk guxoja as me pyet se ku ka qenë pasi thoshte se un jam burri un shkoj ku të dua unë nuk të jap ty llogari, më shantë më ofendonte thoshte se burri nuk duhet me i dhënë raport*

gruas.Ndërsa mua më kishte izoluar, mezi më linte ndonjëherë të shkoja ti vizitoja prindërit.Pastaj zbulova nga telefoni i tij se kontaktonte me vajza tjera.Kjo edhe më bëri të jem edhe më e vendosur dhe të shkurorëzohem nga ai”.

11)**xhelozia e tepruar** – të gjithë ne xhelozojmë nga pak partnerët tanë por kur xhelozohet në masë të madhe atëherë ajo bëhet problem.Xhelozia është bërë shkak për shkurorëzimin e saj thotë njëra ndër të shkuroëzuarat:”Para martesës nuk ka qenë shumë xheloz,por pas martesës filluan problemet tona.Ish burri ishte tepër xheloz , kishte një xheloz të sëmurë.Pas martesës un isha sikur në burg shtëpiak.Kur dilnim ndonjëherë rrallë nuk guxoja as të shikoj sh lirë as një fëmi apo natyrën sepse bëhej menjëherë xheloz në ndonjë kalimtar të rastit që un ndonjëherë as nuk e shifja as nuk e dija se për çfarë apo kënd e kishte fjalën.Aq xheloz i sëmur ishte sa i xhelozonte edhe të afërmit e tij meshkuj.Nuk më linte të përshëndetesh as me të afërmit e mi nëse rastësisht i takoja.Nuk më linte të dal pa të vetëm më të dhe duhesha të mbaj shikimin poshtë për ti shmangur konfliktet.Me shoqe të shoqërohesh apo të dilja as që bëhej fjalë.Edhe në shtëpi të prindërve shumë rrallë shkoja edhe atëherë kur shkoja më thërristë vazhdimisht në telefon nuk guxoja asnjëherë të më ndodhte mos tia hap telefoin edhe nëse isha nxan duhesha me patjetër tia hap telefonin, çka është më tragjikja nga gjithë kjo histori ishte se ndonjëherë kërkonte nga unë që tia hap telefonin dhe të ndëgjonte ai se me kë jam apo çfarë po bisedojmë te familja ime.Nuk mundesha më edhe vendosa të shkurorëzohem”.

12)**mungesa e komunikimit** – është gjithashtu një shkak i shkurorëzimit.Këtë gjë e dshëmon edhe njëra ndër të intervistuarat e cila thotë: “Te unë ka qenë mungesa e komunikimit.I kemi neglizhu problemet , shpesh injoronim njëri tjetrin nuk flisnim mes veti derisa një ditë e pamë se ishim bërë të huaj për njëri tjetrin.Nuk ka pas tradhëti nga asnjëra palë, thjesht më kalimin e kohës jemi largu jemi ftof nga njëri tjetri, ka humb dashuria intimiteti.Nuk kishim më gjëra të përbashkët, u krijua një distancë shumë e madhe mes nesh sa që as ne vet nuk dinim më çka apo si të vepronim.Vendosëm bashkarisht të shkurorëzoheshim me marrëveshje dhe u ndamë si dy miq”.

13)**nënçmimi apo mosvlerësimi** – poashtu është shkak për shkurorëzim.Njëri ndër të intervistuarit tha :” Nënçmimi nga ana e ish bashkëshortës më ka shtyrë të shkurorëzohem.Ajo asnjëherë nuk më ka vlerësuar përkundrazi më nënçmonte çdo herë kjo për arsye se un nuk e kam pasur gjendjen ekonomike shumë të mirë, ajo ishte me letra dhe pasi jemi martu mi ka bërë edhe mua letrat.Por kjo nuk i jepte asaj të drejtë të më nënçmonte gjithmonë, shpesh edhe para të tjerëve.Sillej me mua jo si grua ndaj burrit por si të skllavopronare mendonte se për shkak se mi kishtë bërë letrat un do të duroja gjithçka.Poashtu shkak për tu fjalosur ishin edhe një pjesë nga rroga ime që punoja me mundin tim pse ua dërgoja familjes time në vendlindje.Nënçmimi filloi edhe nga anëtarët e familjes së saj të cilët ishin shumë afër nesh edhe aty fillova të mendoj më për shkurorëzimin sepse nuk mundesha më të duroj edhe u shkurorëzova”.

Poashtu edhe nga intevistat e realizuara me gjygtarët Tafush Ramadani dhe Iljaz Mustafa si dhe intervistën me avokatin Zijadin Azemi u mundova të mësoj cilat janë shkaqet që bashkëshortët i përmendin më së shumti në gjykatë për shkurorëzimin e tyre.

“Un nga përvoja ime do të thoja që gjendja e keqe ekonomike është shkaktari kryesor i shkurorëzimeve , pasi që një përçindje e madhe e shkurorëzimeve në komunën tonë janë fiktive , çiftet shkurorëzohen vetëm për rregullimin e dokumentacionit të shteteve perëndimore e këtu edhe fillojnë konfliktet, disa kthehen prap martohen me ish gruan që e kan lënë në vendlindje i marin dhe i marin me veti por ka edhe aso raste kur nga shkurorëzimi fiktiv vetëm për letr bëhet shkurorëzim njëmend.Edhe dhunën në familje e konsideroj si vrasësin kryesor të martesave shpesh çiftet i heshtin problemet i neglizhojnë për vite të tëra derisa vin në një pikë ku më

*smunden dot të vazhdojnë, më e mira do të kishte me qenë që të kërkonin ndihmë profesionale por dihet mentaliteti ynë që punët e mbrendshme të mbahen brenda mureve të shtëpisë dhe nuk duan të tjerët të marin vesh që kanë problem derisa ato bëhen tepër të mëdha që më nuk mund as ti fshehin. Edhe ndihmë profesionale nuk kërkojnë ose ato pak raste të rralla ndihmën e kërkojnë shumë vonë'' - u shpreh kështu Iljaz Mustafa gjyqtar në Gjykatën Themelore të Preshevës.*

*''Për mendimin tim shkaktar kryesor është mosnjohja mirë e karaktereve të bashkëshortëve që qon menjëherë pas martesës në prishjen e marrëdhënieve bashkëshortore. Poashtu edhe jotoleranca mes bashkëshortëve mendoj që është një ndër shkaktarët pasi të rinjët nuk janë shumë tolerant mes njëri tjetrit dhe si pasojë e kësaj lindin edhe konfliktet pasi nuk kanë shumë mirëkuptim tolerancë respekt edhe si pasojë me akumulimin e përditshëm të problemeve vjen deri të shkurorëzimi. Shpesh ka tensione , fyerje , bile edhe kërcënimë mes çiftit. Ka të atillë që edhe pas shkurorëzimit vazhdojnë me marrëdhënie të këqija e probleme gjë që nuk aspak e mirë sidomos kur kanë fëmijë të përbashkët''- tha kështu Tafush Ramadani gjyqtar në Gjykatën Themelore të Preshevës. Ai tregon një rast kur ka shpëtuar një martesë që kishin ardhur në gjykatë të shkurorëzoheshin. ''Ishin të rinj të dy bashkëshortët dhe gjatë seancës iu foli shumë gjatë për pasojat e shkurorëzimit ndaj fëmijës pasi kishin një fëmijë të përbashkët dhe thash të mendohen mirë e pastaj nëse donin të shkurorëzoheshin atëherë të vini prap. Për fat të mirë i dëgjuan këshillat e mia dhe nuk u shkurorëzuan dhe sot akoma janë bashkë gjë që më ka bërë të ndihem krenar si gjykatës por edhe në aspektin moral si njeri –vazhdoi kështu gjykatësi i nderuar.*

*''Nga përvoja ime si avokat mund të them se papjekuria e hyrjes në martesë është një ndër shkaktarët më të shpeshtë të shkurorëzimit në komunën tonë, pasi të rinjët hynë në martesë të papjekur pa qenë të gatshëm për obligimet që mbart martesë familja, nuk janë të gatshëm as për tu bërë prindër e tjerë. Poashtu shkurorëzime të shumta po kanë martesat që po lidhen me nguti apo shpejt e shpejt ku njëri nga bashkëshortët jeton këtu kurse tjetri në perëndim , zakonisht këto martesë po bëhen me mblesëri , nuk po ka afeksion apo ndjenja për partnerin apo partneren por vetëm interes apo për një jetë më të mirë në perëndim, dhe menjëherë pas martesës po lindin problemet dhe si pasojë po përfundojnë me shkurorëzim'' u shpreh kështu Zijadin Azemi avokat. Këto janë disa nga shkaqet e shkurorëzimit në Komunën e Preshevës ,natyrisht mund të ketë edhe të tjera por nga të gjitha shkurorëzimet për periudhën 2010-2015 këto i hasim më së shumti.*



## 5.2.Shkurorëzimi në vitin 2010

Të dhënat që do ti paraqes në vazhdim janë të gjitha rezultat i një punë të gjatë të studimit të të gjitha rasteve të shkurorëzimit të grumbulluara nga unë në Ofiçarinë e Komunës së Preshevës, Gjakata Themelore e Preshevës dhe Qendra për punë Sociale e Komunës së Preshevës. Në bazë të këtyre studimeve në Komunën e Preshevës në vitin 2010 ka pasur gjithsej nëntëdhjetë e pesë (95) raste të shkurorëzimit. Prej tyre dymbëdhjetë raste kanë qenë shkurorëzime me element të huaj ndërsa tetëdhjetë e tre raste kanë shkurorëzime të vendit.

Tabela 1 - të dhënat e grumbulluara në Ofiçarinë e Komunës së Preshevës

| Numri i shkurorëzimeve Preshevë 2010 | Nr.i shkurorëzimeve të vendit | Nr.i shkurorëzimeve me element të huaj |
|--------------------------------------|-------------------------------|--|
| 95                                   | 83                            | 12                                     |

Më ka interesuar edhe numri i martesave të shkurorëzuara me fëmijë dhe pa fëmijë dhe sa i përket kësaj në bazë të të dhënave rezulton se në vitin 2010 për fat të mirë nuk ka pasur shumë martesa të shkurorëzuara me fëmijë. Më shumë ka pasur shkurorëzime pa fëmijë me gjithsej 77 sosh apo 81% e shkurorëzimeve kanë qenë pa fëmijë. Ndërsa 18 ka qenë numri i çiftëve të shkurorëzuara me fëmijë në vitin 2010.

Tabela 2 – të dhënat e marra në OKP dhe QPS<sup>181</sup>

| Gjithsej shkurorëzime 2010 | Pa fëmijë | Me fëmijë |
|----------------------------|-----------|-----------|
| 95                         | 77        | 18        |

Tabela 3 – të dhënat që kam nxjerrë në përfundim në bazë të grumbullimit të të dhënave në OKP DHE QPS

| Nr.i fëmijëve të çiftëve të shkurorëzuar | 0  | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | më tepër se 5 fëmijë |
|--|----|---|---|---|---|---|----------------------|
| <b>Nr.i shkurorëzimeve</b>               | 77 | 3 | 7 | 4 | 3 | 1 | 0                    |

Në bazë të tabelës mund të shihet edhe numri i martesave të shkurorëzuara me fëmijë dhe pa fëmijë si dhe nga sa fëmijë kanë pasur çiftet e shkurorëzuara në Komunën e Preshevës në vitin 2010. Tre çiftet e shkurorëzuara kanë pasur nga një fëmijë, shtatë çiftet e shkurorëzuara nga dy fëmijë, me nga tre fëmijë kanë qenë katër çiftet e shkurorëzuara, me nga katër fëmijë kanë qenë tre çiftet, me pesë fëmijë ka qenë vetëm një çift i shkurorëzuar në vitin 2010, ndërsa me më tepër se pesë fëmijë nuk ka pasur asnjë rast.

<sup>181</sup> Zyra e Ofiçarisë së Komunës së Preshevës OKP dhe Qendra për punë Sociale QPS

Tabela 4 – të dhënat e nxjerra nga material i grumbulluar në OKP

| Kohëzgjatja e martesës së shkurorëzuar | 0 | 1  | 2  | 3  | 4  | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 40 |
|--|---|----|----|----|----|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Nr.i martesave të shkurorëzuara        | 2 | 15 | 15 | 13 | 12 | 4 | 7 | 5 | 1 | 0 | 3  | 1  | 2  | 0  | 3  | 2  | 3  | 0  | 2  | 1  | 0  | 1  | 2  | 1  |

Nga kjo tabelë mund të shohim se sa kanë zgjatur martesat e shkurorëzuara në vitin 2010, dhe në bazë të kësaj mund të dalin në një përfundim se kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar në Komunë të Preshevës në vitin 2010 ishte 6 vite e gjysëm.

Tabela 5 – Në bazë të dhënave të marra nga QPS

| KUJDESTARIA E FËMIJËVE – 2010 |                           |                            |
|-------------------------------|---------------------------|----------------------------|
| Nr.i.shkur.me fëmi            | Kujdestaria i takon nënës | Kujdestaria i takon babait |
| 18                            | 13                        | 5                          |

Duke parë të dhënat mbi kujdestarinë e fëmijëve shohim se nga 18 raste sa kishte martesat të shkurorëzuara me fëmijë, trembëdhjetë prej tyre kujdestaria i ka takuar nënës, ndërsa pesë rasteve të çiftëve të shkurorëzuar kujdestaria i ka takuar babit. Nisur nga kjo mund të konkludojmë se 72% të rasteve të shkurorëzuara me fëmijë kujdestaria i takuar nënës që është një përqindje shumë e madhe në krahasim me kujdesarinë dhënë babait.

Tabela 6 - të dhënat e nxjerra nga materiali i grumbulluar në OKP

| Me padi |       | Me marrëveshje | Shkurorëzime total 2010 |
|---------|-------|----------------|-------------------------|
| Gruaja  | Burri |                |                         |
| 18      | 15    | 62             | 95                      |
| 33      |       |                |                         |

Poashtu kam menduar se është e nevojshme të dimë edhe sa shkurorëzime kanë qenë me marrëveshje dhe sa me padi. Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme në komunën tonë në vitin 2010, prej gjithsej 95 shkurorëzimeve 62 kanë qenë shkurorëzime me marrëveshje ndërsa 33 kanë qenë me padi. Prej tyre 18 shkurorëzime padinë e ka ngrit gruaja ndërsa 15 raste të tjera të shkurorëzimit padinë e ngrit burri. Pra në 2010-tën mbi 65% të shkurorëzimeve kanë qenë shkurorëzime me marrëveshje.

Tabela 7 - edhe këto të dhëna i kam grumbulluar në OKP

| <b>MOSHA E TË SHKURORËZUARVE</b> |               |              |
|----------------------------------|---------------|--------------|
| <b>VITET</b>                     | <b>GRUAJA</b> | <b>BURRI</b> |
| <b>16-19</b>                     | <b>3</b>      | <b>0</b>     |
| <b>20-24</b>                     | <b>30</b>     | <b>23</b>    |
| <b>25-29</b>                     | <b>27</b>     | <b>24</b>    |
| <b>30-34</b>                     | <b>14</b>     | <b>14</b>    |
| <b>35-39</b>                     | <b>7</b>      | <b>14</b>    |
| <b>40-44</b>                     | <b>6</b>      | <b>9</b>     |
| <b>45-49</b>                     | <b>5</b>      | <b>5</b>     |
| <b>50-54</b>                     | <b>2</b>      | <b>3</b>     |
| <b>55-59</b>                     | <b>0</b>      | <b>2</b>     |
| <b>60-64</b>                     | <b>0</b>      | <b>0</b>     |
| <b>65 e më shumë</b>             | <b>1</b>      | <b>1</b>     |

Në komunën tonë moshat e grave të shkurorëzuara në 2010-tën dominojnë moshat 20-24 me 30 gra të shkurorëzuara, pastaj vijnë ato të moshës 25-29 me gjithsej 27 të shkurorëzuara dhe pastaj gratë e moshës 30-34 me 14 gra të shkurorëzuara duke vazhduar kështu më rradhë 7 gra të 35-39, 6 gra të moshës 40-44, 5 gra të moshave 45-49, 3 gra të moshave 16-19, 2 gra të moshave 50-54, dhe një grua 66 vjeçare. Moshat më të reja për këtë vit apo gruaja më të reja të shkurorëzuara në 2010-tën ishin 19 vjet, ndërsa moshat e vjetra apo gruaja më të vjetra të shkurorëzuara ishin 66 vjet. Ndërsa sa i përket gjinisë tjetër burrave në 2010-tën për burrat dominojnë ato të moshës 25-29 vjet me gjithsej 24 burra të shkurorëzuara të këtyre moshave, pastaj 23 burra të moshës 20-24 vjet, 14 të moshave 30-34, 14 gjithashtu të moshave 35-39, 9 burra të shkurorëzuara të moshave 40-44, 5 burra të moshave 45-49, 3 të moshave 50-54, 2 të moshës 55-59, dhe një burrë i moshës 68 vjeçare. Burri më i ri i shkurorëzuara në vitin 2010 ishte 21 vjeçar ndërsa më i vjetri 68 vjet. Moshat më të reja të gruas ishin 28 vjet ndërsa për burrin ishin 34 vjet.

### 5.3.Shkurorëzimi në vitin 2011

Në Komunën e Preshevës në vitin 2011 shkurorëzimi ka pësuar një rënie nga 95 sa ishte në vitin 2010 në 73 shkurorëzime .Prej tyre 63 janë të vendit ndërsa 10 shkurorëzime janë me element të huaj.

Tabela 1 - të dhënat e grumbulluara në Ofiçarinë e Komunës së Preshevës

| Numri i shkurorëzimeve Preshevë 2011 | Nr.i shkurorëzimeve të vendit | Nr.i shkurorëzimeve me element të huaj |
|--------------------------------------|-------------------------------|--|
| 73                                   | 63                            | 10                                     |

Nga këto shkurorëzime 47 prej tyre ishin çifte të shkurorëzuara pa fëmijë , ndërsa 26 prej tyre ishin shkurorëzime të çifteve me fëmijë.Nëse krahasojmë më përqindje na del diku rreth 64 % të shkurorëzuarve në vitin 2011 kanë qenë pa fëmijë.

Tabela 2 – të dhënat e marra në OKP dhe QPS<sup>182</sup>

| Gjithsej shkurorëzime 2011 | Pa fëmijë | Me fëmijë |
|----------------------------|-----------|-----------|
| 73                         | 47        | 26        |

Tabela 3 – të dhënat që kam nxjerrë në përfundim në bazë të grumbullimit të të të dhënave në OKP DHE QPS

| Nr.i fëmijëve të çifteve të shkurorëzuar | 0  | 1  | 2 | 3 | 4 | 5 | më tepër se 5 fëmijë |
|--|----|----|---|---|---|---|----------------------|
| Nr.i shkurorëzimeve                      | 47 | 11 | 8 | 4 | 3 | 0 | 0                    |

Në bazë të tabelës së mësipërme mund të shohim se nga sa fëmijë kanë pasur çiftet e shkurorëzuara .Në vitin 2011 , pa fëmijë kanë 47 çifte të shkurorëzuara, me nga një fëmijë kanë qenë 11 shkurorëzime , me nga dy fëmijë kanë qenë 8 shkurorëzime , me nga tre fëmijë katër shkurorëzime , ndërsa me katër , pesë e më tepër nuk ka pasur asnjë çift të shkurorëzuar.

<sup>182</sup> Zyra e Ofiçarisë së Komunës së Preshevës OKP dhe Qendra për punë Sociale QPS

Tabela 4 – të dhënat e nxjerra nga material i grumbulluar në OKP

| Kohëzgjatja e martesës së shkurorëzuar | 1 | 2  | 3  | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 23 | 26 |
|--|---|----|----|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Nr.i martesave të shkurorëzuara        | 5 | 11 | 12 | 6 | 6 | 5 | 1 | 3 | 0 | 1  | 3  | 4  | 3  | 2  | 2  | 0  | 1  | 2  | 1  | 2  | 1  | 1  | 1  |

Këtu mund të shohim se nga sa vite kanë zgjatur martesat e shkurorëzuara në vitin 2011 dhe në bazë të kësaj mund të konstatojmë se kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar në vitin 2011 ishte 7 vite gjysëm.

Tabela 5 – Në bazë të dhënave të marra nga QPS

| KUJDESTARIA E FËMIJËVE – 2011 |                           |                            |
|-------------------------------|---------------------------|----------------------------|
| Nr.i.shkur.me fëmi            | Kujdestaria i takon nënës | Kujdestaria i takon babait |
| 26                            | 17                        | 9                          |

Në vitin 2011 nga gjithsej 26 shkurorëzime sa kishte me fëmijë prej këtyre njëzet e gjashtëve 17 prej tyre kujdestaria iu ka takuar nënave, ndërsa nëntë prej tyre kujdestaria iu ka takuar baballarëve.

Tabela 6 - të dhënat e nxjerra nga materiali i grumbulluar në OKP

| Me padi |       | Me marrëveshje | Shkurorëzime total 2011 |
|---------|-------|----------------|-------------------------|
| Gruaja  | Burri |                |                         |
| 13      | 8     | 52             | 73                      |
| 21      |       |                |                         |

Siç edhe po shihet nga tabela nga gjithsej 73 shkurorëzime 52 prej tyre kanë qenë shkurorëzime me marrëveshje ndërsa 21 me padi. Prej këtyre 21 të inicuar me padi në 13 raste shkurorëzimin e ka inicuar gruaja ndërsa 8 raste inicimin e ka bërë burri.

Tabela 7 - edhe këto të dhëna i kam grumbulluar në OKP

| <b>MOSHA E TË SHKURORËZUARVE 2011</b> |               |              |
|---------------------------------------|---------------|--------------|
| <b>VITET</b>                          | <b>GRUAJA</b> | <b>BURRI</b> |
| <b>16-19</b>                          | <b>2</b>      | <b>0</b>     |
| <b>20-24</b>                          | <b>8</b>      | <b>5</b>     |
| <b>25-29</b>                          | <b>24</b>     | <b>17</b>    |
| <b>30-34</b>                          | <b>14</b>     | <b>15</b>    |
| <b>35-39</b>                          | <b>10</b>     | <b>12</b>    |
| <b>40-44</b>                          | <b>9</b>      | <b>7</b>     |
| <b>45-49</b>                          | <b>6</b>      | <b>9</b>     |
| <b>50-54</b>                          | <b>0</b>      | <b>4</b>     |
| <b>55-59</b>                          | <b>0</b>      | <b>3</b>     |
| <b>60-64</b>                          | <b>0</b>      | <b>1</b>     |
| <b>65 e më shumë</b>                  | <b>0</b>      | <b>0</b>     |

Në komunën tonë në vitin 2011 sa i përket moshës së të shkurorëzuarve , për gratë kanë dominuar moshat nga 25-29 vjet me gjithsej 24 raste duke vazhduar me ato të moshës 30-34 vjet me 14 raste, ato 40-44 me 9 raste , 20-24 kishte tetë raste të shkurorëzimeve , 6 raste të moshës 45-49 dhe të moshave 16-19 kishte vetëm dy raste.Sa i takon moshës së burrave të shkurorëzuar në 2011-tën dominojnë ata të moshave 25-29 vjet me gjithsej 17 shkurorëzim duke vazhduar me ata të moshave 30-34 me 15 raste shkurorëzimesh, 35-39 dymbëdhjetë shkurorëzime , 9 raste shkurorëzimesh të moshave 45-49 vjet , pesë raste të moshave 20-24 vjet , të moshave 50-54 katër raste të shkurorëzimeve ,tre raste të moshave 55-59 vjet si dhe një rast i moshës 64 vjeçare.Mosha mesatare e gruas në vitin 2011 ishte 32 vite ndërsa për burrin ishte 40 vjet.

## 5.4.Shkurorëzimi në vitin 2012

Viti 2012 shënoi poashtu rënie të numrit të shkurorëzimit nga 73 sa kishte vitin e kaluar ne 65 që është një gjë positive për komunën tonë.Nga gjithsej 65 shkurorëzime 53 ishin të vendit ndërsa 12 ishin me element të huaj.

Tabela 1 - të dhënat e grumbulluara në Ofiçarinë e Komunës së Preshevës

| Numri i shkurorëzimeve Preshevë 2012 | Nr.i shkurorëzimeve të vendit | Nr.i shkurorëzimeve me element të huaj |
|--------------------------------------|-------------------------------|--|
| <b>65</b>                            | <b>53</b>                     | <b>12</b>                              |

Tabela 2 – të dhënat e marra në OKP dhe QPS<sup>183</sup>

| Gjithsej shkurorëzime 2012 | Pa fëmi   | Me fëmi   |
|----------------------------|-----------|-----------|
| <b>65</b>                  | <b>49</b> | <b>16</b> |

Nga këto shkurorëzime 49 çifte të shkurorëzuara ishin pa fëmi ndërsa 16 ishin me fëmijë.Apo thënë ndryshe 75 % e të të shkurorëzuarve ishin pa fëmijë pjesa tjetër më fëmijë.

Tabela 3 – të dhënat që kam nxjerrë në përfundim në bazë të grumbullimit të të të dhënave në OKP DHE QPS

| Nr.i fëmijëve të çifteve të shkurorëzuar | 0         | 1        | 2        | 3        | 4        | 5        | më tepër se 5 fëmijë |
|--|-----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------------------|
| <b>Nr.i shkurorëzimeve</b>               | <b>49</b> | <b>6</b> | <b>5</b> | <b>2</b> | <b>3</b> | <b>0</b> | <b>0</b>             |

Sa iu përket numrit të fëmijëve në vitin 2012 me nga një fëmijë ishin gjashtë shkurorëzime, me nga dy fëmijë pesë çifte të shkurorëzuara , me nga tre fëmijë dy shkurorëzime , me katër fëmijë ishin tre shkurorëzime ndërsa me pesë e më tepër nuk kishte asnjë rast të shkurorëzimit.

<sup>183</sup> Zyra e Ofiçarisë së Komunës së Preshevës OKP dhe Qendra për punë Sociale QPS

Tabela 4 – të dhënat e nxjerra nga material i grumbulluar në OKP

| Kohëzgjatja e martesës së shkurorëzuar | 1  | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 12 | 16 | 17 | 22 | 23 | 26 | 27 | 30 | 32 | 33 |
|--|----|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Nr.i martesave të shkurorëzuara        | 17 | 7 | 4 | 6 | 5 | 5 | 3 | 3 | 1 | 0  | 3  | 2  | 1  | 2  | 1  | 1  | 1  | 1  | 1  | 1  |

Në këtë tabelë janë të paraqitura kohëzgjatjet e martesave të shkurorëzuara në vitin 2012. Siç shihet më së shumti shkurorëzime kishte me një vit martesë, duke vazhduar me ato nga dy vite martesë me shtatë raste shkurorëzimesh dhe atyre nga katër vite martesë gjashtë raste e kështu me rradhë. Kohëzgjatja e martesës për vitin 2012 ishte shtatë vite martesë.

Tabela 5 – Në bazë të dhënave të marra nga QPS

| KUJDESTARIA E FËMIJËVE – 2012 |                           |                            |
|-------------------------------|---------------------------|----------------------------|
| Nr.i.shkur.me fëmi            | Kujdestaria i takon nënës | Kujdestaria i takon babait |
| 16                            | 11                        | 5                          |

Kujdestaria në vitin 2012 sikur edhe vitet tjera më së shumti iu ka takuar nënës me gjithsej 11 nga 16 raste shkurorëzimi me fëmijë, ndërsa babait i ka takuar kujdestari në pesë raste.

Tabela 6 - të dhënat e nxjerra nga materiali i grumbulluar në OKP

| Me padi |       | Me marrëveshje | Shkurorëzime total 2012 |
|---------|-------|----------------|-------------------------|
| Gruaja  | Burri |                |                         |
| 14      | 8     | 43             | 65                      |
| 22      |       |                |                         |

Në vitin 2012 nga 65 raste shkurorëzimi dyzet e tre apo 66 % ishin shkurorëzime me marrëveshje ndërsa 22 ishin me padi. Nga këto 22 të inicuar me padi 14 raste kishte inicuar shkurorëzimin gruaja ndërsa 8 raste burri.



Tabela 7 - edhe këto të dhëna i kam grumbulluar në OKP

| <b>MOSHA E TË SHKURORËZUARVE 2012</b> |               |              |
|---------------------------------------|---------------|--------------|
| <b>VITET</b>                          | <b>GRUAJA</b> | <b>BURRI</b> |
| <b>16-19</b>                          | <b>1</b>      | <b>0</b>     |
| <b>20-24</b>                          | <b>21</b>     | <b>6</b>     |
| <b>25-29</b>                          | <b>22</b>     | <b>21</b>    |
| <b>30-34</b>                          | <b>5</b>      | <b>15</b>    |
| <b>35-39</b>                          | <b>3</b>      | <b>6</b>     |
| <b>40-44</b>                          | <b>7</b>      | <b>6</b>     |
| <b>45-49</b>                          | <b>3</b>      | <b>4</b>     |
| <b>50-54</b>                          | <b>2</b>      | <b>5</b>     |
| <b>55-59</b>                          | <b>1</b>      | <b>1</b>     |
| <b>60-64</b>                          | <b>0</b>      | <b>0</b>     |
| <b>65 e më shumë</b>                  | <b>0</b>      | <b>1</b>     |

Mosha e të shkurorëzuarve në vitin 2012 shihet në këtë tabelë. Për këtë vit kanë dominuar nga gratë moshat 25-29 vjet ndërsa nga burrat poashtu ata të moshës 25-29 vjet. Mosha mesatare e gruas ishte 30 vjet ndërsa mosha mesatare e burrit ishte 33 vjet.

## 5.5.Shkurorezimi në vitin 2013

Në vitin 2013 ka pësuar një rënie të konsiderueshme të numrit të shkurorezimeve në Komunën e Preshevës. Për këtë vit ka pasur gjithsej 43 shkurorezime prej të cilave 10 kanë qenë me element të huaj.

Tabela 1 - të dhënat e grumbulluara në Ofiçarinë e Komunës së Preshevës

| Numri i shkurorezimeve Preshevë 2013 | Nr.i shkurorezimeve të vendit | Nr.i shkurorezimeve me element të huaj |
|--------------------------------------|-------------------------------|--|
| 43                                   | 33                            | 10                                     |

Nga këto 43 shkurorezime njëzet e shtatë kanë qenë çifte të shkurorezuara pa fëmijë ndërsa gjashtëmbëdhjetë ishin më fëmijë.

Tabela 2 – të dhënat e marra në OKP dhe QPS<sup>184</sup>

| Gjithsej shkurorezime 2013 | Pa fëmi | Me fëmi |
|----------------------------|---------|---------|
| 43                         | 27      | 16      |

Tabela 3 – të dhënat që kam nxjerrë në përfundim në bazë të grumbullimit të të të dhënave në OKP DHE QPS

| Nr.i fëmijëve të çifteve të shkurorezuar | 0  | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | më tepër se 5 fëmijë |
|--|----|---|---|---|---|---|----------------------|
| Nr.i shkurorezimeve                      | 27 | 8 | 5 | 2 | 0 | 1 | 0                    |

Sa i përket asaj se nga sa fëmijë i kanë pasur çiftet e shkurorezuara në vitin 2013 shifen qartë nga tabela , 8 shkurorezime me nga një fëmijë , pesë shkurorezime me nga dy fëmijë, dy shkurorezime me nga tre fëmijë, me nga katër nuk kishte ndërsa me pesë fëmijë kishte një rast shkurorezimi.

<sup>184</sup> Zyra e Ofiçarisë së Komunës së Preshevës OKP dhe Qendra për punë Sociale QPS

Tabela 4 – të dhënat e nxjerra nga material i grumbulluar në OKP

| Kohëzgjatja e martesës së shkurorëzuar | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 13 | 15 | 17 | 18 | 19 | 22 | 25 |
|--|---|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Nr.i martesave të shkurorëzuara        | 5 | 5 | 2 | 7 | 6 | 5 | 4 | 0 | 0 | 0  | 1  | 2  | 1  | 1  | 1  | 1  | 1  | 1  |

Në vitin 2013 ka pasur më së shumti martesë të shkurorëzuara me nga katër vite martesë me gjithsej shtatë raste duke pasur shkurorëzimet me nga një vit martesë me pesë raste shkurorëzimesh. Kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar në vitin 2013 ishte 6,7 vjet.

Tabela 5 – Në bazë të dhënave të marra nga QPS

| KUJDESTARIA E FËMIJËVE – 2013 |                           |                            |
|-------------------------------|---------------------------|----------------------------|
| Nr.i.shkur.me fëmi            | Kujdestaria i takon nënës | Kujdestaria i takon babait |
| 16                            | 11                        | 5                          |

Kujdestaria në vitin 2013 nga gjithsej 16 shkurorëzime me fëmijë në 11 raste i ka takuar nënës ndërsa babait vetëm 5 raste të shkurorëzimit i ka takuar kujdestaria e fëmijëve.

Tabela 6 - të dhënat e nxjerra nga materiali i grumbulluar në OKP

| Me padi |       | Me marrëveshje | Shkurorëzime total 2013 |
|---------|-------|----------------|-------------------------|
| Gruaja  | Burri |                |                         |
| 4       | 5     | 34             | 43                      |
| 9       |       |                |                         |

Në vitin 2013 prej 43 sa kishte gjithsej shkurorëzime 34 prej tyre ishin shkurorëzime me marrëveshje ndërsa nëntë prej tyre ishin të inicuar me padi. Nga këto të inicuarat me oadi katër raste kishte ngritur padi gruaja ndërsa në pesë raste burri e kishte inicuar procedurën e shkurorëzimit.

Tabela 7 - edhe këto të dhëna i kam grumbulluar në OKP

| <b>MOSHA E TË SHKURORËZUARVE 2013</b> |               |              |
|---------------------------------------|---------------|--------------|
| <b>VITET</b>                          | <b>GRUAJA</b> | <b>BURRI</b> |
| <b>16-19</b>                          | <b>0</b>      | <b>0</b>     |
| <b>20-24</b>                          | <b>9</b>      | <b>1</b>     |
| <b>25-29</b>                          | <b>13</b>     | <b>12</b>    |
| <b>30-34</b>                          | <b>10</b>     | <b>10</b>    |
| <b>35-39</b>                          | <b>10</b>     | <b>13</b>    |
| <b>40-44</b>                          | <b>0</b>      | <b>3</b>     |
| <b>45-49</b>                          | <b>1</b>      | <b>3</b>     |
| <b>50-54</b>                          | <b>0</b>      | <b>0</b>     |
| <b>55-59</b>                          | <b>0</b>      | <b>1</b>     |
| <b>60-64</b>                          | <b>0</b>      | <b>0</b>     |
| <b>65 e më shumë</b>                  | <b>0</b>      | <b>0</b>     |

Në këtë tabelë pasqyrohet mosha e të shkurorëzuarve për vitin 2013. Nga gratë dominojnë moshat nga 25-29 vjet ndërsa të burrat dominojnë ata të moshave 35-39 vjet. Mosha mesatare e gruas së shkurorëzuar në vitin 2013 ishte 30 vjet ndërsa për burrin mosha mesatare ishte 34 vjet.

## 5.6.Shkursorëzimi në vitin 2014

Shkursorëzimet për vitin 2014 nuk kanë ndonjë dallim shumë të madh sa i përket numrit nga viti i kaluar.Në komunën tonë për këtë vit ka pasur 44 shkursorëzime. Prej këtyrë 44 shkursorëzimeve 17 kanë qenë më element të huaj.

Tabela 1 - të dhënat e grumbulluara në Ofiçarinë e Komunës së Preshevës

| Numri i shkursorëzimeve Preshevë 2014 | Nr.i shkursorëzimeve të vendit | Nr.i shkursorëzimeve me element të huaj |
|---------------------------------------|--------------------------------|---|
| 44                                    | 27                             | 17                                      |

Nga 44 shkursorëzime sa kishte në 2014-tën , tridhjetë e pesë apo 79 % ishin pa fëmi ndërsa 9 raste shkursorëzimi me fëmijë.

Tabela 2 – të dhënat e marra në OKP dhe QPS<sup>185</sup>

| Gjithsej shkursorëzime 2014 | Pa fëmi | Me fëmi |
|-----------------------------|---------|---------|
| 44                          | 35      | 9       |

Tabela 3 – të dhënat që kam nxjerrë në përfundim në bazë të grumbullimit të të të dhënave në OKP DHE QPS

| Nr.i fëmijëve të çifteve të shkursorëzuar | 0  | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | më tepër se 5 fëmijë |
|---|----|---|---|---|---|---|----------------------|
| Nr.i shkursorëzimeve                      | 35 | 5 | 3 | 1 | 0 | 0 | 0                    |

Në vitin 2014 kishte pesë shkuroëzime me nga një fëmijë , tre raste me nga dy fëmijë , një rast më tre fëmijë ndërsa me katër fëmijë pesë e më tepër nuk kishte asnjë rast.

<sup>185</sup> Zyra e Ofiçarisë së Komunës së Preshevës OKP dhe Qendra për punë Sociale QPS

Tabela 4 – të dhënat e nxjerra nga material i grumbulluar në OKP

| Kohëzgjatja e martesës së shkurorëzuar | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 22 | 25 | 34 | 43 |
|--|---|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Nr.i martesave të shkurorëzuara        | 8 | 3 | 4 | 4 | 1 | 4 | 3 | 3 | 3 | 1  | 1  | 2  | 1  | 1  | 1  | 1  | 1  | 1  | 1  |

Në komunën tonë në vitin 2014 më së shumti pati shkurorëzime me nga një vit martesë me gjithsej tetë raste shkurorëzimesh. Kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar për këtë vit ishte 10 vite martesë.

Tabela 5 – Në bazë të dhënave të marra nga QPS

| KUJDESTARIA E FËMIJËVE – 2014 |                           |                            |
|-------------------------------|---------------------------|----------------------------|
| Nr.i.shkur.me fëmi            | Kujdestaria i takon nënës | Kujdestaria i takon babait |
| 9                             | 5                         | 4                          |

Kujdestarinë në vitin 2014 nga gjithsej 9 shkurorëzime me fëmijë , pesë raste i ka takuar nënës ndërsa babit katër raste të shkurorëzimit.

Tabela 6 - të dhënat e nxjerra nga materiali i grumbulluar në OKP

| Me padi |       | Me marrëveshje | Shkurorëzime total 2014 |
|---------|-------|----------------|-------------------------|
| Gruaja  | Burri |                |                         |
| 7       | 2     | 35             | 44                      |
| 9       |       |                |                         |

Në vitin 2014 nga 44 shkurorëzime në total , tridhjetë e pesë ishin me marrëveshje ndërsa nëntë ishin me padi. Nga shkurorëzimet e inicuar me padi shtatë raste e kishte inicuar gruaja ndërsa burri vetëm dy raste.

Tabela 7 - edhe këto të dhëna i kam grumbulluar në OKP

| <b>MOSHA E TË SHKURORËZUARVE 2014</b> |               |              |
|---------------------------------------|---------------|--------------|
| <b>VITET</b>                          | <b>GRUAJA</b> | <b>BURRI</b> |
| <b>16-19</b>                          | <b>0</b>      | <b>0</b>     |
| <b>20-24</b>                          | <b>13</b>     | <b>7</b>     |
| <b>25-29</b>                          | <b>9</b>      | <b>9</b>     |
| <b>30-34</b>                          | <b>8</b>      | <b>10</b>    |
| <b>35-39</b>                          | <b>5</b>      | <b>1</b>     |
| <b>40-44</b>                          | <b>6</b>      | <b>6</b>     |
| <b>45-49</b>                          | <b>1</b>      | <b>4</b>     |
| <b>50-54</b>                          | <b>1</b>      | <b>3</b>     |
| <b>55-59</b>                          | <b>0</b>      | <b>2</b>     |
| <b>60-64</b>                          | <b>0</b>      | <b>0</b>     |
| <b>65 e më shumë</b>                  | <b>1</b>      | <b>2</b>     |

Sa i përket moshës në vitin 2014 kanë dominuar nga gratë ato të moshës 20-24 vjet ndërsa nga burrat ata të moshës 30-34 vjet. Moshë mesatare e gruas së shkurorëzuar në vitin 2014 ishte 32 vjet ndërsa për burrin ishte 36 vjet.

## 5.7.Shkursorëzimi në vitin 2015

Shkursorëzimi në vitin 2015 ka shënuar një rritje në krahasim me vitin e kaluar prej 44 sa ishte në 64 për këtë vit.Nga këto 23 ishin shkursorëzime me element të huaj.

Tabela 1 - të dhënat e grumbulluara në Ofiçarinë e Komunës së Preshevës

| Numri i shkursorëzimeve Preshevë 2015 | Nr.i shkursorëzimeve të vendit | Nr.i shkursorëzimeve me element të huaj |
|---------------------------------------|--------------------------------|---|
| 64                                    | 41                             | 23                                      |

Nga këto shkursorëzime , dyzet e nëntë apo 76% ishin pa fëmijë ndërsa pesëmbëdhjetë ishin me fëmijë.

Tabela 2 – të dhënat e marra në OKP dhe QPS<sup>186</sup>

| Gjithsej shkursorëzime 2015 | Pa fëmi | Me fëmi |
|-----------------------------|---------|---------|
| 64                          | 49      | 15      |

Tabela 3 – të dhënat që kam nxjerrë në përfundim në bazë të grumbullimit të të të dhënave në OKP DHE QPS

| Nr.i fëmijëve të çifteve të shkursorëzuar | 0  | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | më tepër se 5 fëmijë |
|---|----|---|---|---|---|---|----------------------|
| Nr.i shkursorëzimeve                      | 49 | 7 | 7 | 1 | 0 | 0 | 0                    |

Në komunën e Preshevës për vitin 2015 kishte shtatë raste të shkursorëzimit me nga një fëmijë, shtatë poashtu me nga dy fëmijë, një rast me tre fëmijë ndërsa me katër asnjë, pesë apo më tepër fëmijë nuk kishte asnjë shkursorëzim.

Tabela 4 – të dhënat e nxjerra nga material i grumbulluar në OKP

| Kohëzgjatja e martesës së shkursorëzuar | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 15 | 16 | 17 | 20 | 21 | 22 | 23 | 25 | 36 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Nr.i martesave të shkursorëzuara        | 2 | 8 | 7 | 8 | 9 | 6 | 3 | 0 | 3 | 1  | 1  | 5  | 1  | 1  | 2  | 2  | 1  | 1  | 1  | 1  | 1  | 1  |

<sup>186</sup> Zyra e Ofiçarisë së Komunës së Preshevës OKP dhe Qendra për punë Sociale QPS



Sa i përket kohëzgjatjes së martesës së shkurorëzuar në vitin 2015 më së shumti çifte janë shkurorëzuar ato që kishin nga tre, katër dhe pesë vite. Kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar për vitin 2015 ishte 7,8 vite martesë.

Tabela 5 – Në bazë të dhënave të marra nga QPS

| <b>KUJDESTARIA E FËMIJËVE – 2015</b> |                                  |                                   |
|--------------------------------------|----------------------------------|-----------------------------------|
| <b>Nr.i.shkur.me fëmi</b>            | <b>Kujdestaria i takon nënës</b> | <b>Kujdestaria i takon babait</b> |
| <b>15</b>                            | <b>11</b>                        | <b>4</b>                          |

Kujdestaria në vitin 2015 më së shumti i ka takuar nënës me 11 raste nga 15 gjithsej sa kishte shkurorëzime me fëmijë, ndërsa babin i ka takuar kujdestaria me katër raste shkurorëzimi.

Tabela 6 - të dhënat e nxjerra nga materiali i grumbulluar në OKP

| <b>Me padi</b> |              | <b>Me marrëveshje</b> | <b>Shkurorëzime total 2015</b> |
|----------------|--------------|-----------------------|--------------------------------|
| <b>Gruaja</b>  | <b>Burri</b> |                       |                                |
| <b>8</b>       | <b>8</b>     | <b>48</b>             | <b>64</b>                      |
| <b>16</b>      |              |                       |                                |

Në këtë vit në komunën tonë nga 64 shkurorëzime gjithsej 48 raste apo 75% ishin shkurorëzime me marrëveshje ndërsa gjashtembëdhjetë ishin të inicuar me padi. Prej këyre me padi tetë raste ishin incuar nga ana e gruas dhe teta nga ana e burrit.


Tabela 7 - edhe këto të dhëna i kam grumbulluar në OKP

| <b>MOSHA E TË SHKURORËZUARVE 2015</b> |               |              |
|---------------------------------------|---------------|--------------|
| <b>VITET</b>                          | <b>GRUAJA</b> | <b>BURRI</b> |
| <b>16-19</b>                          | <b>0</b>      | <b>0</b>     |
| <b>20-24</b>                          | <b>16</b>     | <b>8</b>     |
| <b>25-29</b>                          | <b>12</b>     | <b>10</b>    |
| <b>30-34</b>                          | <b>14</b>     | <b>14</b>    |
| <b>35-39</b>                          | <b>5</b>      | <b>8</b>     |
| <b>40-44</b>                          | <b>11</b>     | <b>9</b>     |
| <b>45-49</b>                          | <b>3</b>      | <b>6</b>     |
| <b>50-54</b>                          | <b>1</b>      | <b>3</b>     |
| <b>55-59</b>                          | <b>1</b>      | <b>2</b>     |
| <b>60-64</b>                          | <b>0</b>      | <b>1</b>     |
| <b>65 e më shumë</b>                  | <b>1</b>      | <b>3</b>     |

Mosha e të shkurorëzuarve në vitin 2015 sa i përket grave më së shumti kishte të moshave 20-24 ndërsa sa iu përket burrave më së shumti pati të moshave 30-34. Mosha mesatare e gruas ishte 32 vjet ndërsa e burrit ishte 37 vjet.


Tani për të pasur një pasqyrim më të drejtë të shkurorëzimit në Komunën e Preshevës do ti paraqes të dhënat e të gjithave viteve me një tabelë të vetmë.

**Numri i shkurorëzimeve në Komunën e Preshevës për vitet 2010 - 2015**




Në vitin 2010 në Komunën e Preshevës ka patur më së shumti shkurorëzime gjithsej 95 shkurorëzime, në vitin 2011 kishte 73 shkurorëzime, 65 shkurorëzime gjithsej kishte në vitin 2012, në vitin 2013 kishte 43 shkurorëzime ndërsa në vitin 2014 pati 44 shkurorëzime dhe 64 shkurorëzim në vitin 2015 në Komunën e Preshevës.

**Numri i shkurorëzimeve me fëmijë dhe numri i shkurorëzimeve pa fëmijë i paraqitur në mënyrë tabelare për vitet përkatëse (2010-2015)**




Në vitin 2010 më shumë ka pasur shkurorëzime pa fëmi me gjithsej 77 sosh apo 81% e shkurorëzimeve kanë qenë pa fëmi. Ndërsa 18 ka qenë numri i çifteve të shkurorëzuara me fëmijë në vitin 2010. Në vitin 2011 nga 73 shkurorëzime sa ishin gjithsej 47 prej tyre ishin çifte të shkurorëzuara pa fëmijë, ndërsa 26 prej tyre ishin shkurorëzime të çifteve me fëmijë. Nëse krahasojmë më përqindje na del diku rreth 64 % të të shkurorëzuarve në vitin 2011 kanë qenë pa fëmijë. Në vitin 2012 nga gjithsej 65 shkurorëzime 49 çifte të shkurorëzuara ishin pa fëmi ndërsa 16 ishin me fëmijë. Apo thënë ndryshe 75 % e të të shkurorëzuarve ishin pa fëmijë pjesa tjetër më fëmijë. Në 2013- tën nga gjithsej 43 shkurorëzime sa kishte, njëzet e shtatë kanë qenë çifte të shkurorëzuara pa fëmijë ndërsa gjashtëmbëdhjetë ishin më fëmijë. Nga 44 shkurorëzime sa kishte në 2014-tën, tridhjetë e pesë apo 79 % ishin pa fëmi ndërsa 9 raste shkurorëzimi me fëmijë. Nga 64 shkurorëzime në vitin 2015, dyzet e nëntë apo 76% ishin pa fëmijë ndërsa pesëmbëdhjetë shkurorëzime ishin me fëmijë.

### Kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar 2010-2015




Kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar në vitin 2010 ka qenë 6 vite e gjysëm, në 2011 7 vite e gjysëm, në 2012-tën kohëzgjatja mesatare ishte 7 vite ,në 2013 6,7 vjet , në vitin 2014 ishte 10 vite ndërsa në vitin 2015 ishte 7,8 vjet.Që përkthyer ndryshe në periudhën 2010 – 2015 martesat në Komunën e Preshevës ka zgjatur përafërsisht 10 vite që është një shifër që tregon se çiftet preshevare nuk ndahen edhe aq kollaj sa në vendet tjera.

### Kujdestaria e fëmijëve për vitet përkatëse




Siç edhe shihet nga tabela e mësipërmë kujdestaria e fëmijëve te të gjitha vitet mbizotëron kujdestaria nënës që domethënë se fëmijët më së shumti i besohen nënave për rritje kujdes dhe edukim. Në vitin 2010 nga shkurorëzimet me fëmijë 72% e rasteve kujdestaria iu ka takuar nënës, në 2011-tën kjo përqindje ishte 65% nënës, në 2012tën 68%, 67% në 2013tën, 55% në 2014 dhe 73% në 2015 që është një shifër e konsiderueshme por jo edhe e habitshme pasi dihet që nënat mirrën më së shumti me rritjen edukimin e fëmijëve.

### Shkurorëzimet me marrëveshje dhe shkurorëzimet e inicuar me padi për vitet përkatëse



Lirisht mund të thëmi se çiftet preshevare shkurorëzohen më së shumti me marrëveshje. Në vitin 2010 mbi 65% e shkurorëzimeve kanë qenë me marrëveshje, në 2011-tën 71% me marrëveshje, në 2012-tën me marrëveshje ishin 66% e rasteve, në vitin 2013 79% me marrëveshje, në 2014-tën 78% kanë qenë me marrëveshje dhe në vitin 2015 mbi 75% e rasteve kanë qenë shkurorëzime me marrëveshje.

## Shkurorëzimet me padi – Inicimi i procedurës nga ana e gruas dhe inicimi nga ana e burrit 2010-2015



Kam konstatuar se në komunën tonë më shumti gratë i paditin burrat gjë që është një risi krahasuar me të kaluarën tonë, kjo gjë lidhet ngushtë me të drejtat më të mëdhaja që kanë gratë preshevere në ditët e sotme pasi në të kaluarën kanë qenë më të nënshtuara ndaj burrit ndërsa sot gëzojnë më shumë të drejtë kuptohet pasi arsimohen më shumë janë të punësuar më shumë dhe kanë mundësi ekonomike për të mbajtur veten dhe fëmijët. Në të gjitha vitet përqindja e grave ka qenë më e madhe në krahasim me paditë të inicuar nga burrat. Përveq në vitin 2015 ku kjo përqindje ka qenë e njëjtë 50% - 50%.

Në vitin 2010 rreth 54 % të rasteve të shkurorëzimit të inicuar me padi kanë qenë padi nga gratë, në 2011 61% e rasteve kanë qenë shkurorëzime të inicuar me padi nga ana e gruas, në 2012tën 63% gratë, pastaj në 2013 44% , në 2014tën 77% dhe në vitin 2015 50% e rasteve kanë qenë padi nga ana e gruas dhe 50 % nga ana e burrit.

Është interesant fakti sa i përket ndarjes së pasurisë në Komunën e Preshevës pothuajse në secilin rast të shkurorëzimit palët deklarorin se nuk kishin arritur pasuri të përbashkët dhe si pasojë e saj skishin as çfarë të ndanin, gjë që nuk është e vërtetë por kjo dëshmon pozitën më të lartë të burrit në krahasim me gruan sepse zakonisht dihet që pasuria që fitohet me punë të përbashkët prap i mbetet burri për shkak të mentalitetit patriarkal. Kishte disa raste që deklarorin se ndarjen do ta bënin jashta dyerve të gjykatës. Sa i përket alimentacionit zakonisht prindi që nuk e kishte kujdestarin paguante alimentacion natyrisht kur kishte mundësi për një gjë të tillë. Por në praktikë alimentacioni jo çdo herë jipej , edhe atëherë kur jipej nuk jipej me rregull nga ana e prindit tjetër.

Mund të konludojmë së shkurorëzimi në Komunën e Preshevës siç mund edhe të shifet nga statistikat nuk arrin shifra shumë të larta sidomos nëse e krahasojmë me vendet tjera- qytetet tjera komuna jonë qëndron shumë mirë bile i ka shifrat më të ulta së shumica e vendeve tjera në Serbi dhe më gjerë.

Kam konstatuar se nga viti 2010 deri në vitin 2013 ka pasur një rënie të numrit të shkurorëzimeve në komunën tonë përkundër hipotezës timë që ka rritje të konsiderueshme të numrit të shkurorëzimeve në komunën tonë. Nga viti 2013 – 2015 kemi një rritje të numrit të shkurorëzimit por prap nëse e krahasojme vitin 2015 që kishte 64 shkurorëzime me vitin 2010 ku kishte 95 shkurorëzime lirisht mund të themi se prap shkurorëzimi nuk ka shënuar një rritje shumë të madhe pra është një rritje shumë e vogël dhe jo e konsiderueshme.



## PËRFUNDIMI

Shkurorëzimi , kjo dukuri gjithnjë e në rritje, edhe pse konsiderohet si e drejtë e njeriut prap mbetet një problem që duhet studiuar e analizuar mirë pasi që ka pasoja të mëdha dhe jo vetëm për çiftin që shkurorëzohet por edhe për familjet e tyre si dhe në veçanti për fëmijet nëqoftëse kanë. Allahu xh.sh , divorcin edhe pse e ka lejuar nën kushte të caktuara prap mbetet ndër gjërat që Allahu i madhërishtëm urren.

Me zhvillimin e hovshëm të shoqërisë, zhvillimin e teknologjisë, ndryshimi i sistemit të vlerave, papunësia, varfëria, liritë më të mëdha të njeriut, të drejtat e grave ,rrjetët sociale janë vetëm disa nga shkaqet e ditëve të sotme që ndikojnë dukshëm në bashkësinë martesore dhe familjare në përgjithësi. Martesa dhe familja e kanë humbur rolin dhe rendësinë që kanë pasur dikur. Familja si celula më e rëndësishme dhe njëherit më delikate e shoqërisë nuk po shikohet më nga gjeneratat e reja si një gjë e shenjtë siç është parë dikur. Njeriu i ditëve të sotit është më tepër egoist dhe më shumë shikon të drejtat që ka duke anashkaluar detyrimet e tij. Njerëzit janë bërë më pak tolerant. Trendi i rritjes së shkurorëzimeve ka kapluar mbarë botën, e këtij trendi nuk ka mundur t'i iki as komuna e Preshevës.

Sipas rezultateve të nxjerra nga ky hulumtim shkaqet për shkurorëzim në Komunën e Preshevës janë nga më të ndryshmet.Por shkaqet kryesore apo më të shpeshta janë : mospërputhje e karaktereve , tradhëtia bashkëshortore , implikimet familjare apo përzjerja e anëtarëve të familjes në jetën e çiftit bashkëshortorë, gjendja ekonomike,dhuna, shkurorëzimi për letra, martesat me shkuesi , mospasja e fëmijëve ,jeta e natës,xhelozia e tepruar etj.

Në Komunën e Preshevës më shumti shkurorëzohen çiftet pa fëmijë , ku shumica e të shkurorëzuarve në periudhën 2010-2015 kanë qenë pa fëmijë , që dëshmon edhe njëherë se kur ka fëmijë në mes përpjekjet dhe sakrificat janë më të mëdha që të ruhet martesa.Në vitin 2010 rreth 81% e shkurorëzimeve kanë qenë pa fëmijë, në 2011 ishin 64% pa fëmijë, në vitin 2012 pa fëmijë ishin 75% e shkurorëzimeve, në 2013 ishin 63%, në 2014-tën ishin 79% pa fëmijë dhe në 2015-tën ishin 76% eshkurorëzimeve pa fëmijë.

Sa i përket numrit të shkurorëzimeve mbizotron viti 2010 me më së shumti shkurorëzime gjithsej 95 shkurorëzime,2011tën kishte 73, 2012-tën kishte 65 shkurorëzime, në 2014-tën kishte 44 shkurorëzime dhe në vitin 2015 ka pasur gjithsej 64 shkurorëzime.

Kohëzgjatja mesatare e martesës së shkurorëzuar në Komunën e Preshevës në vitin 2010 ka qenë 6 vite e gjysëm, në 2011 7 vite e gjysëm, në 2012-tën kohëzgjatja mesatare ishte 7 vite ,në 2013 6,7 vjet , në vitin 2014 ishte 10 vite ndërsa në vitin 2015 ishte 7,8 vjet.Që përthyer ndryshe në periudhën 2010 – 2015 martesa në Komunën e Preshevës ka zgjatur për afërsisht 10 vite që është një shifër që tregon se çiftet preshevarë nuk ndahen edhe aq kollaj sa në vendet tjera.

Kujdestaria e fëmijëve te të gjitha vitet mbizotëron kujdestaria e dhënë nënës që domethënë se fëmijët më së shumti i besohen nënave për rritje kujdes dhe edukim.Në vitin 2010 nga shkurorëzimet me fëmijë 72% e rasteve kujdestaria iu ka takuar nënës, në 2011-tën kjo përqindje ishte 65% nënës, në 2012tën 68%, 67% në 2013tën, 55% në 2014 dhe 73% në 2015 që është një shifër e konsiderueshme por jo edhe e habitshme pasi dihet që nënat mirrën më së shumti me rritjen edukimin e fëmijëve.

Lirisht mund të thëmi se çiftet preshevarë shkurorëzohen më së shumti me marrëveshje.Në vitin 2010 mbi 65% e shkurorëzimeve kanë qenë me marrëveshje , në 2011tën 71% me marrëveshje, në 2012tën me marrëveshje ishin 66% e rasteve, në vitin 2013 79% me

marrëveshje, në 2014-tën 78% kanë qenë me marrëveshje dhe në vitin 2015 mbi 75% e rasteve kanë qenë shkurorëzime me marrëveshje.

Kam konstatuar gjithashtu se në komunën tonë më së shumti gratë e inicojnë procedurën e shkurorëzimit pra më shumti gratë i padisin burrat. Në vitin 2010 rreth 54 % të rasteve të shkurorëzimit të inicuar me padi kanë qenë padi nga gratë, në 2011 61% e rasteve kanë qenë shkurorëzime të inicuar me padi nga ana e gruas, në 2012-tën 63% gratë, pastaj në 2013 44% , në 2014-tën 77% dhe në vitin 2015 50% e rasteve kanë qenë padi nga ana e gruas dhe 50 % nga ana e burrit.

Është vërtetuar hipoteza se mospërputhja e karaktereve të çiftit çon drejt shkurorëzimit. Duke u nisur nga shikimi dhe analizimi i rasteve të shkurorëzimit një shumicë e konsiderueshme e çifteve në gjykatë kishin dhënë si shkak të shkurorëzimit mospërputhjen e karaktereve apo karakteret e ndryshme dhe si pasojë e kësaj është bërë edhe jeta e tyre e padurueshme dhe janë shkurorëzuar. Poashtu edhe nga intervistat e realizuara nga ana ime me të shkurorëzuarit është konstatuar mospërputhja e karaktereve si shkak i shkurorëzimit. Avokati Zijadin Azemi si një ndër shkaqet dha mosnjohjen mirë të karaktereve. Edhe gjygtarët e intervistuar pohuan një gjë të tillë.

Edhe hipoteza e veçantë lidhur me atë se martesat e lidhura me shkuesi kanë më shumë gjasa të përfundojnë me shkurorëzim është vërtetuar nga intervistat me të shkurorëzuarit. Nga gjithsej njëzet persona të shkurorëzuar që kam intervistuar dy raste kanë qenë shkurorëzime ku të shkurorëzuarit kanë fajësuar mësitin. Të intervistuarit kanë pohuar se janë martuar me mblesëri dhe se kanë njoft mirë partnerin apo nuk kanë pasur shumë kohë për tu njoftuar mirë partnerin para martesës pra janë ngutur dhe janë martuar shume shpejt. Edhe avokati Zijadin Azemi si shkak për shkurorëzim dha martesat e lidhura me nguti pa u njoft mirë bashkëshortët mes veti dhe se zakonisht këto martesat janë martesat të bëra me mblesëri dhe në të cilat martesat nuk ëshë kurorëzim i dashurisë.

Poashtu edhe hipoteza tjetër se bashkëshortët që nuk kanë fëmijë e kanë më të lehtë për të marrë vendimin për shkurorëzim është vërtetuar nga të intervistuarit, ku njëri ndër ta tha se mospasja e fëmijëve ka qenë shkak i shkurorëzimit të tij. Edhe nga rastet e tjera shifet se çiftet me fëmijë mundohen më tepër të ruajnë martesën e tyre për shkak edhe të fëmijëve familjes së krijuar nga vetë ata dy. Ndërsa çiftet pa fëmijë e kanë më të lehtë për tu shkurorëzuar pasi se nuk kanë fëmijë të përbashkët kanë më pak obligime pas shkurorëzimit dhe për këtë e kanë edhe më të lehtë jo se ata nuk mundohen që të ruajnë martesën e tyre por ndoshta nuk sakrifikojnë aq shumë dhe nuk bëjnë shumë kompromise sikurse çiftet që kanë fëmijë të cilët pos vetes së tyre duhet të mendojnë edhe për fëmijët e tyre dhe për pasojat që ata mund të kenë në rast të shkurorëzimit.

Është interesant fakti sa i përket ndarjes së pasurisë në Komunën e Preshevës pothuajse në secilin rast të shkurorëzimit palët deklarorin se nuk kishin arritur pasuri të përbashkët dhe si pasojë e saj skishin as qfarë të ndanin, gjë që nuk është e vërtetë por kjo dëshmon pozitën më të lartë të burrit në krahasim me gruan sepse zakonisht dihet që pasuria që fitohet me punë të përbashkët prap i mbetet burri për shkak të mentalitetit patriarkal. Kishte disa raste që deklarorin se ndarjen do ta bënin jashta dymëve të gjykatës. Sa i përket alimentacionit zakonisht prindi që nuk e kishte kujdestarin paguante alimentacion natyrisht kur kishte mundësi për një gjë të tillë. Por në praktikë alimentacioni jo çdo herë jipej , edhe atëherë kur jipej nuk jipej me rregull nga ana e prindit tjetër.

Mund të konkludojmë së shkurorëzimi në Komunën e Preshevës siç mund edhe të shifet nga statistikat nuk arrin shifra shumë të larta sidomos nëse e krahasojmë me vendet tjera- qytetet tjera komuna janë qëndron shumë mirë bile i ka shifrat më të ulta së shumica e vendeve tjera në Serbi dhe më gjerë.

Bazuar në analizimin dhe studimin e të gjitha rasteve të shkurorëzimit nga viti 2010-2015 dhe intervistat e realizuara me të shkurorëzuarit avokat e gjygtarë ,hulumtova edhe hipotezën e përgjithshme se në Komunën e Preshevës ka rritje të konsiderueshme të shkurorëzimeve.Dhe në bazë të këtij hulumtimi, nga grumbullimi i të dhënave dhe rangimi i shkurorëzimeve nga 2010 deri 2015, si dhe nga statistikat del apo vërtetohet e kundërta se ka pasur rënie të shkurorëzimit që është një gjë pozitive. Të dhënat poashtu dëshmojnë faktin se shoqëria preshevarë është një shoqëri e shëndoshë.

Kjo gjë tregon sistemin e vlerave që kanë qytetarët e Komunës së Preshevës dhe se familja preshevarë është një familje stabile dhe e shëndoshë përkundër peripetive të saj.Ky fakt nuk është për t'u habitur pasi Preshevarët shquhen për vlerat morale që kanë.

Por kjo nuk do të thotë se nuk ka nevojë për përmirësime.

Rekomandimet e mia do të ishin :

- Ndryshimin apo plotësimin e Ligjit aktual për Familjen
- Inkorporimin e rregullave dhe rekomandimeve të Këshillit të Evropës që kanë të bëjnë me institucionin e martesës dhe shkurorëzimit në legjislacionin vendor
- Sjelljen e një ligji të veçantë për martesën dhe shkurorëzimin
- Bashkëpunim më të ngushtë mes Ministrisë së Drejtësisë me Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale rreth çështjeve të shkurorëzimit
- Analizimi dhe krahasimi i legjislacioneve të vendeve tjera me qëllim që të përfitohet nga përvoja e tyre dhe të inkorporohen në fushën e të drejtës familjare
- Qendrat për punë sociale të jenë më të efektshme dhe të monitorojnë periodikisht fëmijët e mitur të prindërve të shkurorëzuar
- Mbrotja më e madhe e interesave të fëmijëve
- Mbrotje më e madhe edhe për rastet e dhunës
- Të zhvillohen politika sociale me qëllim të përmirësimit të jetës së bashkëshortëve të shkurorëzuar
- Mbajtja e seminarave, debateve, konferencave shkencore lidhur me shkurorëzimin dhe pasojat e shkurorëzimit
- Të ketë bashkëpunim më të ngushtë mes institucioneve relevante për shkurorëzim
- Të formohen institucione të veçanta për pajtim ku çifteve në krizë apo me probleme të ju ofrohet ndihmë profesionale me qëllim të shpëtimit të martesave dhe zvogëlimit të shkurorëzimeve .

## BIBLIOGRAFIA

1. Abdulla Aliu, ‘E drejta Familjare’, Prishtinë, 2007.
2. Aleks Luarasi, ‘Shteti dhe e drejta shqiptare në epokën e Skenderbeut’, Tiranë, 1998.
3. Aleks Luarasi, ‘Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri’, Tiranë, 2001.
4. Aleks Luarasi, ‘Marrëdhëniet familjare’, Tiranë, 2001.
5. Andrew J. Chepli, ‘Public and private families’, N.York, 1996.
6. Andrew Borkowski, Paul du Plessis, ‘E Drejta Romake’, Përkthim Spartak Ngjela, Tiranë, 2001.
7. Arta Mandro, ‘E Drejta Familjare’, Tiranë, 2009.
8. Asllan Bilalli, Hajredin Kuçi, ‘Zanafilla, zhvillimi historik dhe burimet e së drejtës ndërkombëtare’, Tetovë, 2006.
9. Gani Oruçi, ‘E drejta Familjare’, Prishtinë, 1994.
10. Hamdi Podvorica, ‘E Drejta Familjare’, Prishtinë, 2005.
11. Hamit Beqja, Lekë Sokoli, ‘Divorci’, Tiranë, 2000.
12. Hamude Abdul’Ati, ‘Struktura familjare në Islam’, Shkup, 1995.
13. Hilmi Ismaili, Fatmir Sejdiu, ‘Historia e shtetit dhe e së drejtës’, Prishtinë, 2005.
14. Ivo Puhan, ‘E drejta romake’, Prishtinë, 1980.
15. Irfan Abazi, Taxhedin Bislimi, Faredin Ebibi, Jusuf Zimeri, ‘E drejta Familjare në Islam’, Shkup, 1996.
16. Jusuf Kardavi, ‘Hallalli dhe harami’, Shkup 2004.
17. Ken Dhima, ‘E Drejta Romake’, Tiranë, 2007.
18. Liljana Spirovik Trpenska, ‘Semejno Pravo’, Shkup, 2013.
19. Marija Draskic, ‘Porodicno pravo’, Beograd, 2016.
20. Marija Draskic, ‘Porodicno pravo i prava deteta’, Beograd, 2015.
21. Marina J. Komar, Slobodan Panov, ‘Nasilje u porodici’, Beograd, 2012.
22. Marko Mladenovic, Slobodan Panov, ‘Porodicno pravo’, Beograd, 2003.
23. Mladenovic Marko, ‘Porodicno pravo’, Beograd, 1982.
24. Muhamed Ahmed Ken’an, ‘Elementet themelore të jetës bashkëshortore’, Gostivar, 2005.
25. Muhammed Kutub, ‘Tituj të zgjedhur mbi familjen muslimane’, Prishtinë, 2001.
26. Muhamed Rashid Rida, ‘Të drejtat e gruas në Islam’, Tirane, 2006.
27. Musli Halimi, ‘Marrëdhëniet juridiko-civile në Ligjin e XII Tabelabe’, Tetovë, 2005.
28. Slobodan Panov, ‘Porodicno Pravo’, Beograd, 2016.
29. Shefik Kurdiç, ‘Martesa në Islam’, Tetovë, 2010.
30. Shejh Salih ibën Salih El-Feuzan, ‘Dispozitat në lidhje me gratë besimtare’, Shkup, 2009.
31. Zoran Ponjavic, ‘Privatizacija porodice i porodicnog prava’, Beograd, 2009.
32. Zoran Ponjavic, ‘Porodicno pravo’, Beograd, 2016.
33. Kur’ani.

## LIGJET DHE AKTET JURIDIKE TË SHFRYTËZUARA

1. Kushtetuta e Serbisë ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 98/2006)
2. Ligji i familjes i Republikës së Serbisë ("Gazeta Zyrtare e RS", nr.18/2005 dhe 72/2011)
3. Ligji i procedurës kontestimore RS ("Gazeta Zyrtare", nr.125/2004 dhe 111/2009)
4. Ligji për rregullimin e gjykatave RS("Gazeta Zyrtare e RS", nr.116/2008, 104/2009, 101/2010, 31/2011, 78/2011, 101/2011, 101/2013, 106/2015)
5. Ligji për Familjen i Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RM", nr.80/1992, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14,115/14 dhe 104/15)
6. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë Ligji Nr.9062, 2003
7. Ligji për Familjen i Republikës së Kosovës Ligji Nr. 2004/32 2006
8. Deklarata e përgjithshme për të drejtat e njeriut 1948
9. Konventa e Hagës për njohjen e shkurorëzimit dhe ndarjes ligjore 1970
10. Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut ose Konventa për mbrotjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore 1953
11. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave 1981
12. Konventa për të drejtat e fëmijës 1989
13. Rekomandimi nr.R(98) 1 i Këshillit të Evropës mbi ndërmjetësimin në marrëdhëniet familjare 1998
14. Konventa mbi të drejtën e cila aplikohet të detyrimet e ushqimisë (alimentacionit) ndaj fëmijëve 1958
15. Konventa mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve mbi alimentacionin (ushqimisë) 1973
16. Konventa mbi kompetencën,të drejtën kompetente,njohjen,ekzekutimin dhe bashkëpunimin në çështjet e përgjegjësisë prindërore dhe masave mbi mbrotjen e fëmijëve 1996
17. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike 1976

## BURIMET E INTERNETIT

1. Emese von Bóné, *"The historical development of grounds for divorce in the French and dutch civil codes"*.  
[http://www.scielo.org.za/scielo.php?script=sci\\_arttext&pid=S1021545X2014000200049](http://www.scielo.org.za/scielo.php?script=sci_arttext&pid=S1021545X2014000200049)
2. Dr Sherif Muhamed, *"Gruaja në Islam kundrejt tradites judeo-krishtere"*  
<http://de.slideshare.net/Libraislame/dr-sherif-muhamed-gruaja-ne-islam-kundrejtradites-judeokrishtere>
3. Jens M.Shcherpe, *"European Family Law"*.  
<https://books.google.rs/books?id=qIxeCwAAQBAJ&pg=PA376&lpg=PA376&dq=comparative+divorce+law+in+ballcan&source=bl&ots=Fp5aLpRvsc&sig=rISfqLQWkJIQ0CPdZP21Do9qCo8&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwiutaqbgOvEhUIOsAKHSXqDM4Q6AEINTAC#v=onepage&q=comparative%20divorce%20law%20in%20ballcan&f=false>

4. **Nigel Wilson, ‘*Encyclopedia of ancient Greece*’.**  
[\(https://books.google.rs/books?id=8pXhAQAQBAJ&pg=PA238&lpg=PA238&dq=history+of+divorce+in+ancient+athens&source=bl&ots=okIuEpWlhk&sig=2dsobWx5D2Ri0XsRKRYKIOYGe\\_M&hl=de&sa=X&redir\\_esc=y#v=onepage&q=history%20of%20divorce%20in%20ancient%20athens&f=false\)](https://books.google.rs/books?id=8pXhAQAQBAJ&pg=PA238&lpg=PA238&dq=history+of+divorce+in+ancient+athens&source=bl&ots=okIuEpWlhk&sig=2dsobWx5D2Ri0XsRKRYKIOYGe_M&hl=de&sa=X&redir_esc=y#v=onepage&q=history%20of%20divorce%20in%20ancient%20athens&f=false)
5. **Prof. Dieter Martiny, ‘*Grounds for divorce and maintenance between former spouses*’.** [ceflonline.net/wp-content/uploads/Germany-Divorce.pdf](http://ceflonline.net/wp-content/uploads/Germany-Divorce.pdf)
6. <http://www.ancient.eu/article/623/>
7. <http://fathom.lib.uchicago.edu/1/777777190170/>
8. <http://www.womenintheancientworld.com/hammurabilawcode.htm>
9. [https://en.wikipedia.org/wiki/Marriage\\_in\\_ancient\\_Greece](https://en.wikipedia.org/wiki/Marriage_in_ancient_Greece)
10. [http://www.stoa.org/projects/demos/article\\_women\\_and\\_family?page=all](http://www.stoa.org/projects/demos/article_women_and_family?page=all)
11. <http://www.moyak.com/papers/athenian-women.html>
12. <http://www.womenintheancientworld.com/divorceinancientrome.htm>
13. <http://www.cflp.co.uk/a-brief-history-of-divorce/>
14. <http://www.womenintheancientworld.com/divorceinancientrome.htm>
15. <http://www.lifemanagement.com/fsa8.2.1137/>
16. <http://historycooperative.org/the-history-of-divorce-law-in-the-usa/>
17. <https://www.theguardian.com/lifeandstyle/2009/sep/19/divorce-law-history>
18. <https://www.lawteacher.net/study-guides/family-law/History-Divorce-Law.php>
19. <http://www.lifemanagement.com/fsa8.2.1137/>
20. <http://historycooperative.org/the-history-of-divorce-law-in-the-usa/>
21. <http://permalink.gmane.org/gmane.politics.region.albania.shqiperia/5991>
22. <http://informer.rs/vesti/drustvo/305367/svaki-cetvrti-brak-se-raspadne-ovo-su-najcesci-razlozi-razvoda-u-srbiji>
23. <http://www.lepaisrecna.rs/slobodno-vreme/price-iz-srbije/12318-razvodi-u-srbiji-sve-cesci-u-prvim-godinama-zajednickog-zivota.html>
24. <https://www.vesti.rs/Drustvo/ALARMANTNO-U-Srbiji-vise-razvoda-nego-venecanja.html>
25. <https://pescanik.net/srbija-vs-evropa-u-svetlu-statistike/>
26. [http://www.novosti.rs/vesti/zivot\\_+303.html:567248-Sta-ubija-brakove-u-Srbiji](http://www.novosti.rs/vesti/zivot_+303.html:567248-Sta-ubija-brakove-u-Srbiji)
27. <http://portal.tlas.org.al/sq/sherbimet/zgjidhje-martese>
28. <https://www.slideshare.net/sara7991/divorci-ne-shoqerine-shqiptare>
29. <http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika>
30. <http://www.javaneës.al/harta-e-divorceve-ne-shqiperi-ndahen-rreth-39-cifte-ne-cdo-100-martesa/>
31. <http://www.balkanweb.com/site/deshiron-divorcin-mendo-per-femijet/>
32. <http://www.kosovapress.com/sq/shendetesi/si-ndikon-divorci-i-prinderve-tek-femijet-pasojat-i-tregon-psikologia-125315/>
33. <https://telegrafi.com/fenomeni-i-divorcit-ne-shoqerine-kosovare/>
34. <http://www.kosovapress.com/sq/shendetesi/divorci-mund-te-ndikojte-ne-mbipeshen-e-femijes-18705/>
35. <http://www.gazetamonitor.com/arsyet-e-divorceve-ne-kosove/>
36. <http://aktivpress.com/shkaktaret-e-rritjes-se-numrit-te-cifteve-te-shkurorezuara-ne-kosove/>

37. <https://telegrafi.com/rritet-numri-i-divorceve-ne-maqedoni-statistike/>
38. <http://www.gazetaexpress.com/lajme/90-te-rasteve-te-divorcit-ne-maqedoni-jane-iniciative-e-grave-200944/?archive=1>